

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje Europiane dhe të sigurisë - 22

ÇËSHËTJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË

EUROPEAN AND SECURITY AFFAIRS

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Bordi shkencor:

Prof. dr. Rexhep Meidani (kryetar)

Prof. asoc. dr. Kristaq Xharo (anëtar)

Prof. asoc. dr. Arshi Çela (anëtar)

Dr. Eranda Gjomema (anëtare)

Elona Dhëmbo, kandidate për dr. (anëtare)

Redaktor përgjegjës:

MA Elira Hroni

Ndihmuan në përgatitje:

Egest Gjokutaj

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare
të **Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s**
dhe **Fondacioni Shoqëria e Hapur OSI Think tank Fund**

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE 7

Giovanni Faleg dhe Alessandro Giovannini

1. BE-ja ndërmjet mbledhjes & përdorimit të përbashkët dhe mbrojtjes së zgjuar: Virtytizi i domosdoshmërisë? 9

Liliana Levkovska dhe Shane Thomas Franklin

2. Një qasje gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e zgjuar të NATO-s 40

Daniel Fiott

3. Pasojat gjeopolitike të krizës së Eurozonës: Rasti i Politikës së Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë 48

Dr. Arben Shehu

4. Kriza ekonomike dhe krimi i organizuar 72

Kudret Selimaj

5. Konteksti historik dhe dukuritë e terrorizmit në Europë ... 81

Alida TOMJA, Doktorante

6. Karta e Adriatikut: Integrimi i vendeve të Adriatikut 3 në NATO 101

PARATHËNIE

Në përpjekje për të kontribuar në informimin e publikut mbi çështjet kryesore të politikave mbi reformat dhe performacën e sektorit të sigurisë në përgjithësi, trendet europiane dhe globale të sigurisë, debatin aktual dhe të ardhshëm mbi fushat prioritare të NATO-s, sfidat e Shqipërisë për reformimin e institucioneve dhe qeverisjes në sektorin e sigurisë, çështjet debatuese dhe partneritetet e NATO-s me BE-në dhe organizatat e tjera botërore, ky numër i Revistës për Çështjet Europiane dhe të Sigurisë vjen me një tematikë të veçantë mbi: *“Perspektivat e Reformave në Sektorin e Sigurisë në Shqipëri: Reforma dhe Sfida të Strukturave Rregullatore Ligjore dhe Kushtetuese”*.

Kjo fushë studimi, duke u përqendruar te sfidat dhe problemet e reformave ligjore në sektorin e sigurisë në vend, sjell njëkohësisht një panoramë më të gjerë të perspektivës europiane në qeverisjen e sektorit të sigurisë, apo të aktorëve të tjerë që kanë një impakt domethënës mbi këtë sektor.

Giovanni Faleg dhe Alessandro Giovannini¹

I. BE-JA NDËRMJET MBLEDHJES & PËRDORIMIT TË PËRBASHKËT DHE MBROJTJES SË ZGJUAR VIRTUTIZIMI I DOMOSDOSHMERISË?

Abstrakt

Kriza financiare ka prekur thellësisht buxhetet e mbrojtjes europiane dhe rrjedhimisht edhe kapacitetin e BE-së për të vepruar si ofrues i sigurisë globale. Ky punim vlerëson shkallën se deri ku mbledhja dhe përdorimi i përbashkët (Pooling & Sharing) i kapaciteteve ushtarake është një plan i suksesshëm për të rritur zhvillimin e ndërtimit të përbashkët të kapaciteteve dhe për të kompensuar ndikimin e shkurtimeve të mëdha buxhetore duke u frymëzuar nga agjenda e NATO-s për mbrojtjen e zgjuar (*Smart Defence*). Edhe pse nga këndvështrimi ekonomik, bashkëpunimi shumëpalësh ka qenë më efikas sesa *status-quo* dhe një sërë stimuljsh ushtarakë do të lehtësonin një integrim ushtarak më të thellë, studimi njeh faktin se një treg mbrojtjeje i BE-së tërësisht i pavarur mbetet i vështirë për t'u arritur për shkak të vlerësimeve afatshkurtra politike dhe strategjike. Megjithatë, progresi hap pas hapi në fusha specifike është si i mundshëm, ashtu edhe i arritshëm nëse përmbushen rrethanat politike. Kapitulli i fundit i studimit ofron rekomandime politikash për të shkuar drejt një plani pragmatik dhe të arritshëm për P&S.

Hyrje

Sekretari i Mbrojtjes i SHBA, Robert Gates në qershor të vitit 2011 paralajmëroi se Amerika mund të braktiste NATO-n nëse trendet aktuale në rënie të kapaciteteve të mbrojtjes nuk do të ndryshonin (Traynor, 2011). Në atë moment ndërmarrjet

¹ Giovanni Faleg është një studiues i përkohshëm te CEPS dhe doktorant në Shkollën Ekonomike të Londrës dhe Shkencat Politike. Alessandro Giovannini është asistent studiues te CEPS.

europiane të mbrojtjes u përballën me një vendim të menjëhershëm dhe të vështirë: ose të rrisnin asetet e mbrojtjes në kontinent duke përmbushur kësaj zotimet e aleancës ose të zvogëlonin këto asete dhe të lëshonin terren ndaj presioneve të ashpra.

Është e kuptueshme se në situatën aktuale asnjë udhëheqës nuk mund të miratojë një rritje të shpenzimeve ushtarake pa u përballur me kritikë nga publiku dhe me humbjen thuajse të paevitueshme të elektoratit përkatës. Për më tepër përse duhen rritur shpenzimet ushtarake gjithësesi? Frika nga pushtimi sovjetik dhe rreziku për një luftë bërthamore në Europë u zhdukën thuajse 20 vjet më parë. Përsa i përket rrezikut nga terrorizmi ndërkombëtar, qasja e BE-së në luftën kundër terrorizmit ka prioritetizuar bashkëpunimin policor dhe në drejtësi kundrejt qasjes ushtarake. Përgjithësisht, vendet anëtarë të BE-së priren të trajtojnë terrorizmin si çështje të brendshme dhe kanë qenë shumë kritikë kundrejt konceptit ushtarak të "Luftës kundër terrorizmit" të përkrahur nga SHBA-ja (Keohane, 2005). Me fjalë të tjera, meqenëse Europa nuk përballlet me ndonjë rrezik të pashmangshëm, argumentet politike për rritjen e shpenzimeve ushtarake në një periudhë ashpërsie ekonomike priren të humbasin terren.

Në këtë kontekst, reduktimet e mëdha të shpenzimeve për mbrojtjen nuk janë të papritura. Në Britaninë e Madhe, rishikimi strategjik i buxhetit të mbrojtjes dhe sigurisë për vitin 2010 nga qeveria e koalicionit atje (HM government 2010) përfshiu shkurtimet më të mëdha të shpenzimeve për mbrojtjen që prej fundit të Luftës së Ftohtë. Sakrificat buxhetore përmbanin masa të ashpra si rënia me 8% e shpenzimeve për mbrojtjen brenda katër vjetëve, reduktimi i ushtrisë me rreth 7000 trupa, çmontimi i makinave ushtarake Harrier dhe i avionëve zbulues Nimrod dhe së fundi por jo më pak e rëndësishmja, vendimi për çmontimin e Aeroplanmbajtëses *HMS Ark Royal* shumë përpara ndërtimit të dy Aeroplanmbajtëseve të reja (*HMS Queen Elisabeth* dhe *HMS Prince of Waes*) që do të zëvendësonin atë. Masa e fundit do të thotë se asnjë avion nuk do të mund të fluturojë nga Aeroplanmbajtëse britanike përpara vitit 2019.

Një tjetër gjë jo e papritur është edhe fakti se shtetet janë përpjekur të ulin kostot e mbrojtjes dhe të rritin efikasitetin duke forcuar format e bashkëpunimit dypalësh ose shumëpalësh me shtetet e tjera. Ndoshta shembulli më konkret i kësaj është

marrëveshja e mbrojtjes ndërmjet Francës dhe Britanisë së Madhe që u firmos në Londër, më 2 nëntor 2010, e cila përfshinte një bashkëpunim të paprecedent në fushën e mbrojtjes, duke përfshirë edhe përdorimin e përbashkët të mjediseve për testimin e raketave me mbushje bërthamore, përdorimin e përbashkët të avionëve për qëllime trajnimi dhe për operacione të mundshme ushtarake, krijimin e një force të përbashkët për t'u vendosur jashtë vendit dhe përdorimin e burimeve të përbashkëta për trajnimin, mirëmbajtjen dhe logjistikën e avionëve transportues A400M. Megjithatë, kjo formë bashkëpunimi nuk mjaftoi për të parandaluar që Europa të shënjestrohej nga kritikata publike kur fushatës nën udhëheqjen Anglo-Franceze në Libi, i mbaruan municionet.

Për të shmangur një tërheqje europiane për çështjet e mbrojtjes në gusht të vitit 2011 NATO bëri thirrje për bashkëpunim më të madh ndërmjet vendeve anëtare europiane për blerjen e pajisjeve për mbrojtjen, trajnimin dhe specializimin në detyra ushtarake (Rasmussen, 2011). Logjika bazë e "agjendës për mbrojtjen e zgjuar" (*smart defence agenda*), paketa e plotë për zbatimin e së cilës do të prezantohet në Samitin e NATO-s në Çikago në maj 2012, është e drejtpërdrejtë. Në vend që të ndërmerren programe kombëtarë të kushtueshme, aleatët mund të kërkojnë zgjidhje më efikase në kosto duke mbledhur dhe përdorur së bashku (P&S) burimet.

As ndarja e barrës dhe as ideja e bashkimit dhe përdorimit të përbashkët të kapaciteteve ushtarake në Europë nuk përbëjnë një shqetësim të ri në marrëdhëniet transatlantike (Biscop, 2005). Ajo që dy konceptet kanë të përbashkët është se megjithatë ato duket se janë një konflikt i pafund, i cili vazhdimisht ka dështuar që të kthehet në veprime konkrete. Risia është se kriza financiare së bashku me mësimet e marra nga fushata në Libi, kanë mundësuar për lidhjen e idesë të një kontributi më të drejtë dhe më të dukshëm europian me konceptin e zhvillimit të kapaciteteve të NATO-s në mënyrë të "zgjuar" për të trajtuar mbrojtjen me anë të bashkëpunimeve shumëpalëshe në një kohë shtrëngesash ekonomike (Giegerich, 2006 dhe Valasek, 2011). Për më tepër riorientimi i interesave strategjikë të SHBA-së drejt rajoneve të Azisë dhe Paqësorit po shtyn europianët që të rifokusojnë qasjen e tyre tek fqinjët si edhe që të konsiderojnë mënyra për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e kapaciteteve të sigurisë së fortë pa ndikuar në deficitin fiskal.

Këta faktorë kanë nxitur rigjallërimin e diskutimeve për europeanizimin e mbrojtjes ushtarake në BE i cili është zhvilluar më tej nëpërmjet procesit të njohur si “Kuadri i Ghentit” (*Ghent Framework*) (Biscop & Coelmont, 2011). Kësisoj, dalin në pah tre pyetje të rëndësishme. E para, çfarë impakti do të ketë ky zhvillim i ri transatlantik mbi tregun e mbrojtjes së Bashkimit Europian dhe më gjerësisht tek Politika e Përbashkët e Mbrojtjes dhe Sigurisë (PPMS)? Nga këndvështrimi ekonomik, a është struktura aktuale e tregut të mbrojtjes së BE-së përthithëse ndaj P&S? Së treti, cilat janë perspektivat reale për bashkëpunim më të thellë në një sektor ku tendencat kombëtare proteksioniste dhe interesat strategjike janë shumë të theksuar për të lejuar hapjen dhe liberalizimin?

Ky dokument mundëson një analizë të detajuar se pse dhe si racionalizmi dhe optimizimi i shpenzimeve për mbrojtjen të BE-së me anë të mbledhjes dhe përdorimit të përbashkët është i nevojshëm, si dhe për identifikimin e pengesave kryesore me të cilat do të përballlet Europa për zbatimin praktik të kësaj agjende. Ne argumentojmë se edhe pse kushtet strukturore pas vitit 2008, kanë qenë të favorshme duke lejuar që BE të kryente lëvizjen historike për thellimin e integritetit ushtarak, një sistem i mbrojtjes i BE-së dhe një treg europian i mbrojtjes tërësisht të pavarur mbetet ende e paarritur për shkak të konsiderimeve politike dhe strategjike. Njëkohësisht, progresi hapa pas hapi është i mundshëm dhe i arritshëm sidomos nëse kjo shtyhet përpara nga një thirrje e besueshme e NATO për “më tepër Europë”.

Analiza strukturohet si më poshtë. Seksioni i parë identifikon bashkimin dhe përdorimin e përbashkët të burimeve në kuadrin e tregjeve të mbrojtjes së BE-së dhe përmbledh çështjet kryesore të debatit akademik dhe atij politik. Seksioni i dytë shpjegon se përse rrethanat aktuale e bëjnë më të mundshëm zbatimin e agjendës për P&S kundrejt përpjekjeve të pasuksesshme të mëparshme. Seksioni i tretë analizon ekonominë e shpenzimeve ushtarake të BE-së për të qartësuar se përse nevojitet P&S si edhe se cilat janë dobësitë kryesore në sistemin aktual të mbrojtjes të BE-së. Së fundmi, seksioni i katërt bën rekomandime për një plan të arritshëm dhe pragmatist për P&S.

Mbledhja dhe ndarja e BE-së: Një qasje e re për një ide të vjetër

Përkufizimi i P&S bazohet në tre komponentë kryesorë: i) mbledhja e prokurimit të armëve dhe shërbimeve, ose struktura

të përbashkëta për kërkim (për shembull për avionin transportues 400M); ii) përdorimi i përbashkët nëpërmjet integritit të pjesëshëm ose të plotë të strukturave të forcave të armatosura (për shembull mjediset për trajnim ose formimi i njësive të përbashkëta) dhe iii) specializimi. Tashmë në Europë ekzistojnë disa shembuj të praktikimit të P&S të cilët përfshijnë: së pari, traktatin Franko-Britanik të nëntorit të vitit 2010, i cili është një marrëveshje dypalëshe për P&S; së dyti, eksperiencia shumëpalëshe si Katërshja e Vishegradit (Çekia, Hungaria, Polonia dhe Sllovakia) dhe Trekëndëshi i Weimarit (Franca, Gjermania dhe Polonia) të cilave mund t'ju referohesh më mirë si iniciativa të nivelit të ulët që janë pjesërisht në kuadrin e P&S; dhe së treti lidhur me kapacitetet e Grupeve të Luftimit të BE-së (*EU Battlegroups*) të cilët përbëjnë shembuj konkretë të “bashkimit” të trupave të vendeve anëtarë të BE-së. Megjithatë, pa anashkaluar këto iniciativa duhet thënë se agjenda për P&S e BE-së varet nga dy faktorë kryesorë të cilët duhen konkretizuar ende. I pari, liberalizimi i efekti të tregut europian të mbrojtjes duke çuar drejt një konkurrence më të madhe ndërmjet kompanive të mbrojtjes (duke hequr kësajsoj barrierat kombëtare) dhe Europianizimit të një pjese të buxhetit të mbrojtjes. Së dyti, përmirësimet e dukshme të bashkëpunimit europian për vendosjen në një kuadër të përbashkët të bashkëpunimit të diversifikuar europian për pajisjet ushtarake dhe atij për teknologjitë.

Duke datuar që në vitet 1990 në kuadër të Bashkimit të Europës Perëndimore (BEP), thellimi i bashkëpunimit në fushën e armatimeve është një histori e vjetër (Keohane, 2005). Kjo lidhet ngushtë me tre dobësitë strukturore të sistemit të mbrojtjes së BE-së.

Pabarazitë në shpenzimet ushtarake ndërmjet vendeve anëtarë të BE-së dhe mungesa e koordinimit kanë dëmtuar bashkëpunimin e BE-së në fushën e sigurisë. Vetëm Britania e Madhe dhe Franca së bashku përbëjnë mbi 40% të investimeve publike për mbrojtjen në Bashkimin Europian. Shpenzimet e vendeve të tjera të BE-së për sa i përket kontributit në kapacitete virtuale të mbrojtjes së BE-së janë të pavlefshme. Rrjedhimisht, pjesa kryesore e kapaciteteve për mbrojtjen të BE-së nuk kanë “madhësinë” e duhur dhe kapacitetet kombëtare janë ende në pjesën më të madhe të tyre të pakoordinuar, sidomos për sa i përket blerjes së teknologjive të reja. Për më tepër, kapacitetet kolektive ushtarake që janë zhvilluar nga vendet anëtare që prej qershorit të vitit 2004 (miratimi i *Headline Goal* në 2010 duke

vendosur guidat për ndërtim kapacitetesh) kanë nxjerrë në pah mangësi të mëdha dhe projektet për prokurimin e përbashkët janë rrezikuar prej rivaliteteve kombëtare (Major & Molling, 2010). Dy shembuj janë dukshëm domethënës. Grupet e Luftimit të BE-së të cilët konsiderohen si historia e suksesshme kryesore e procesit për zhvillimin e kapaciteteve (Lindstrom, 2007), nuk janë dislokuar asnjëherë dhe prandaj nuk mund të mundësojnë eksperiencën operacionale të nevojshme (që është një tërësi mësimesh të mësuara) për përmirësimin dhe shtyrjen përpara të mekanizmit për gjenerimin e kapaciteteve. Një *studim* i publikuar nga Instituti i BE-së për Studimet e Sigurisë (ISS) në nëntor 2009 (Keohane & Blommestijn, 2010) njeh faktin se, krahasuar me vitin 1999, vërehet një progres i ngadaltë tek planet për prokurime si për shembull për avionët transportues A400M dhe C-17, avionët gjuajtës Eurofighter, Joint Strike Fighter dhe Rafale dhe për sistemin e drejtimit satelitor Galileo. Megjithatë, dokumenti thekson gjithashtu se një sërë dobësish në kapacitete ende do të vazhdojnë të dëmtojnë aftësinë e BE-së për të projektuar forcën e saj ushtarake, sidomos për sa i përket aseteve të transportit strategjik.

Proteksionizmi ekonomik dhe konsideratat gjeopolitike gjithashtu ndihmojnë për të shpjeguar gjeometrinë fleksibël të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes e cila dëmton integrimin në këtë fushë duke rezultuar në progres të ngadaltë për sa i përket kapaciteteve. “Pyetja thelbësore këtu është se cilat janë arsyet për bashkëpunim dhe me kë bashkëpunohet? *Organisation Conjointe de Coopération en matière d’Armements* (OCCAR), për shembull mbledh së bashku Belgjikën, Francën, Spanjën, Italinë, Gjermaninë dhe Britaninë e Madhe për menaxhimin efikas (domethënë bashkimin) e disa projekteve specifike të përbashkëta për armatimin si Projekti për përdorimin taktik dhe strategjik të avionit A400M ose programi FREMM (*Fregate Europee Multi-Missione*). OCCAR ka qenë e suksesshme vetëm për arritjen e objektivave të kufizuar dhe të përqendruar me një numër të kufizuar vendesh pjesëmarrëse. Një organizatë më e madhe do të ishte shumë më e vështirë për t’u menaxhuar dhe do të ulte efikasitetin për shpërndarjen e pajisjeve të mbrojtjes.

Literatura specifikon ndryshimet në kulturat strategjike kombëtare si një pengesë e tretë kulturore me pasoja thelbësore strategjike dhe operacionale. Kulturat strategjike ndikojnë në mënyrën si forcat e armatosura kombëtare veprojnë dhe

përforcojnë doktrinat ushtarake që udhëheqin qasjen e shteteve të ndryshme për procedurat dhe qasjet operacionale. Siç theksohet nga Christoph Meyer, duke qenë se PPMS varet në mënyrë thelbësore nga bashkëpunimi ndërmjet ushtrive kombëtare në fazën e planifikimit dhe zbatimit, moskoherencat strategjike mund të çojnë drejt çorientimit, qëllimeve të paqarta dhe kësisoj në veprime të vonuara ose të paefektshme (Meyer, 2004). Ndarjet sipas kulturave strategjike ndërmjet vendeve anëtare të BE-së zhvillohen rreth tre dimensioneve kryesore:

i) Atlanticistët (Britania e Madhe, Holanda dhe vendet e Europës Qendrore dhe Lindore) kundrejt europianistëve (Franca, Gjermania, Belgjika ose Finlanda).

ii) Vendet multilateraliste (shumica dërrmuese e vendeve anëtarë të BE-së) kundrejt sovranistëve (për shembull Britania e Madhe) dhe neutralistëve (si Austria dhe Irlanda) dhe,

iii) vendet të cilat përkrahin përdorimin e forcës (kryesisht ish-vende koloniale si Franca dhe Portugalia) kundrejt fuqive pacifiste (Gjermania dhe Vendet Nordike) (Cardoso, 2009).

Kulturat strategjike ndërveprojnë me masën dhe kapacitetet e ushtrive kombëtare, duke thelluar boshllëkun ndërmjet vendeve anëtare të mëdha dhe të vogla dhe duke ndikuar interesat dhe prioritetet e tyre të sigurisë. Strategjia Europiane për Sigurinë (SES) (Bashkimi Europian, 2003), e cila u hartua nën përgjegjësinë e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së Javier Solana dhe u aprovua nga Këshilli Europian më 12 dhjetor të vitit 2003 dhe Rishikimi i mëvonshëm i saj (Bashkimi Europian, 2008) edhe pse kanë krijuar terrenin për identifikimin e fushave strategjike për bashkëpunim dhe kanë ndihmuar për prioritizimin e agjendës së sigurisë të vendeve anëtarë të BE-së, kanë dështuar për të çuar drejt një konvergjence strategjike ose drejt europianizimit. Megjithatë, si Meyer (2006) ashtu edhe Giegerich (2006) bien dakord se ndërmjet vendeve të BE-së vazhdojnë të jenë të pranishme ndasi të rëndësishme kulturore dhe konceptuale (konkretisht ndërmjet atlanticistëve dhe europianistëve dhe ndërmjet atyre që përkrahin ndërhyrjet dhe pacifistëve).

Pasi theksohet sa më sipër, tre zhvillime të rëndësishme kanë rigjallëruar debatin për integrimin ushtarak të BE-së nëpërmjet mbledhjes dhe përdorimit të përbashkët të kapaciteteve gjatë tre vjetëve të fundit.

Së pari, dispozitat e Traktatit të Lisbonës për Bashkëpunim të Përhershëm të Strukturuar (BPS) (*Permanent Structured Cooperation (PESCO)*) si një instrument i cili mundëson që grupe vendesh anëtare të bashkëpunojnë më ngushtë duke përmbushur kësajsoj objektiva që ndryshe do të ishin të paarrtshme me 27 vendet së bashku. Së dyti, miratimi i dy Direktivave (43/EC në fund të vitit 2008 dhe 81/EC në fillim të vitit 2009) që synojnë lehtësimin e procedurave për lëvizjen e mallrave ushtarakë ndërmjet vendeve anëtare dhe rritjen e sasisë së prokurimeve për mbrojtjen që është e hapur ndaj konkurrencës në BE-së. Së treti, miratimi i Kuadrit të Ghentit në dhjetor të vitit 2010 nën presidencën belge, i cili eksploron fizibilitetin për intensifikimin e bashkëpunimit në BE dhe P&S për kapacitetet ushtarake në fusha si trajnimi logjistika, mjekësia, transporti dhe komunikimet. Kjo iniciativë u ndoq nga *German-Swedish Food for Thought Paper* “për intensifikimin e bashkëpunimit ushtarak në Europë që identifikohen këto fusha si të përshtatshme për rritjen e bashkëpunimit: kërkimin dhe zhvillimin, përvetësimin, trajnimin dhe ushtrimet, strukturat dhe procedurat e komandës dhe kostot operationale.

Kuadri i Ghentit është veçanërisht i rëndësishëm duke qenë se ai mundëson “kuadrin politik” që vendet anëtare të shfrytëzojnë potencialin e madh të dy instrumenteve ligjorë (BPS dhe Direktivat 43/81). Kuadri i Ghentit në fakt rihap debatin për buxhetet e mbrojtjes në Europë duke njohur faktin se përgjigjja ndaj buxheteve të reduktuar kombëtare për mbrojtjen duhet kërkuar të krijimi i formave më të mira (më të zgjuara për të përdorur termin e NATO-s) të bashkëpunimit dhe si rrjedhojë duke shkuar përtej marrëveshjeve të mëparshme *ad hoc* dhe të diktuar prej rrethanave të cilat nuk adresojnë që në themel mungesat strategjike të BE-së. Kuadri synon identifikimin dhe vlerësimin e kapaciteteve ushtarake të vendeve anëtarë sipas tre kategorive: i) aftësitë për të qenë i përmbajtur në nivel kombëtar dhe njëkohësisht për të siguruar ndërveprim më të madh, ii) aftësitë për të ofruar potencial për bashkim, dhe iii) kapacitetet për ndarjen e roleve dhe detyrave.

Si zakonisht, zhvillimet e reja në skenën politike kanë stimuluar debatin brenda komunitetit të ekspertëve të sigurisë dhe mbrojtjes të BE-së. Bastian Giegerich (2010) rithekson nevojën për bashkëpunim shumëkombësh në Europë për të ndihmuar menaxhimin e mbrojtjes në një epokë të ashpër ekonomike duke mësuar nga iniciativat e mëparshme. Giegerich njeh faktin se

kufizimet kryesore të këtyre projekteve bashkëpunuese qëndrojnë në lëvizjen e tyre sipas hapit të pjesëmarrësit më të ngadaltë si edhe në faktin që shqetësimet për humbjen e autonomisë kombëtare dhe kapaciteteve industriale përbëjnë vazhdimisht pengesë. Megjithatë katër çështje konsiderohen se bëjnë bashkëpunimin produktiv: transparencja rreth rreziqeve të projektit, një qasje strategjike rreth kohëzgjatjes së kapaciteteve, harmonizimi i kërkesave për pajisje të rënda ushtarake dhe një proces vendimmarrës i depolitizuar.

Biscop & Coelmont (2011) theksojnë nevojën për të përdorur BPS për zbatimin e Kuadrit të Ghentit dhe nevojshmërinë për themelimin e një konference të përhershme për aftësitë me qëllim krijimin e një kuadri strategjik afatgjatë për shkëmbimin sistematik informacionesh mbi planet kombëtarë të mbrojtjes. BPS perceptohet si i vetmi instrument që lejon vendet anëtarë që dëshirojnë të bëhen pjesë e proceseve të përhershëm që të shkojnë më tej pa pasur nevojë të përballen me bllokime të forta prej atyre që nuk duan ta bëjnë këtë. Nëse konfigurohet në mënyrë që të mos krijojë ndasi brenda BE-së dhe nëse mbështetet nga një grup i konsiderueshëm vendesh anëtarë që dëshirojnë të zhvillojnë kapacitete të reja kolektive të cilat aktualisht nuk janë të disponueshme për BE-në, BPS ka potencial afatgjatë. Instrumenti mund të ndihmojë për vendosjen e objektivave dhe planeve të reja për mbrojtjen dhe për përmirësimin e marrëdhënieve me NATO-n dhe zhvillimin e saj si një aleancë me dy shtylla (BE-ja dhe SHBA) ku SHBA humbet ndikimin e saj por përfiton për sa i përket ndarjes së kostos.

Autorë të tjerë kanë vendosur theksin te liberalizimi efikas i tregut evropian të mbrojtjes me miratimin prej Presidencave të zbatimit të Direktivave 43 dhe 81 (O'Donnell, 2011), si edhe tek evropianizimi i një pjese të buxhetit të mbrojtjes dhe komunitarizimi i financimit të misioneve (Liberti, 2011). Valasek (2011) sugjeron formimin e "ishujve të bashkëpunimit" nëpërmjet formimit të ishujve rajonalë shumëpalësh anëtarët e të cilëve do të integrojnë pjesërisht ushtritë e tyre duke zhvilluar kështu strategji sipas nevojave për pjesë diskrete të Europës (një vizion gjeopolitik i marrëdhënies ndërmjet BPS dhe Kuadrit të Ghentit).

Së fundmi për sa i përket pyetjes se cilat kapacitete janë më të afta për bashkimin e Agjencisë Europiane të Mbrojtjes, sugjerohet se P&S duhet të zgjerohet sidomos në lidhje me teknologjitë me përdorim të dyfishtë (ushtarak dhe civil) si

komunikimi satelitor, mbështetja logjistike (për shembull detare) dhe mbështetja mjekësore (EDA, 2011).

Pasi kemi përmbledhur çështjet kryesore në debatin akademik dhe politik si edhe dobësitë kryesore të sistemit të mbrojtjes së BE-së, kapitulli në vijim qartëson se çfarë e bën të ndryshme situatën aktuale nga përpjekjet e mëparshme për krijimin e një tregu europian të armatimeve.

Kjo epokë është ndryshe: Pse mbledhja dhe përdorimi i përbashkët nuk përbëjnë më tabu?

Siç u theksua dhe në kapitullin e mëparshëm tre faktorë endogjenë (hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës, miratimi i Kuadrit të Ghentit dhe dy Direktivat për tregun europian të mbrojtjes) kanë çuar tek rivlerësimi i P&S. Një pyetje kryesore që del në pah është se si thirrja aktuale për intensifikimin e bashkëpunimit në armatim në Europë ndryshon nga përpjekjet zhgënjyese të mëparshme. A justifikohet optimizmi lidhur me një çështje që është konsideruar për një kohë të gjatë si tabu? Tre stimuj të jashtëm mbështetin këtë optimizëm: i) kriza e zonës Euro dhe ndikimi i saj tek buxhetet e mbrojtjes, ii) mësimet ushtarake të nxjerra nda Libia dhe nga thirrja e NATO-s (SHBA) për bashkëpunim shumëpalësh për ndërtimin e kapaciteteve të mbrojtjes dhe iii) e ardhmja e industrisë globale të mbrojtjes dhe tranzitimi drejt një bote shumëpolëshe.

Në kohë shtrëngimesh mungesa e efikasitetit nuk është më e pranueshme

Kriza e zonës Euro dhe ndikimi i saj tek buxhetet e mbrojtjes mundësojnë një stimul të parë dhe kryesor për të konsideruar P&S si një alternativë për reduktimin e shpenzimeve ushtarake individuale të vendeve anëtare. Situata e degraduar e kapaciteteve ushtarake të BE-së nuk është një zhvillim i ri. Që prej fillimit të viteve 1990 vendet europiane kanë filluar reduktimin dramatik të buxheteve të tyre për mbrojtjen. Paqja ishte rivendosur, rreziku Rus që zhdukur dhe të gjithë vendet mundeshin në fund të fundit të përfitonin nga “dividentët e paqes”. Buxhetet europiane për mbrojtjen kanë vuajtur një rënie mesatare prej 16% në katër vjet duke mundësuar burime të çmuara për sektorë të tjerë të ekonomisë. Nga një qasje ekonomike, nuk ka dyshim se ky proces ka forcuar rritjen dhe ka ndihmuar për konsolidimin e projektit liberal European, duke

gjeruar paqe dhe stabilitet në rajon. Ky proces ka çuar në shpërbërjen e ish-strukturave ushtarake për të mundësuar njësi më të vogla, më të mirë trajnuara, më të dislokueshme dhe më fleksibël të cilat janë më të përshtatshme për konfliktet aktuale. Kjo ka rezultuar në rënie të kapaciteteve ushtarakë në terma relativë.

Megjithatë përgjatë dekadës së fundit (2000-2010) shpenzimet ushtarake u rritën sërish kryesisht si rezultat i luftërave në Afganistan dhe Irak. Europa Perëndimore dhe Qendrore (që përbën shumicën e vendeve anëtarë të BE-së dhe NATO-s) ka përjetuar një rritje në terma realë prej 6.4% gjatë periudhës 2000-2009. Edhe pse një rritje e tillë mund të perceptohet si indikator i një ripërtëritjeje të rolit të Europës në sigurinë ndërkombëtare, krahasimi me aktorët e tjerë globalë tregon një tjetër panoramë. Shpenzimet ushtarake europiane janë në fakt mjaft të papërfillshme nëse krahasohen me kërcimin botëror prej 4.3% në terma realë. Gjatë të njëjtës dekadë, SHBA dhe Kina kanë rritur shpenzimet e tyre me 64.7% dhe 18% përkatësisht (vetëm Japonia ka ulur shpenzimet e saj në terma realë me 3.1%). Në vitin 2010 shpenzimet ushtarake të SHBA përfaqësonin 43% të totalit botëror me një kosto ushtarake e cila llogaritej si 4.8% e PBB-së. Pavarësisht synimit të NATO-s për shpenzime ushtarake deri në 2% të PBB-së vetëm 6 vende (Britania e Madhe, Franca, Estonia, Portugalia, Bullgaria dhe Qipro) qëndronin brenda këtij marzhi.

Situata e kapaciteteve europiane të mbrojtjes u përkeqësua seriozisht pas vitit 2008 me ardhjen e krizës financiare. Për t'ju përgjigjur presioneve të tregut dhe për të siguruar buxhetet e tyre shtetërore shumica e qeverive europiane u detyruan të reduktonin shpenzimet e tyre. Kjo tendencë e cila ka qenë më e dukshme në buxhetet e vitit 2010 do të vazhdojë dhe ndoshta do të përkeqësohet përgjatë viteve në vazhdim sidomos për vendet e euro zonës që kanë nivele të larta borxhi. BE-ja në tërësi dhe vendet e Euro zonës në veçanti përgjatë dekadës në vijim do të përballen me presione të forta në financat publike dhe me rritje të ulët ekonomike. Në një periudhë shtrëngimesh të ashpra ekonomike, përdorimi i reduktimeve të shpenzimeve për mbrojtjen përbën një mënyrë të lehtë për qeveritë që ato të reduktojnë shpenzimet pa pasur ndikim të madh në popullaritetin e tyre.

Një shembull empirik i kësaj ndjesie mund të gjendet duke shqyrtuar të dhënat e pyetësorit “Trendet Transatlantike 2011”

zhvilluar nga Fondi Marshall gjerman i Shteteve të Bashkuara (GMF) dhe Compagnia di San Paolo. Shumica e të intervistuarve europianë ishin pro mbajtjes në nivelin aktual (46%) ose reduktimit (34%) të shpenzimeve të mbrojtjes dhe vetëm 17% ishin për rritjen e këtyre shpenzimeve. SHBA-ja tregon një trend thuajse të njëjtë me 45% pro mbajtjes në nivelin aktual, 34% pro reduktimit të shpenzimeve për mbrojtjen dhe 19% pro rritjes së tyre. Pa dyshim që këto përgjigje përbëjnë më shumë një informacion rreth ndjesive popullore sesa një llogaritje të saktë të Prove dhe Kundrave të secilit opSION politikash të mundshëm. Për një buxhet kombëtar mbrojtja është një nga pak elementët ku reduktim në shpenzime nuk përfaqëson ndonjë veprim të vështirë, sidomos sepse shumë prej shpenzimeve për të iu transferohen investimeve, duke pasur një efekt të thellë vetëm në të ardhmen. Për më tepër, mbrojtja perceptohet shpesh prej popullatës si një sektori i izoluar dhe joetik (dy luftërat në Afganistan dhe Irak ishin shumë jopopullore në Europë). Kjo çoi në bindjen se është më mirë të shpërndash burimet për adresimin e vështirësive të brendshme sesa për të zgjidhur problemet larg vendit tënd.

Tendenca në rënie duket se është shumë kritike duke qenë se kapacitetet e mbrojtjes degradojnë shpejt por nga ana tjetër janë të vështira për t'u rindërtuar. Pavarësisht tendencës së përbashkët në rënie brenda BE-së (mesatarisht 5.9%) ndikimi i presioneve të buxhetit ndryshon dukshëm ndërmjet vendeve anëtare duke reflektuar nivelet e ndryshme të rëndësisë që shtetet i japin politikave për mbrojtjen. Pavarësisht faktit se mbrojtja ka luajtur gjithmonë një rol të rëndësishëm në politikën kombëtare britanike, ky fakt nuk pengoi qeverinë për të bërë reduktime të forta. Buxheti britanik për mbrojtjen do të përballlet me një reduktim prej 8% gjatë periudhës 2011-2014 duke përfshirë çmontimin e aeroplanmbajtëseve, heqjen e avionëve Harrier, vonesa në modernizimin e nëndetëseve Trident dhe tërheqjen e të gjithë trupave britanikë nga Gjermania. Edhe Franca, pavarësisht interesave të saj të forta nacionaliste është detyruar të bëjë kursime të mëdha (thuajse 3.5 miliardë Euro gjatë periudhës 2011-2013) duke vendosur për reduktimin me 8000 punëtorë të stafit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe duke vonuar procesin e përmirësimit të avionëve gjuajtës Mirage. Ministri i Mbrojtjes gjerman ka miratuar një program prej 8.3 miliardë Euro reduktime në shpenzime gjatë periudhës 2011-2014 duke reduktuar fuqinë punëtore nga 250.000 në 185.000 dhe me heqjen e rekrutimit ushtarak. Në të njëjtën kohë megjithatë numri

i trupave të dislokuara parashikohet të dyfishohet nga 7.000 në 14.000. Reduktimet kanë prekur gjithashtu Italinë e cila është e detyruar të reduktojë buxhetin me 10% gjatë periudhës 2011-2014. Kjo ka çuar në reduktimin e stafit komandues të avionëve Eurofighter në 25 avionë (nga një total prej 121 të tillë aktualisht) si dhe në reduktime në anije ushtarake.

Pavarësisht tendencës së përbashkët për reduktime në mbrojtje ekzistojnë pa dyshim disa shembuj pozitivë. Megjithatë ekzistojnë pa dyshim disa shembuj pozitivë. Danimarka planifikon një rritje të buxhetit të saj ushtarak me 8% gjatë periudhës 2010-2014, qeveria polake rriti buxhetin e saj të vitit 2011 me 7% (kryesisht në sektorin e investimeve me një rritje prej 16%) dhe Suedia vendosi të mbante buxhetin e mbrojtjes në nivele të njëjta duke hequr njëkohësisht rekrutimin ushtarak.

Të tre vendet që marrin aktualisht asistencë financiare ndërkombëtare (Greqia, Irlanda dhe Portugalia) kanë bërë reduktime të dukshme në buxhetet e tyre ushtarake duke u përballur me humbje të kapaciteteve të tyre ushtarake. Këto reduktime kanë një domethënie të veçantë për Greqinë për shkak të rëndësisë së mbrojtjes në këtë vend. Për një kohë të gjatë në fakt Greqia është renditur e para në Europë për përqindjen e PPB-së që i jepej mbrojtjes (3.2% në vitin 2009) për shkak të tensioneve të vazhdueshme me rivalin e saj Turqinë dhe me një popullsi prej 11 milionësh, ajo është importuesi më i madh i armëve konvencionale në Europë. Pavarësisht rrëshqitjes së vendit në recesion ekonomik, buxheti kombëtar u rrit me 5% në vitin 2009 për t'u reduktuar më pas me 7% në vitin 2010 dhe reduktimet që planifikohen për vitet e ardhshme shkojnë në 330 milionë Euro. Buxheti për pajisjet shkon deri në 1.8 miliardë Euro duke mundur minimalen e burimeve të mjaftueshme për të mbajtur efikasitetin ekzistues pa planifikuar blerje të reja dhe duke vonuar projektet që janë ndërmarrë më parë. Në një situatë tensionesh në rritje në Qipro dhe sidomos duke u përballur me reduktime të pakrahasueshme në buxhetin e mbrojtjes së Turqisë, zbatimi i masave të ashpra për të cilat është rënë dakord gjatë negociimit të planit ndërkombëtar duket se do të ketë kosto politike të lartë për qeverinë greke.

Kjo situatë është veçanërisht e rrezikshme në Europë duke qenë se politikat kombëtare të mbrojtjes janë ende shumë të lidhura me skemat e Luftës së Ftohtë. Shumë ushtri europiane për shembull bazohen në rekrutimin kombëtar (Austria, Qipro,

Danimarka, Estonia, Finlanda, Greqia dhe Suedia) ose e kanë hequr atë vetëm gjatë dekadës së fundit ose edhe më vonë (Bullgaria, Gjermania, Letonia, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia). Për më tepër kjo ashpërsi nuk lejon operacionalitet të ushtrive të BE-së (më pak se 4% e trupave europiane janë dislokuar nëpër misione krahasuar me 16% të SHBA-së) dhe as që buxhetet ushtarake të kenë fleksibilitetin e duhur për t'iu përgjigjur në mënyrë efikase reduktimeve aktuale. Si përgjigje e parë ndaj reduktimeve buxhetore dhe ngushtimit të shpenzimeve për personelin, shumë vende po reduktojnë programet e tyre për modernizimin dhe armatimet ose po vonojnë kohën e heqjes nga përdorimi të programeve aktuale të pajisjeve. Kjo praktikë sado e mirë për mundësimin e kursimeve në një kohë të shkurtër rrezikon zgjerimin e deficitit aktual në efikasitet të ushtrisë të BE-së dhe në të njëjtën kohë rrit kostot e mirëmbajtjes duke neutralizuar kështu kursimet e dëshiruara në terma afatgjatë. Përballja me presionin publik për reduktimin e shpenzimeve ushtarake nuk është një detyrë e lehtë për qeveritë europiane dhe kjo tendencë nuk do të ndryshojë as në terma afatmesëm. Duke u përballur me këtë perspektivë, ekziston vullneti i pakët për të vazhduar koherencën europiane për kapacitetet e mbrojtjes duke çuar në rritje të inkoherencës së instrumenteve të mbrojtjes dhe duke dëmtuar krijimin e një sistemi ushtarak të integruar europian. Rreziku i inkoherencës në instalimin e kapaciteteve përbën një sfidë kryesore për Europën. Shpesh, reduktimet udhëhiqen nga një nevojë afatshkurtër për ekonomizim pa analizuar pasojat afatgjata të ndonjë reduktimi specifik në kontekstin europian. Seksioni tjetër do të përpiqet të analizojë shkurtimisht se cilat janë arsyet kryesore prapa këtyre inkoherencave të paqëndrueshme në politikën e mbrojtjes në nivel BE-je.

Libia - një provë reale për politikën e mbrojtjes së BE-së

Mësimet nga Libia dhe nga thirrja e NATO-s për më tepër bashkëpunim shumëpalësh për ndërtim kapacitetesh përbëjnë një stimul të dytë të brendshëm i cili ka të njëjtën rëndësi me luftërat e Ballkanit për lancimin e politikës së mbrojtjes dhe sigurisë të BE-së. Fakti se mungesa e BE-së në krizën libiane shënoi fundin *de facto* të Politikës së Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë (PPMS) është një opinion që ndahet gjerësisht nga analistët. Kjo ndodhi më pak se 18 muaj pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës i cili synonte rritjen e efikasitetit të BE-së si aktor global. Siç thekson edhe Anand Menon, "Bashkimi Europian

qëndroi në anë të fushës dhe vëzhgoi se si Franca dhe Britania e Madhe duke vepruar në kuadër të NATO-s ndërhyjnë ushtarakisht në kufijtë e unionit.” (Menon, 2011). Një ngurrim i tillë *vis a vis* paaftësisë të BE-së për të vepruar si një ofrues sigurie me kapacitete të plota është i kuptueshëm. Kurdo që Europa shfaq kufizime titanike për menaxhimin e krizave ndërmjet fqinjëve të saj (për shembull në Ballkanin Perëndimor) BE-ja është në krye të kritikizmit publik. Pavarësisht risive që solli Traktati i Lisbonës dhe eksperiencës së grumbulluar pas thujse 10 vjetësh eksperience operacionale për menaxhimin e krizave, problemi mbetet i njëjtë siç ka qenë në fillimin e luftërave Jugosllave. Nga këndvështrimi ushtarak BE-ja nuk është e pajisur për këtë qëllim dhe nuk përmbush dot nevojat e sigurisë të anëtarëve të saj. Në fakt siç komenton edhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Rasmussen “nuk ka mungesë shtabesh (...) ajo që na mungon në Europë janë pajisjet ushtarake.” Këto fjalë duket të jenë tërësisht me vend në kuadrin e problemeve me të cilat u përballën aleatët europianë gjatë fushatës në Libi.

Kriza e Libisë ka treguar se ulja e shpenzimeve ushtarake dhe përhapja e konkurrencës nëpër shtetet europiane nuk përbëjnë një qasje të qëndrueshme për ambiciet globale të Europës. Mësimet që duhen nxjerrë për Europën janë shumë të qarta. Ushtritë e vogla dhe të pakoordinuara duhet të bashkohen dhe specializohen për të kursyer, evituar humbjen e resurseve dhe për optimizmin e kapaciteteve në sektorët e shpërndarë të mbrojtjes europiane. Për më tepër reagimi i SHBA në fillim të fushatës së NATO-s dhe strategjia e re e mbrojtjes që deklarohet nga Presidenti Obama dhe Sekretari i Mbrojtjes Leon Panetta në vitin 2012 konfirmon se Amerika po tërhiqet ngadalë por me vendosmëri nga Europa dhe se e ardhmja e përfshirjes në Europë në rastin më të mirë do të jetë e kufizuar (Marrone, 2012). Rrjedhimisht, ndërsa SHBA riorienton qëndrimin e saj ushtarak drejt skenave të Azisë dhe Paqësorit, perspektiva për një reduktim të armëve bërthamore konvencionale dhe taktike ka gjasa që të shtyjë udhëheqësit europianë që të konsiderojnë ndërmarrjen e lëvizjeve të paprecedenta në fushën e mbrojtjes. Luftërat e Ballkanit (veçanërisht bombardimi i Jugosllavisë nga NATO në vitin 1999) kanë qenë një çast vendimtar në marrëdhëniet transatlantike duke treguar se SHBA as nuk do të donte dhe as nuk do të mundte që të kujdesej për sigurinë e Europës pavarësisht kostos si dhe duke theksuar ndasitë e dhimbshme ndërmjet dy brigjeve të Atlantikut për sa i përket kapaciteteve dhe interesave strategjike. Kjo çoi eventualisht në miratimin e *Helsinki Headline Goal* (1999) për të pajisur Europën

me një mekanizëm për reagim të shpejtë brenda vitit 2003 si dhe i dha një zhvillim fenomenal PPMS-së. Dymbëdhjetë vjet më vonë, operacioni *Unified Protector* në Libi jo vetëm që tregoi progresin e pakët të arritur nga europianët për përmirësimin e kapaciteteve ushtarake që prej vitit 1999 por nxori në pah lidhjen e rrezikshme ndërmjet humbjes së relevancës strategjike të Europës dhe shqetësimit të SHBA-së për reduktimin e shpenzimeve për mbrojtjen e vendeve anëtare Europiane të NATO-s.

Këto dy zhvillime, mësimet nga fushata në Libi dhe tërheqja e SHBA-së nga Europa së bashku me klimën e shtrëngimeve financiare janë baza e thirrjes së NATO-s për më tepër bashkëpunim shumëpalësh për të rritur ndërtimin e kapaciteteve për mbrojtjen. Dhe duke qenë se ajo që ndodh në NATO rrallë përcillet pa jehonë në Bruksel agjenda për “mbrojtjen e zgjuar” po shtyn vendimmarrësit e BE-së për të kërkuar zëvendësues ndërmjet bashkëpunimeve për armatime transatlantike dhe europiane.

Një industri e mbrojtjes e transformuar në një botë shumëpolëshe

Së fundmi, ndryshimet që kanë ndodhur në nivel makro dhe që kanë rezultuar në tranzicionin drejt një bote shumëpolëshe gjithashtu po ushtrojnë presionin e tyre duke ngritur pyetje thelbësore mbi të ardhmen e industrisë globale të mbrojtjes dhe rolit të Europës në të. Rritja e madhe ekonomike dhe rritja rëndësisë në punët globale kanë shtyrë fuqitë në zhvillim (Kina, Rusia, India, Brazili, Turqia dhe Afrika e Jugut) që të forcojnë kapacitetet e tyre ushtarake, të përfshihen në programe të mëdha modernizimi të cilat kanë rezultuar në buxhete të mëdha për mbrojtjen. Rreziqet për sigurinë apo konfliktet në vendet fqinje, ambicia për të arritur statusin e fuqisë së madhe, prestigji dhe ndjesia e dobësisë kundrejt fuqive konkurruese janë faktorë që justifikojnë modernizimin ushtarak. Në shumicën e rasteve, fuqitë në zhvillim janë përpjekur gjithashtu që të zhvillojnë industritë kombëtare të armëve për të reduktuar varësinë e tyre nga importet, përtej diversifikimit tradicional të politikave për blerjen e armëve. Pasojat e këtyre dinamikave për Europën janë të dyfishta. Së pari, tregu i mbrojtjes po bëhet më konkurrues (Gallois, 2012). Ndërsa industritë e reja kombëtare zhvillohen dhe hyjnë në treg, në terma afatmesëm ka gjasa që kompanitë perëndimore të përballen me konkurrencë në rritje nga

prokuruesit jo Perëndimorë. Së dyti, nëse trendi aktual në shpenzime ushtarake nuk ndryshon, kompanitë europiane do të detyrohen të rritin numrin e kontraktorëve të huaj të cilëve iu shesin sistemet e tyre të armatimit për të kompensuar rënien në kërkesat për pajisje ushtarake si rrjedhojë e reduktimeve buxhetore.

Ekonomia e shpenzimeve ushtarake të BE-së

Gjasat për një ndryshim efikas në politikën e mbrojtjes së BE-së lidhen ngushtësisht me mjedisin ekonomik ku ajo vepron. Edhe pse nëpërmjet analizës ekonomike, ky seksion thekson dobësitë kryesore aktuale të Tregut European të Pajisjeve të Mbrojtjes (TEPM) i cili po prodhon mungesa efektshmërie të cilat tashmë duket se janë të papranueshme. Përmirësimi i këtij sistemi përfaqëson aktualisht opsionin politik më të lehtë dhe më të menjëhershëm që synon të lejojë vendet anëtarë të BE-së që të racionalizojnë shpenzimet e tyre dhe të përftojnë rezultate më të mira duke përdorur një sasi burimesh më të pakët ose të njëjtë.

Një treg i përbashkët i mbrojtjes i papërfunduar

Aktualisht tregu european i mbrojtjes karakterizohet nga prezenca e një shumëllojshmërie industrish kombëtare të cilat kanë format e tyre të proteksionit dhe interesat kombëtare përkatëse. Në vitin 2010 tre të katërtat e investimeve europiane për mbrojtjen u mundësuan nga kompanitë europiane dhe çereku i mbetur erdhi prej importeve, programeve të brendshme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe nga heqja e burimeve në sektorin civil (ASD, 2010). Megjithatë përpara se të analizojmë elementët që përbëjnë këtë treg të veçantë (kërkesën dhe ofertën) është thelbësore të kuptojmë nëse një “treg” i tillë ekziston në Europë. që do të thotë nëse kushtet për një shkëmbim fitimprurës ndërmjet kërkesës dhe ofertës janë prezente.

Neni 346 i Traktatit të Lisbonës për Funkcionimin e Bashkimit European (TFBE), i cili përjashton prodhimin dhe eksportin e armëve nga rregullat që menaxhojnë tregun e përbashkët përbënte për një kohë të gjatë pengesën kryesore për krijimin e TEPM dhe shpjegon përmbajtjen e vendeve anëtare në këtë fushë. Pavarësisht një dispozite të qartë në TFBE dhe thirrjes së drejtpërdrejtë nga Komisioni European për të kufizuar zbatimin e tij vetëm për “rastet strategjike”, vendet anëtarë kanë abuzuar

me këtë opion në të shkuarën duke zgjeruar fushën e tij të veprimit dhe duke krijuar artificialisht kushtet për ekzistencën e një numri të madh përjashtimesh që nuk do të kishin qenë financiarisht të qëndrueshëm në kushtet e tregut të lirë. Për të arritur këtë secili anëtar i BE-së kërkoi autorizim individual për çdo lëvizje ndërkombëtare të komponentëve që lidhen me mbrojtjen, duke krijuar kështu pengesa formale që kushtojnë më shumë se 3 miliardë Euro në vit sipas statistikave të Komisionit Europian (O'Donnell, 2009).

Megjithatë vitet e fundit situata ka pësuar një përmirësim të lehtë. Në vitin 2004 falë punës së Presidencës Greke të BE-së, u krijua Agjencia Europiane e Mbrojtjes (AEM) për të mundësuar bashkëpunim më të madh ndërmjet vendeve anëtare në sektorin e mbrojtjes dhe për të lehtësuar krijimin e TEMM-së. Gjatë periudhës korrik 2006 - dhjetor 2011, 700 oferta për kontrata u publikuan në buletin elektronik të TEMM-së (portali i Agjencisë ku qeveritë dhe industritë europiane publikojnë mundësitë e tyre për kontrata) (EDA, 2012). Edhe pse duket mbresëlënëse, shumica e kontratave të dhëna nuk u përfunduan dhe kontratat nën 5.8 miliardë Euro nuk ishin subjekt i konkurrencës në BE.

Një tjetër hap më i madh përpara u ndërmor në vitin 2009 falë dy direktivave (Direktiva 2009/43/EC dhe Direktiva 2009/81/EC) të cilat hynë të dyja në fuqi pas gushtit të vitit 2011. E para thjeshtëzonte rregullat për transferimin e produkteve që lidhen me mbrojtjen ndërmjet vendet anëtarë të BE-së duke thjeshtuar procedurat për autorizimet e eksportit brenda TEMM-së (duke krijuar licenca të përgjithshme në vend të individualeve) dhe duke synuar kështu ristrukturimin e kompanive të mbrojtjes në Europë në mënyrë më komunitare (duhej që të lehtësonte formimin e kompanive Europiane të cilat kishin kapacitetet e prodhimit të vendosura në disa vende anëtare të BE-së). Qëllimi i direktivës së dytë ishte të hapte tregun e prokurimeve të mbrojtjes dhe sigurisë për të reduktuar ekskluzivitetin e kompanive kombëtare dhe për të krijuar një treg të përbashkët. (Gjatë periudhës 2000-2004 më pak se 13% e të gjithë mundësive për të tenderuar për prokurimet e mbrojtjes europiane u publikuan (EDA, 2010)). Për më tepër këto dy Direktiva ratifikojnë hyrjen e Komisionit Europian (dhe të shpirtit të tij joqeveritar) në menaxhimin e tregut të mbrojtjes pas një periudhe të gjatë kur ndërhyrja e tij ishte kufizuar. (Komisioni ka qenë shumë i vullnetshëm për denoncimin e shteteve përpara gjykatës për çështje që lidhen me Nenin 296).

Problemet nga ana e kërkesës

Pasi kemi analizuar kushtet dhe joefektshmëritë nën të cilat ndodhin shkëmbimet në tregun e mbrojtjes së BE-së do të përqendrohemi te dy komponentët e tij. Nga ana e kërkesës qeveritë kombëtare përfaqësojnë pa asnjë kontestim faktorin kryesor kur vendoset për politikat e shpenzimeve. Pra, vendet anëtare hartojnë specifikime të prokurimeve me qëllimin e drejtpërdrejtë të kontraktimit të industrive prodhuese kombëtare të mbrojtjes dhe për të mbajtur kështu kontroll të plotë të sovranitetit të njohurive kombëtare në prodhimin e mbrojtjes. NATO pavarësisht rolit të saj kryesor si organizatë ndërkombëtare e mbrojtjes dhe formimit të një platforme për bashkëpunimin e të gjithë vendeve anëtarë nuk ka arritur të bindë shtetet europiane që të tejkalojnë ose minimalisht të reduktojnë faktorët politikë kombëtarë. As themelimi i Politikës Europiane të Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe i Agjencisë Europiane të Mbrojtjes nuk kanë ndryshuar rrënjësisht këtë aspekt strukturor sepse ndikimi i tyre ka qenë i pamjaftueshëm për gjenerimin e procedurave të përbashkëta ose për krijimin e konvergencës në sektorët kryesorë të bashkëpunimit për armatimet, prokurimet dhe mbrojtjen. Thjesht duke parë të dhënat tregohet se si prokurimet e përbashkëta europiane përfaqësojnë forumin bashkëpunues që përdoret më shpesh nga vendet anëtare si edhe gjithashtu si ky mekanizëm nuk është zhvilluar gjerësisht duke qenë se prokurimet totale kanë mbetur në 20% gjatë katër viteve të fundit.

Edhe pas institucionalizimit të AEM dhe ndryshimit pasues nga një sistem ndërqeveritar dhe tërësisht *ad hoc* drejt një qasjeje më sistematike dhe më të menaxhuar prej BE-së principi i “*juste retour*” përbën qasjen kryesore të qëllimeve të vendeve anëtare. Sipas këtij principi industria e secilit vend pjesëmarrës do të marrë një pjesë të punës që i korrespondon kontributit financiar të qeverisë përkatëse. Edhe pse ky sistem në teori siguron një rishpërndarje të aktivitetit sipas kapaciteteve të secilit shtet, rezultati final shpesh ka qenë jo efikas duke qenë se ka reduktuar seriozisht fleksibilitetin e programeve të ndryshme dhe mbi të gjitha sepse shpërndarja është bërë jo sipas kapaciteteve por sipas konsideratave politike kjo ka reduktuar në vend që të ngrejë efikasitetin e projektit (Schmitt, 2003).

Problemet nga ana e ofertës

Mungesa e konsolidimit nga krahu i kërkesës ka çuar në mënyrë të paevitueshme drejt një sistemi të ndarë të industrive

të mbrojtjes të BE-së që përbëhet nga një sërë industrish kombëtare secila me interesat kombëtare përkatëse (disa ende nën kontrollin e qeverive). Në këtë kontekst struktura e ofertës së TEPM përbëhet nga 20 kompani të mëdha (kontraktorët kryesorë), një grup i dytë prej rreth 100 kompanish të mesme (zakonisht të nënkontraktuara dhe të specializuara në komponentë të pjesëve, elektronikë etj.) dhe së fundmi nga një numër i madh prodhuesish të pjesëve të specializuar dhe ofruesish shërbimesh (pajisje elektrike dhe elektronike, inxhinieri mekanike etj.) të cilët veprojnë në periferi të sektorëve të mbrojtjes dhe janë kryesisht ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Pozicioni i industrisë së mbrojtjes së BE-së në tregun botëror është padyshim i fuqishëm duke u renditur e dyta pas SHBA. Në vitin 2004, 44 nga 100 kompanitë kryesore për prodhimin e armëve bazoheshin në BE duke mbuluar gati 30% të shitjeve botërore të armëve (duke përfshirë kompanitë kineze).

Shifrat tregojnë qartësisht se si prioriteti kryesor i jepet kompanive amerikane që përfaqësojnë 60% të tregut botëror. Megjithatë dominimi i SHBA është edhe më i dukshëm kur krahasohet numri i kompanive në 25 firmat kryesore prej të cilave vetëm 9 nuk bazohen në SHBA.

Rëndësia e madhe që iu jepet interesave sovrane dhe preferencave kombëtare të veçanta të shpenzimeve ushtarake të vendeve anëtare kanë sjellë një situatë në të cilën industria e mbrojtjes në BE reflekton kryesisht përqindjen e buxheteve të ndryshme kombëtare. Katër industritë më të mëdha kombëtare (Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Gjermania) mbulojnë thuhetse 70% të të gjithë tregut të mbrojtjes së BE-së (90% nëse konsiderohen edhe firmat transeuropiane si EADS dhe MBDA). Kjo situatë me përqendrim të lartë megjithatë nuk reflekton një përqendrim të krahasueshëm në numrin e firmave. Dy të tretat e firmave të mbrojtjes së BE ndodhen jashtë këtyre katër vendeve duke rezultuar në një shpërndarje të madhe dhe në një strukturë të fragmentuar që është jo efikase nga këndvështrimi ekonomik. Për të kompletuar përshkrimin e situatës duhet theksuar se momentalisht vetëm duke marrë në konsideratë 50 kompanitë kryesore të mbrojtjes së BE-së, 13 prej tyre janë prodhues avionësh, 10 prodhues raketash, 9 prodhues mjjetesh ushtarake dhe 8 prodhues anijesh. Kjo situatë duket jo efikase nëse krahasohet me atë të SHBA, e cila ka një treg mbrojtjeje dy herë më të madh. Ajo ka 12 prodhues avionësh, 5 prodhues raketash, 8 prodhues mjjetesh ushtarake dhe vetëm 4 prodhues anijesh.

Ky përqendrim i lartë është kryesisht rezultati i një zgjidhjeje të qartë politike të bërë nga Departamenti i Mbrojtjes i SHBA në vitin 1993 pas rënies së Murit të Berlinit (Edwards, 2011). Në kontekstin e reduktimeve të planifikuara në buxhetin e mbrojtjes 15 firmave kryesore të mbrojtjes iu kërkua që të ndërmerren politika konsoliduese për të mbijetuar falë sasisë më të madhe të ekonomive të shkallëzimit që përftoheshin në këtë mënyrë.

Në Europë, në fillimin e viteve '90 procesi i konsolidimit u zhvillua kryesisht në nivel kombëtar me krijimin e shembujve kombëtarë (Bergstrom et al., 2008). Kompanitë që rezultuan nga kjo megjithatë tani duket se nuk janë mjaftueshëm të mëdha për të performuar efektivisht në tregun aktual të mbrojtjes. Në këtë skenë vetëm EADS përfaqëson një produkt efikas të përpjekjeve pozitive të bëra nga qeveritë e BE-së për ndërmarrjen e politikave bashkuese në nivel evropian. Në shumicën e rasteve kur firmat evropiane vendosin të bashkëpunojnë, strategjia e preferuar ka qenë krijimi i konsorciumeve shumëkombëshe *ad hoc* (Eurofighter) ose i sipërmarrjeve të përbashkëta. (MBDA, Agusta Westland) të dyja prej të cilave kanë lejuar firmat që të ruajnë identitetin e tyre kombëtar. Pranimi i blerjes së një firme nga një vend tjetër anëtar i BE-së ka qenë një politikë thuajse e papranueshme për shumicën e vendeve anëtare. Për më tepër shumë industri (si Finmeccanica në Itali dhe Thales në France) ende kanë si aksioner shtetin ose janë të kontrolluara në mënyrë indirekte prej tij me anë të të drejtave speciale (si për shembull "pjesën e artë" në Mbretërinë e Bashkuar) duke lejuar që qeveritë kombëtare të orientojnë strategjinë e firmave. Në situatën kur ekzistojnë pak firma ndër-kombëtare të konsoliduara plotësisht në BE, Thales përbën një përjashtim të pjesshëm. Firma u krijua nga CSF dhe Dassault Electronique dhe British Racal Electronics.

Kjo situatë justifikohet bindshëm nga këndvështrimi politik (humbja e sovranitetit mbi kapacitetet për mbrojtjen përbën një rrezik të madh potencial duke qenë se procesi i rindërtimit të kompetencave në këtë fushë është një aktivitet i gjatë dhe i kushtueshëm). Megjithatë kjo situatë është dyfish jo ekonomike. Nga njëra anë ajo përfaqëson një kufizim të fortë për të arritur procesin e shumë nevojitur të konsolidimit (njësoj me atë që u zbatua në SHBA pas Luftës së Ftohtë) i cili është thelbësor në një sektor me përfitime të larta ekonomike dhe parandalon krijimin e gjigantëve të industrisë së mbrojtjes në BE të aftë për të konkurruar me sukses me homologët e tyre në SHBA. Nga ana

tjetër, kjo nuk lejon as shfrytëzimin e avantazheve të konkurrencës që krijohen nga prezenca e industrive të njëjta për shkak të preferencave kombëtare të ndara të shpenzimeve ushtarake të vendeve anëtare.

Fragmentizimi i madh i tregut të mbrojtjes të BE-së sjell në mënyrë të paevitueshme pamundësinë për të fituar nga përfitimet ekonomike. Pavarësisht prezencës së një kostoje fikse të lartë në sektorin e mbrojtjes, industritë e BE-së nuk janë të afta të reduktojnë këtë kosto duke rritur prodhimin e tyre duke gjeneruar më tepër ekonomi të shkallëzimit dhe ekonomi të shtrirjes. Situata paraqitet krejt ndryshe në SHBA ku prezenca e një tregu të madh të përbashkët lejon që firma të zgjerohet duke krijuar një botë më të madhe lojtarësh të aftë jo vetëm për të vepruar me përfitime më të larta por mbi të gjitha për të konkurruar në tregun botëror të mbrojtjes. Në fakt, aktualisht pavarësisht kontributit relativisht të rëndësishëm të eksporteve të BE-së (industria e aeronautikës përfaqëson 2.6% të totalit të eksporteve të jashtme të BE-së) aftësia e industrive të mbrojtjes së BE-së për të penetruar në tregun e jashtëm është e kufizuar krahasuar me SHBA-në. Shkaku i këtij fragmentimi në krahun e ofertës është rezultati i natyrshëm i fragmentizimit të tregut në krahun e kërkesës. Numri i lartë i firmave kombëtare që prodhojnë shumë lloje pajisjesh të ngjashme të cilat prodhohen në sasi të ulëta për secilin treg kombëtar. Kjo dilemë është rezultat i natyrshëm i organizimit të tregut i cili nuk bazohet në nivelin e BE-së por kryesisht në nivel kombëtar.

Rruga përpara: Nga Ghenti në Çikago, a mundet Europa që të virtytizojë domosdoshmërinë?

Edhe pse ndërmarrjet kombëtare të mbrojtjes mund të kundërshtojnë këtë proces për të mbrojtur interesat e tyre afatshkurtra, pritjet që debati në BE për mbledhjen dhe përdorimin e përbashkët të burimeve të intensifikohet i nxitur nga shtytjet që vijnë nga NATO. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për Kuadrin e Ghentit dhe agjendën e NATO-s për mbrojtjen e zgjuar që ato të zbatohen së bashku sidomos pas Samitit të Këshillit të Atlantikut të Veriut në Çikago (maj 2012). Në fakt pavarësisht pengesave që hasen në rrugën për zbatimin e integritit ushtarak, kuadri shumëpalësh i BE-së është i mirëpajisur për të adresuar thirrjen e NATO-s për më tepër bashkëpunim shumëpalësh për të zgjidhur problemet e Europës me kapacitetet.

Për arritjen e këtij objektiv, është shumë e rëndësishme që rigjallërimi i Kuadrit të Ghentit të respektojë tre kushte “politike”: të shmangë çështjet që kanë ndjeshmëri politike, të veprojnë sipas agjendës trans-atlantike dhe të mbajnë pritshmëritë e publikut në nivele të ulëta.

Shmangia e çështjeve që kanë ndjeshmëri politike nënkupton që P&S e BE-së nuk duhet të përfshihet në debatin e lodhshëm për themelimin e një selie ushtarake të BE-së dhe për vendosjen e strukturave ushtarake të komandimit dhe kontrollit në nivel BE-je. Lidhja e të dy çështjeve në fakt do të mërziste disa vende anëtare që kundërshtojnë këtë zhvillim dhe mund të rrezikonte progresin në ndërtimin e kapaciteteve. Veprimi sipas agjendës transatlantike përfshin zbatimin e një “rrege europiane drejt mbrojtjes së zgjuar” duke respektuar 3 kritere (angl. 3d) (mosduplikimin, mosçiftëzimin dhe mosdiskriminimin) që përbëjnë bazën e marrëdhënieve NATO-BE. Së fundmi, duke mbajtur pritshmëritë e ulëta, vendimmarrësit duhet të tregojnë kujdes që të mos ngatërrojnë P&S me fillimin e një procesi që do të çonte drejt krijimit të një ushtrie europiane.

Nëse këto kushte do të mund të respektoheshin, zbatimi i Kuadrit të Ghentit do të kryhej sipas tre fazave:

- Rimodulimi i strategjisë për pajisjen me mjete të rënda ushtarake strategjike,
- Rishikimi i kuadrit të përbashkët të BE-së për kërkim dhe zhvillim dhe
- Krijimi i një tregu efikas dhe të përbashkët të mbrojtjes europiane për pajisjet jo strategjike

Rimodulimi i strategjisë për pajisjen me mjete të rënda ushtarake strategjike

Paefektshmëritë e sistemit të mbrojtjes së BE-së kanë ndikim më të madh te furnizimi me sisteme të armëve të rënda strategjike (tanke, anije, avionë etj.) për shkak të prezencës së kostove fikse të larta në zinxhirin e prodhimit. Megjithatë, në këtë sektor ka pak gjasa që vendet anëtare të pranojnë që të vendosin kapacitetet kombëtare të mbrojtjes në një “kazan të përbashkët” çka do të rezultonte në një humbje të papranueshme të autonomisë strategjike (në një sektor ku kapacitetet rindërtuese të humbura do të ishin shumë të kushtueshme). Pavarësisht kësaj është gjithashtu e vërtetë se shqetësimet buxhetore të mbrojtjes do të rezultojnë në reduktimin e hapësirës për manovrim duke gjeneruar si pasojë humbjen e autonomisë.

Për sa i përket krahut të kërkesës, mënyra për zgjidhjen e problemit është ndërmarrë tashmë edhe pa pasur vullnetin e mjaftueshëm po duhet të ishte ndërmarrë, edhe pa pasur vullnetin e mjaftueshëm. Bashkëpunimi më i ngushtë është politika e duhur për mbajtjen e konsideratave strategjike kombëtare në sektorin e mbrojtjes dhe për të lejuar vendet anëtare që të pajisen me kapacitete që ata nuk do të ishin të aftë t'i blinin individualisht me një kosto të pranueshme. Megjithatë kuadri aktual i bashkëpunimit (OCCAR, AEM, marrëveshjet dypalëshe, dokumentet e qëllimeve, konsorciumet *ad hoc* etj.) krijojnë paefektshmëri dhe konfuzion. Prandaj, nevojitet zgjedhja e një mekanizmi të standardizuar dhe të pranuar gjerësisht për themelimin e instrumenteve të BE-së. Sipas sugjerimeve të Biscop & Coelmont (2011), përdorimi parësor i BPS që mundësohet nga Traktati i Lisbonës mund të jetë thelbësor për këtë qëllim pasi do të kombinonte kriterin e qasjes ndërqeveritare dhe konsideratat kombëtare me modularitetin dhe bashkëpunimin. Pavarësisht pikëpamjes së Gjen. Lt. David Leakey (ish-drejtor i përgjithshëm i Shtabit Ushtarak të Bashkimit Europian) se “shumica e kapaciteteve ushtarake që i janë dhënë BPS aktuale janë minimale dhe nuk përbëjnë ndonjë vlerë të shtuar për mbrojtjen europiane” (Fiott, 2011), përdorimi më efikas i BPS mund të gjendet në këto komponentë të pajisjeve të rënda ushtarake strategjike. Kjo dritare që ofrohet nga Direktiva 2009/81/EC, në fakt lejon për një hapje të gjerë të tregjeve për prokurimin e këtyre pajisjeve për mbrojtjen duke lehtësuar kështu përdorimin e BPS-së. Një tjetër hap përpara do të ishte qartësimi asaj që përfaqëson BPS. Leakey argumenton se pavarësisht potencialeve të saj ambicioze, format e ndryshme të BPS sugjerojnë se qartësimi i përdorimit të tij mund të ofronte baza më solide për një bashkëpunim të ardhshëm (Fiott, 2011).

Koordinimi vetëm nga ana e kërkesës nuk do të mjaftonte për grumbullimin e kursimeve të mëdha. Duke theksuar sa më sipër, vetëm koordinimi i kërkesës nuk do të mjaftonte për të arritur kursime të mëdha. Krijimi i EADS (dhe subvencionimi i MBDA, Eurocopter dhe Eurofighter), duhet të shërbejnë si histori suksesi për rigjallërimin e sektorëve të tjerë të mbrojtjes. Aktualisht, Aerospace është e vetmja industri strategjike europiane që karakterizohet nga reduktimi i kostos, nga intensiteti i lartë në kërkim dhe zhvillim dhe nga zhvillimet në teknologji (Ecorys, 2010). Për më tepër sektori preket vetëm pjesërisht nga paefektshmëritë që ndikojnë një përqindje të madhe firmash të vogla, nga shfrytëzimi i pakët i ekonomive të

shkallëzimit dhe nga mbi kapaciteti duke qenë se magnituda e tyre nuk krahasohet me sektorë të tjerë. Sektori i pajisjeve tokësore për shembull është tërësisht i papranishëm në ndonjë ndërmarrje të përbashkët në nivel BE-je (me përjashtim të një rasti ndërmjet Nexter dhe BAE) çka sjell prezencën e po aq prodhuesve në BE sa në SHBA. Kjo ka prodhuar shpenzime më të ulëta për kërkim dhe zhvillim dhe në prodhueshmëri të ulët të punës (TNO, 2009).

Hartimi i programeve të përbashkëta të BE-së për kërkim dhe zhvillim

Zhvillimi dhe prodhimi i pajisjeve ushtarake strategjike lidhet me programet për kërkim dhe zhvillim. Shifrat tregojnë se niveli aktual i kërkimit dhe zhvillimit në BE është i pamjaftueshëm dhe, ajo që është më e rëndësishmja tejet jo eficient për shkak të ekonomive të shkallëzimit që janë prezent në këtë fushë. Për më tepër duke qenë se sektori është subjekt i vjetërimit, një reduktim i urdhëresave publike nga vendet e BE-së si rrjedhojë e shpenzimeve buxhetore mund të çojë në humbje të aftësive konkurruese, humbje të kapitalit njerëzor dhe në humbje të njohurive krahasuar me industrinë e SHBA dhe ato të vendeve në zhvillim duke prodhuar si rrjedhojë pasoja negative afatgjata. Prandaj është thelbësore që kompetencat aktuale teknologjike në nivele që mundësojnë pavarësinë strategjike të mbrojtjes së BE-së për vitet në vazhdim. Një bashkim më i madh i pjesëve për kërkim dhe zhvillim të buxheteve të mbrojtjes përbën një prioritet kyç për rritjen e efikasitetit për ndërtim kapacitetesh.

Deri tani, vendet anëtare kanë preferuar të kufizojnë programet e tyre kërkimore të përbashkëta tek iniciativat dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërqeveritare. Forcimi i sinergjive ndërmjet Komisionit vendeve anëtare dhe AEM do të lehtësonte lançimin e aktiviteteve të reja të përbashkëta dhe do të optimizonte burimet nën ombrellën e Kuadrit të Programit për Kërkim dhe Zhvillim (KPKZH) të cilit i mungon aktualisht krahu i mbrojtjes. Për periudhën 2007-2013 buxheti i ri për sigurinë brenda KPKZH-së (i cili u arrit falë një përpjekjeje politike të konsiderueshme prej Komisionit) ishte vetëm 2% e të gjithë shumës, (një shumë thuajse e pakonsiderueshme prej 1 miliardë euro nga 50 miliardë në total) (Liberti, 2011). Sistemi i ri duhet hartuar si vijon. Vendet anëtare duhet të përcaktojnë prioritetet për BE-në gjatë viteve në vazhdim duke treguar aspektet strategjike të cilët duhen zhvilluar. Në këto faza të hershme

Komisioni dhe AEM nuk duhet të përfshihen në atë që duhet të mbetet debat i udhëhequr prej vendeve anëtarë mbi strategjinë europiane të sigurisë, duke theksuar rolin e BE-së në fushën e sigurisë globale dhe si rrjedhojë për nevojat e mbrojtjes në dekadën e ardhshme.

Pas vendosjes së prioriteteve për kërkim dhe zhvillim AEM duhet të bëjë të disponueshme ekspertizën e saj për të përcaktuar strukturat e programeve kërkimore të cilat do të lancohen më pas nga Komisioni. Falë eksperiencës së tij afatgjatë të grumbulluar në kuadër të Programeve Bazë, Komisioni sigurisht që është struktura më e mirë për të siguruar menaxhimin efikas të projekteve. Në këtë kontekst principi i *“juste retour”* duhet braktisur duke qenë se ai nuk do të lejonte maksimizimin e granteve të marra nga programet bashkëpunuese. Një hap i mundshëm në këtë drejtim do të ishte forcimi i sferës së ndikimit të AEM duke lënë atë që të identifikojë kompetencat kryesore të vendeve anëtare në industri të caktuara të mbrojtjes krahas identifikimit tradicional të nevojave të mbrojtjes që kryhet nga vendet anëtare.

Vetëm duke pasur këtë panoramë të plotë të sektorit të mbrojtjes së BE-së AEM mund të jetë në pozicionin për të krijuar programe bashkëpunues të cilët nuk bazohen në principin e *“juste retour”*, por në atë të specializimit pra duke përfituar në efikasitet.

Treg unik të mbrojtjes europiane për pajisjet jo strategjike

Në kontrast me prokurimet strategjike prokurimet e pajisjeve të nivelit të ulët si municionet, armët dhe materialet e luftimit (veshje, mjete, pajisje për personelin etj.) mund të menaxhohen me lehtësi në nivel BE-je pa kërcënuar autonominë kombëtare. Kriza financiare iu ka dhënë disa vendeve të BE-së mundësinë për të rritur specializimin e tyre në fusha ushtarake specifike sidomos për vendet e vogla dhe të mesme të cilat nuk mund të mbajnë forca me kapacitet të plotë. Për shembull, Republika Çeke është përqendruar te mbrojtja NBK (nukleare/biologjike/kimike) dhe te mjetet elektronike, Luksemburgu ka shtuar specializimin në zbulim dhe Letonia në mjekësi dhe në mbështetje inxhinierike (Moling & Brune, 2011). Kjo tendencë mund të tregojë rrugën drejt një dispozite europiane më efektive për pajisjet jo strategjike për të përfituar tërësisht nga mësimi Rikardian i *“përfitimeve të përbashkëta nga specializimi”*.

Për të arritur këtë rezultat është kryesore që shtetet europiane të përcaktojnë qartë natyrën e “pajisjeve jo strategjike” duke mos lënë hapësirë për keqkuptime. Në këtë kontekst një rol të rëndësishëm mund të luhet si nga Komisioni European me anë të qasjes së tij jo qeveritare e zhvilluar tashmë në sektorë të tjerë ashtu edhe nga AEM. Falë njohurive specifike industriale dhe eksperiencës së mbledhur gjatë viteve të fundit AEM mund të marrë tipare të veçantë teknike për përcaktimin e këtyre pajisjeve. Pasi të jetë arritur kjo, AEM do të duhet të zhvillojë procesin e saj të standardizimit në këtë fushë duke zhvilluar kësisoj tipare të veçanta dhe më të mira të këtyre produkteve për të lancuar një iniciativë të përbashkët të BE-së për prokurimet ose së paku për të institucionalizuar një kuadër të përbashkët të BE-së ku të gjithë firmat private të saj mund të referohen për të hartuar strategjitë e tyre të ofertave. Sidomos për sa i përket sektorit të pajisjeve jo strategjike në fakt Materiel Standardization Group (i përbërë nga standardizimi i ekspertëve të vendeve anëtare) mund të arrijë shpejt rezultate të mira dhe ndoshta edhe më shumë kursime në buxhet për Ministrinë e Mbrojtjes se sa proceset e gjata për të përcaktuar pajisjet e përbashkëta të sofistikuar teknike.

Për të arritur këto suksese nevojitet që kjo procedurë të ndryshojë gjithnjë e më shumë nga një qasje tërësisht ndërqeveritare drejt një qasjeje komunitare për të reduktuar ndasitë kombëtare gjatë procesit të përcaktimit. Në fakt, pasi specifikimet e produkteve jo strategjike u përcaktuan (duke eliminuar interesat kombëtare) tregu përkatës mund të ishte tërësisht i integruar në BE dhe mund të aplikonte të gjithë rregullat bazë ekonomike të tregtisë ndërkombëtare duke çuar kësisoj drejt përfitimeve në efikasitet dhe drejt uljes së kostove për të gjithë vendet e BE-së.

Për të siguruar funksionimin efikas të TEPM-së për pajisjet jo strategjike hapat bazë janë ndërmarrë tashmë. (Dy direktivat, krijimi i Bordit të Buletinit Elektronik të AEM, krijimi i Kodit të Sjelljes për Prokurimet e Mbrojtjes dhe Kodit të Praktikave më të mira në zinxhirin e furnizimit ndërmjet industrive.) Së bashku këto mundësojnë elementët në terren që sigurojnë pasjen e një mjedisi ku mund të punohet për këto lloj politikash. Pra i vetmi element shtesë që nevojitet është vullneti politik që lejon një funksionim real dhe sistematik të këtyre instrumenteve. Një zgjidhje e cila nuk mund të shtyhet për shkak të gjendjes aktuale të buxhetit të vendeve anëtare.

Konkluzione

Shpërndarja e fuqisë në sistemin ndërkombëtar po ndryshon. Pavarësisht supremacisë të pakontestueshme të SHBA-së në sektorin e mbrojtjes, fuqitë në zhvillim po realizojnë marrëveshje të mëdha për mbrojtjen dhe po rritin buxhetin e tyre për mbrojtjen duke përdorur pjesë të fitimeve të tyre ekonomike për projektimin e kapaciteteve të forcës. Në këtë kontekst është bërë e qartë se vendet anëtare të BE-së nuk mund të veprojnë si lojtarë globalë duke u mbështetur në financat e luhatshme kombëtare. Vendet e BE-së po përballen me rrezikun për të humbur rëndësinë e tyre strategjike gjatë viteve të ardhshëm duke qenë se reduktimet buxhetore po rrezikojnë seriozisht aftësitë e tyre për t'u përballur me sfidat e ardhshme në fushën e mbrojtjes. BE-ja duhet të përfitojë nga dritarja e mundësive që i ofron Traktati i Lisbonës për rritjen e bashkëpunimit dhe nga qasja e mbrojtjes së zgjuar të NATO-s për racionalizimin e tregut të saj të mbrojtjes. Një rivitalizim i Kuadrit të Gjentit duhet të çojë drejt një bashkëpunimi më të madh në blerjen e pajisjeve ushtarake strategjike, bashkimin e resurseve për kërkim dhe zhvillim dhe në realizimin efikas të TEPM-së për pajisjet jo strategjike.

Ky studim ka theksuar se “kësaj radhe është ndryshe” dhe mbledhja dhe përdorimi i përbashkët nuk përbën më tabu për shkak të ekzistencës së tre stimujve të jashtëm: ndikimit të krizës ekonomike në zonën euro mbi buxhetet për mbrojtjen, mësimet ushtarake nga Libia dhe thirrjes së NATO-s për më shumë bashkëpunim shumëpalësh për ndërtimin e kapaciteteve të mbrojtjes dhe lidhjes së qartë ndërmjet transformimit në industrinë globale të mbrojtjes dhe tranzicionit drejt një bote shumëpalëshe. Gjithashtu, theksohet se operacionalizimi i suksesshëm i Kuadrit të Gjentit varet nga depolitizimi i debatit dhe nga lidhja (dhe përputhshmëria) me agjendën e NATO-s. Së fundmi, studimi ynë sugjeron së një plan për P&S duhet të bazohet mbi tre shtylla. Në shtyllën e parë (pajisjet strategjike) fokusimi te “praktikat më të mira” (për shembull roli i AESM në sektorin e aeronautikës) mund të prodhojë nxitje zinxhir të rëndësishme dhe të krijojë efekte konkurrues për pajisjet e rënda ushtarake për forcat tokësore dhe për sektorin detar. Kjo e fundit do të ishte veçanërisht e dobishme si rezultat i aktivizmit të BE-së për të kontribuar në sigurinë detare (si për shembull Operacioni Atlanta) dhe në kuadër të rëndësisë në rritje të operacioneve detare brenda PPMS-së. Në shtyllën e dytë (programet për kërkim dhe zhvillim) një ndarje më e mirë e punës ndërmjet vendeve anëtare

(përgjegjëse për përcaktimin e prioriteteve strategjike për vitet e ardhshëm nëpërmjet rishikimit të Strategjisë Europiane për Sigurinë), AEM (përgjegjëse për operacionalizimin e nevojave strategjike të BE-së me anë të hartimit të programeve për kërkim dhe zhvillim) dhe Komisionit European (menaxhuesi i projekteve ose zbatuesi i tyre) mund të krijojnë sinergji të paprecedent sidomos nëse shtetet shprehin vullnetin për të braktisur principin e “*juste retour*”. Së fundmi, në shtyllën e tretë (pajisjet jo strategjike) mësimi rikardian i përfitimeve të përbashkëta nga specializimi mund të pajisë BE-në me ushtri më efikase, më efikase në kosto dhe më të integruara.

REFERENCAT

- AeroSpace and Defence Industries Association of Europe (ASD) (2010), “Facts and Figures 2010”.
- Andries, J. (2011) “The 2010 Belgian EU Presidency and CSDP”, Egmont Institute Security Policy Brief No. 21, Egmont, Brussels, April.
- Bergstom, O. et al. (2008), “European Defence Industry Anticipating Restructuring”, BIPE, March.
- Biscop, S. (ed.), (2005), “E Pluribus Unum? Military Integration in the European Union”, Egmont Paper No. 7, Egmont, Brussels, June.
- Biscop, S. and J. Coelmont (2011), “Pooling and Sharing: From Slow March to Quick March?”, Egmont Institute Security Policy Brief No. 23, Egmont, Brussels, May.
- Cardoso Reis, B. (2009), “Europeans are from Athens: European Strategic Culture and the deepening of ESDP in an enlarged EU”, paper based on discussions held at the Lisbon conference on “New Perspectives for European Security”, EU-Consent.
- Cristos, K. et al. (2007), “A panel data analysis of the nexus between defence spending and growth in the European Union”, Defence and Peace Economics, Vol. 18(1), February.
- DeYoung, K. and G. Jaffe (2011), “NATO runs short on some munitions in Libya”, Washington Post, 16 April.
- Ecorys (2010), “FWC Sector Competitiveness Studies - Study on the Impact of Emerging Defence Markets and Competitors on the Competitiveness of the European Defence Sector”, Final Report, February.
- Edwards, J. (2011), The EU Defence and Security Procurement Directive: a Step Towards Affordability?, Chatham House,

- Royal Institute of International Affairs London, August.
- European Defence Agency (2010), "EDA Annual Report 2009", Brussels.
- _____ (2011), "EDA's Pooling and Sharing", EDA Facts Sheets, November, Brussels.
- _____ (2012), "EDA Annual Report 2011", Brussels.
- European Parliament and Council (2009), Directive 2009/43/EC, "Simplifying terms and conditions of transfers of defence-related products within the Community", 6 May.
- European Parliament and Council (2009), Directive 2009/81/EC, "On the coordination of procedures for the award of certain works contracts, supply contracts and servile contracts by contracting authorities or entities in the fields of defence and security", 13 July.
- European Union (2003), "A Security Europe in a Better World", European Security Strategy (<http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/78367.pdf>).
- _____ (2008). "Providing security in a changing world", Report on the Implementation of the European Security Strategy (ESS Review)(www.consilium.europa.eu/showpage.aspx?id=266&lang=EN.)
- Fiott, D. (2010), "Is Permanent Structured Cooperation a Workable Way towards EU Defence?", Madariaga – College of Europe Foundation, Citizen's Controversy Report.
- Gallois, D. (2012), "Un marché de la défense de plus en plus concurrentiel", Le Monde, 2 April.
- Giegerich, B. (2006), European Security and Strategic Culture, Baden-Baden: Nomos.
- Hale, J. (2011), "NATO Chief: 'Smart Defence' Plan in work", Defense News, 6 September 2011.
- HM Government (2010), "Securing Britain in an Age of Uncertainty: The Strategic Defence and Security Review", October, London.
- Kagan, R. (2003), *Of Paradise and Power: America and Europe in the New World Order*, London: Atlantic.
- Keohane, D. (2005), "The EU and counter-terrorism", Centre for European Reform Working Paper, CER, London, May.
- Keohane, D. and C. Blommesteijn (2010), "Strength in Numbers? Comparing EU military capabilities in 2009 with 1999", EU ISS Policy Brief No. 05, December 2009, EU Institute for Security Studies.
- Liberti, F. (2011), "Defence spending in Europe: Can we do better without spending more?", Notre Europe Policy Paper No.46,

- Notre Europe, Paris.
- Lindstrom, G. (2007), "Enter the Battlegroups". Chaillot Paper No. 97, EU Institute for Security Studies, Paris.
- Major, C. and Moling (2010), "EU Military Capabilities – Some European Troops, but not yet a European Army", E. Greco, N. Pirozzi, and S. Silvestri (eds), EU Crisis Management: Institutions and Capabilities in the Making, Quaderni IAI No. 19, Istituto Affari Internazionali, Rome.
- Marrone, A. (2012), "The next US President and Europe's defense", Aspenia Online, 23 February.
- Menon, A. (2011), "European Defence Policy from Lisbon to Libya", *Survival*, 53:3, June-July, pp. 75-90.
- Meyer, C. (2004), "Theorising European Strategic Culture. Between Convergence and the Persistence of National Diversity", CEPS Working Document No. 24, Centre for European Policy Studies, Brussels, June.
- _____ (2006), *The Quest for a European Strategic Culture*, Basingstoke: Palgrave Macmillan.
- Moling, C. and S.C Brune (2011), "The impact of the Financial Crisis and cuts in Member States" Defence Budgets", EU Directorate-General for External Policies, European Commission, Brussels.
- NATO (2011), "NATO Armaments Directors focus on Smart Defence and Capabilities needs", NATO News, 7 April.
- O'Donnell M. C. (2009), "The EU finally opens up the European defence market", Centre for European Reform, London.
- Rasmussen, A. F. (2011), "NATO after Libya", *Foreign Affairs*, July/August 2011.
- Schmitt, B. (2003), "The European Union and armaments: Getting a bigger bang for the Euro", Chaillot Papers n°63, EU Institute for Security Studies, Paris.
- SIPRI (2012), "Military Expenditure Database".
- _____ (2011), "Military Expenditure Database".
- TNO (2009), "Development of a European Defence Technological and Industrial Base", Main Report, September 2009.
- Transatlantic Trends (2011), "Transatlantic Trends 2011. Key Findings".
- Traynor, I. (2011), "US defence chief blasts Europe over NATO", *The Guardian*, 10 June 2011.
- Valasek, T (2011), "Surviving Austerity: The case for a new approach to EU military collaboration", Centre for European Reform, London.

Liliana Levkovska dhe Shane Thomas Franklin

2. NJË QASJE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR MBROJTJEN E ZGJUAR TË NATO-S

Efektet e krizës financiare botërore dhe të masave shtrënguese kombëtare si pasojë e saj, vazhdojnë të ushtrojnë presion ndaj buxheteve të mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO. As buxhetet e Mbrojtjes së vendeve nga rajoni i Europës Juglindore (EJL) nuk përjashtohen prej kësaj tendence. Gjatë viteve retorika e NATO-s ka nxitur aleatët e saj për të shpenzuar më tepër dhe për të mbajtur shpenzimet për mbrojtjen në marzhin e preferuar prej 2% të PBB-së për të siguruar një shpërndarje proporcionale të barrës së kostos për sigurinë. Megjithatë, realitetet e reja financiare kanë zhvendosur së fundmi retorikën e NATO-s drejt reduktimit të shpenzimeve dhe maksimizimit të përfitimeve. E vendosur në presion nga realitetet financiare sfiduese, NATO gjithnjë e më shumë po hedh dritë mbi principin e “reduktimit të dhjavit dhe zhvillimit të muskujve” ndërkohë që po vendos prioritetet që përputhen me njëra-tjetrën për zhvillimin e kapaciteteve të cilat janë gjithashtu konform kërkesave të përbashkëta, koordinimit më të ngushtë të përpjekjeve, evitimi i dublimit dhe maksimizimi i përfitimeve.

Kapacitetet e reduktuara ulin shumë gjithashtu aftësinë e Aleancës për të përmbushur misionin, detyrat dhe zotimet e saj. Mospërputhja në aftësi për mbrojtjen mund të pengojnë Aleatët që të veprojnë në mënyrë efikase me njëri - duke qenë se disa vende janë tashmë prapa kjo do të zvogëlonte dhe përkeqësonte principet e mbrojtjes kolektive dhe solidaritetit të Aleancës të cilët janë themelet e Aleancës së Atlantikut të Veriut. Për të evituar këtë, NATO tashmë ka nxitur zhvillimin e konceptit të mbrojtjes së zgjuar i cili përpiqet të eliminojë procesin e shpenzimeve të reduktuara dhe atë të më pak kapaciteteve për pagesa më të vogla duke theksuar konceptin e kapaciteteve “më të zgjuara” duke ruajtur gatishmërinë e Aleancës.

Përkeqësimi i kësaj sfide është i dukshëm gjerësisht në Europën Juglindore ku buxhetet për mbrojtjen vazhdojnë të

reduktohen dhe të vuajnë rënie serioze përgjatë viteve të fundit. I përballur me sfidat e një reduktimi të resurseve për mbrojtjen dhe të zotimeve të mëdha për krahasueshmëri dhe ndërveprueshmëri, NATO duhet të punojë më ngushtësisht me vendet e Ballkanit për të eksploruar rrugë alternative për të siguruar dhe mbështetur kapacitetet në rajon të cilat janë ta afta për të mundësuar përmbushjen dhe finalizimin e zotimeve të ndërmarra në kuadër të NATO-s.

Ky studim analizon rrugët për të pasur një vijueshmëri të suksesshme, të ndërveprueshme dhe të përputhshme të aftësive të rajonit të EJT-së sipas konceptit të Mbrojtjes së Zgjuar të NATO-s. Argumenti që parashtrohet në këtë dokument konsideron si parësor interesat e përbashkëta për menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve të mbrojtjes. Për më tepër, theksohet se përpjekjet e përbashkëta të NATO-s dhe vendeve të Ballkanit janë thelbësore për thellimin e bashkëpunimit rajonal duke zhvilluar zgjidhje që bazohen në konceptin e “mbrojtjes së zgjuar” të NATO-s. Duke konsideruar se ka pak gjasa që shpenzimet modeste për mbrojtjen do të ndryshojnë së shpejti si edhe nëse NATO dhe EJT do të dështonin për pasjen e një koordinimi të zgjuar si dhe për bashkimin dhe përdorimin e përbashkët të burimeve drejt zhvillimit të instalimeve për përdorim të përbashkët rajonalë, duket se ka shanse për një mbetje prapa të mëtejshme dhe për dëmtimin e përpjekjeve për qëndrueshmëri rajonale të Aleancës.

Bashkëpunimi: Qasja bashkëpunuese për zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes ka qenë prioritare në agjendën e vendeve anëtarë të NATO-s dhe atë të partnerëve të rajonit të EJT. Mekanizmat për bashkëpunim janë vendosur nën mbikëqyrjen e Kartës së Adriatikut të udhëhequr prej SHBA-së. Ky kuadër synon nxitjen e dialogut rajonal, avancimin e bashkëpunimit në mbrojtje dhe forcimit të aftësive kombëtare drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta të integritetit rajonal në strukturat euroatlantike.

Në këtë kuadër, janë ngritur qendra të trajnimit rajonal të cilat janë në dispozicion të vendeve të rajonit, partnerëve të NATO-s dhe aleatëve. Pavarësisht se ofrohen në mënyrë rajonale, këto qendra kanë qenë të financuara nga buxhetet kombëtare dhe kanë vepruar duke iu ofruar burime të kufizuara vendeve partnere. Duke pasur parasysh shqetësimet financiare aktuale, strategjia që duhet konsideruar çon një hap

më tutje mbrojtjen e zgjuar. Ajo kërkon përpjekjen e vendeve të Ballkanit e cila do të thellonte bashkëpunimin rajonal duke zhvilluar zgjidhje që orientohen drejt konceptit të NATO-s për mbrojtjen e zgjuar i cili përcakton bashkimin dhe përdorimin e përbashkët të burimeve me synim zhvillimin e aseteve të përbashkët të mbrojtjes dhe sigurisë. Së fundmi kjo strategji synon zhvillimin e kapaciteteve nën drejtim të përbashkët duke reduktuar dublimin dhe tepricën.

Një bashkëpunim më i zgjuar. Zbatimi praktik i konceptit të NATO-s për Mbrojtjen e Zgjuar është i arritshëm nëpërmjet projekteve shumëkombësh. Projektet shumëkombësh nuk janë një qasje e re por ato janë një mënyrë për të ecur përpara drejt zhvillimit në rajon të kapaciteteve më gjithëpërfshirëse për mbrojtjen. Projektet shumëkombëshe lejojnë për bashkimin e burimeve kur kjo nevojitet për arritjen e kapaciteteve dhe aftësive të kërkuara, aplikimin e fondeve të përbashkët kundrejt programeve të zhvillimit të përbashkët dhe për prokurime të përbashkëta për arritjen e kapaciteteve të cilat aleatët dhe partnerët nuk mund t'i arrijnë individualisht duke pasur parasysh buxhetet e shtrënguara për mbrojtjen.

Projektet shumëkombëshe ulin dublimin duke mbajtur kapacitetet, përputhshmërinë dhe ndërveprueshmërinë duke lejuar që EQL të mbetet një partner i besueshëm i NATO-s për sigurinë. Nëse zhvillimi i qendrave kombëtare të trajnimit, të disponueshme edhe për vendet e tjera të rajonit do të konsiderohej si zgjerim i bashkëpunimit, projektet shumëkombësh do të mundësonin një mënyrë për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit. Thellimi jo vetëm që forcon bashkëpunimin ndërmjet partnerëve dhe aleatëve por gjithashtu përbën një rrugë për reduktimin e ndikimit të krizës financiare globale duke marrë të njëjtat kapacitete me përdorim më të reduktuar të burimeve të disponueshme.

Një mbrojtje e zgjuar gjithëpërfshirëse: Mbrojtja e zgjuar përbën mekanizmin për zbatimin e zgjidhjeve të pranueshme nga të gjithë për mungesën e dukshme të në kapacitete, si edhe për mirëmbajtjen e kapaciteteve që janë duke u degraduar për shkak të shqetësimeve buxhetore. Qasja përfshirëse për mbrojtjen e zgjuar pret që këto të planifikohen për të vendosur në funksion burimet e secilit vend me anë të një qasjeje të balancuar për mbajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve. Në përpjekje për balancimin e kërkesave, Mbrojtja e Zgjuar përdor tre

komponentë: Prioritizimin, Bashkëpunimin dhe Specializimin.² Sipas NATO-s *“Vendet e Aleancës duhet t’i japin prioritet kapaciteteve të cilat i nevojiten NATO-s më shumë, të specializohen në atë që bëjnë më mirë dhe të shohin për zgjidhje shumëkombëshe për problemet e përbashkëta. NATO mund të veprojë si ndërmjetës duke ndihmuar vendet që të themelojnë atë që ata mund ta bëjnë së bashku me kosto më të ulët, në mënyrë më efikase dhe me rrezik më të vogël.”*³ Ndërkohë që i jepet prioritet blerjeve të mëdha të sistemeve ku vendet e mëdha janë në pozicion më të mirë për zhvillimin e kapaciteteve që kërkojnë kosto të lartë, si për shembull mbrojtja me Raketa Balistike dhe Mbrojtja Ajrore Strategjike, NATO duhet të sigurojë një qasje gjithëpërfshirëse për vendet e vogla për zhvillimin e kapaciteteve në përputhje me aftësitë e tyre socio-ekonomike. Ndërsa i është kushtuar më shumë vëmendje sistemeve të mëdha si Mbrojtja Ajrore Strategjike, Furnizimi me Karburant në Ajër dhe Mbrojtja me Raketa Balistike, vendet e vogla (si ato të rajonit të EJL) mund të kontribuojnë për mbrojtjen e zgjuar duke përdorur prokurimin e përbashkët të mjeteve ë armatosura, helikopterëve dhe sistemeve të tjerë të armatimeve ndërkohë që përfitojnë nga kostoja e reduktuar për shkak të ekonomive të përshkallëzuara. Këto lloj prokurimesh mund të kërkojnë ndryshimin e sistemeve të trashëguar dhe të rezultojnë në më shumë investim fillestar por me pjekjen e përfitimeve në kosto më të ulët mirëmbajtjeje, pjesësh dhe menaxhimit të vjetrimit do të ketë përfitime përfundimtare për Aleancën dhe anëtarët e saj lidhur me ndërveprimin dhe vijueshmërinë edhe në rastet si reduktimi i pjesëve të këmbimit që mbahen në stoqet e ofertës.

Iniciativat e mbrojtjes së zgjuar. Prokurimet dhe sistemet e shkallës së gjerë marrin pjesën më të madhe të vëmendjes këtu ndërkohë që një nivel i njëjtë vëmendjeje i duhet kushtuar edhe aftësive të Kërkesës së Lartë/Densitetit të Ulët (ang. HD/LD) që janë kryesore për hetimin e veprimeve të NATO-s. Eksperiencat e fundit në Afganistan, Afrikë, Ballkan dhe Lindjen e Mesme kanë treguar një kërkesë në rritje për Forcat për Operacione Speciale (FOS), Ekipet Mjekësorë dhe Skuadrat për Rindërtim. Këto asete kanë në qendër njerëzit jo teknologjinë ose sistemet e me kosto të lartë. Duke mbajtur parasysh se

² NATO “Smart Defense” NATO. www.nato.int/cps/en/live/topics_84268?selectedLocale=en.

³ NATO “Smart defence” NATO www.nato.int/cps/en/natolive/topics_82468.htm?selectedLocale=en

reduktime buxhetorë dhe gatishmëria e personelit si dhe nivelet e gatishmërisë marrin burime nga sistemet komplekse të armatimit që zhvillohen nga vendet e mëdha të NATO-s, Aleanca duhet të shikojë nga partnerët rajonalë të EQL-së dhe të balancojë me anë të mbështetjes zhvillimin e kapaciteteve të tyre për HD/LD (një mënyrë kjo mjaft efikase për zbatimin e mbrojtjes së zgjuar dhe iniciativës për lidhjen e forcave për përmirësimin e kapaciteteve operacionale të NATO-s.

Me rëndësi të veçantë për NATO-n është edhe pasja në dispozicion të FOS për shkak të kohës që kërkohet për formimin e këtyre forcave. FOS-të nuk mund të krijohen menjëherë pasi kërkojnë vite trajnimesh për të zhvilluar grupin e aftësive që kërkohet për bërjen funksionale të tyre çka do të thotë që ato nuk mund të prodhohen menjëherë dhe duhet të jenë gati kur kërkohen. Karakteristikat e ushtarëve të EJL i bëjnë këta të fundit kandidatët e përkryer për zhvillimin e kapaciteteve bazë të FOS-ve dhe shumë prej këtyre vendeve zotërojnë kapacitete solide bazë për FOS-të. FOS-të aktualë nga vendet e rajonit të EQL-së kanë treguar nivele të lartë profesionalizmi dhe kompetence në Irak dhe Afganistan.

Ka pasur një përpjekje të kufizuar por të vazhdueshme ndërmjet vendeve të EQL-së për zhvillimin e Qendrave të Trajnimit Rajonalë për Forcat e Operacioneve Speciale duke mundësuar kështu përdorimin e përbashkët të burimeve ku secili prej vendeve pjesëmarrës specifikohet në një aftësi specifike të FOS dhe mundëson trajnimin e përbashkët në këto fusha për secilin anëtar. Kjo do të përmbushte qëllimet e Mbrojtjes së Zgjuar duke promovuar ndërveprueshmërinë, rritur kapacitetet dhe reduktuar kostot. Ky koncept është tashmë në funksion brenda Aleancës ku 9 vende anëtarë marrin pjesë në Qendrën e Trajnimit të Specialistëve Ndërkombëtarë (QTSN). QTSN-ja synon reduktimin dhe përdorimin e përbashkët të kostove të trajnimit nëpërmjet qendërimit të trajnimit të avancuar të njësive të FOS-ve duke dhe për shtimin, me anë të shkëmbimit të vazhdueshëm të eksperiencave, njohuritë për operacionet e Forcave të Operacioneve Speciale.⁴

Megjithatë, ndërkohë që ndodhet në Gjermani QTSN-ja nuk është as një shkollë e NATO-s dhe as nën komandën e saj porse

⁴ ISTC "ISTC CONCEPT & MISSION." ISTC. <http://www.istc-sof.org/concept.html>

këshillohet prej Grupit të Trajnimit të NATO-s për të mbajtur drejtimin e doktrinës operacionale për FOS të NATO-s. Ajo është gjithashtu e kufizuar. Ajo gjithashtu kufizohet vetëm tek vendet pjesëmarrës duke reduktuar mundësitë e përgjithshme për një ndërveprim më të gjerë. Një Qendër Rajonale për Trajnimin e FOS-ve në bashkëpunim me dhe me mbështetjen e NATO-s do të lejonte zhvillimin e FOS-ve dhe arritjen qëllimeve të NATO-s që theksohen në konceptin e Mbrojtjes së Zgjuar dhe në Iniciativën për Lidhjen e Forcave.

Skuadrat Mjekësore të Dislokueshme përbëjnë një tjetër fushë me kërkesë të lartë dhe kërkojnë personel me aftësi trajnuese të veçanta. EQL zotëron një numër të lartë personeli mjekësor të trajnuar dhe ka një iniciativë rajonale për trajnimin e personelit mjekësor. Një investim i vogël në vendet e trajnimit dhe në pajisje të dislokueshme do të rriste shumë kapacitetin e Aleancës për mbështetjen e operacioneve në vijim e sipër dhe atyre të ardhshëm. Këto aftësi mund të mundësonin gjithashtu mbështetje për forcat rindërtuese PSCO/CIMIC. Qendra e Trajnimit për Operacionet në Mbështetje të Paqes në Bosnjë është një shembull e kësaj iniciative i cili megjithatë kërkon më tepër vëmendje, bashkim dhe përdorim të përbashkët të burimeve për rritjen e cilësisë së trajnime dhe numrin e trupave që mund të trajnohen. Zhvillimi i forcave operacionale sipas misionëve dhe ai i sistemeve trajnues për specializim në këto fusha mund të mundësojë fleksibilitet më të madh në planet dhe operacionet rastësore.

Zhvillimi i kapaciteteve të tjerë dytësore, si për shembull ai i Qendrave të Përbashkëta të Trajnimit për Armët Jovdekjeprurëse përbën një tjetër mundësi për zgjerimin e kontributit të vendeve të EJK-së për Aleancën. Aktualisht nuk ka një organizatë të formuar për AJV në Europë për forcat e NATO-s. Shtetet e Bashkuar kanë të vetmen Shkollë për AJV të përhershme në FT Leonard-Wood në Missouri (Kursin Ndërkombëtar për Instruktor të Armëve Jovdekjeprurëse (INIWIC)). Republika e Maqedonisë (RM) ka një pozitë unike për të marrë përsipër këtë rol dhe për të mundësuar asete trajnimi në Europë. Ushtria e RM-së tashmë posedon kapacitetet e duhura dhe mjaftueshëm pajisje AJV nga SHBA për formimin brenda një kohe të shkurtër dhe me mbështetjen e NATO-s të një qendre rajonale dhe për bashkimin dhe përdorimin e përbashkët të resurseve për këtë qëllim si edhe instruktorë të AJV-ve të certifikuar. Zhvillimi i qendrave të trajnimit përbën vetëm një aspekt të qasjes gjithëpërfshirëse të mbrojtjes

së zgjuar, ndërsa përdorimi i tyre dhe zhvillimi i një plani trajnimi të integruar që lejon që njësitë të marrin pjesë në mënyrë të përbashkët dhe jo individualisht në trajnime kërkohet për të krijuar sinergji më të madhe për përmbushjen e qëllimeve të NATO-s.

Ndërsa iniciativat e mbrojtjes së zgjuar dominojnë retorikën e udhëheqësve të mbrojtjes së EQL-së nga perspektiva rajonale vendet ngurrojnë për bashkimin dhe përdorimin e përbashkët të burimeve dhe për investimin në kapacitete dhe aftësi me pronësi të përbashkët, për përdorim të përbashkët dhe me fonde të përbashkëta. Zhvillimi i iniciativave rajonale do të kërkonte investime të përbashkëta në kapacitetet që janë vendosur në vendet fqinjë të cilat janë më ta afta për zhvillimin e kapaciteteve çka është arsyeja për ndërmarrjen e qasjeve të përbashkëta thelbësore për t'u përballur me burimet e shtrydhura prej recesionit mbetet si qasja më e mirë. Themelimi i një sponsorizimi të NATO-s për blerjen dhe mbajtjen e pajisjeve që kanë kërkesa të larta si helikopterët, mjetet e armatosura dhe kërkesat rajonale vendosur prej NATO-s si Radarë për Vëzhgime Ajrore, do të përbënin një mekanizëm për shndërrimin e retorikës në veprim dhe për inkurajimin e një bashkëpunimi më të madh ndërmjet partnerëve rajonalë të Ballkanit. Sponsorizimi i NATO-s për themelimin e qendrave kombëtare të NATO-s do të siguronte qasje gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e zgjuar duke ngushtuar konceptin për vendet më të vogla dhe duke mos u fokusuar vetëm te sistemet e mëdha të armatimit të cilat janë kryesore për sigurimin e ndërveprueshmërisë, uljen e varësisë dhe përdorimin e përbashkët të kapaciteteve në rajonin e EQL-së.

Shkurtimisht mbi autorët

Lidija Levkovska, Maqedoni

Lidija ka qenë konsulente për menaxhimin e burimeve të mbrojtjes në Booz Allen Hamilton dhe ka këshilluar Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë dhe Zyrën e SHBA për Bashkëpunim në Mbrojtje për fusha si planifikimi strategjik i mbrojtjes dhe menaxhimi i burimeve, Integrimi në NATO, reforma në sektorin e sigurisë, dhe barazia gjinore duke u përqendruar te roli i gruas në paqe dhe siguri. Është diplomuar në Menaxhim Financash në University Ss. Cyril and Methodius në Shkup, ka përfunduar Masterin për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime të Europës Qendrore në Universitetin European në Budapest dhe aktualisht është candidate për Master në Administrim Publik dhe Menaxhim në Harvard Kennedy School of Government.

Shane T. Franklin, SHBA

Shane është një marins i SHBA-së në pension i specializuar për Operacionet Speciale, Menaxhimin e Trajnimeve dhe Operacionet e Sigurisë. Krahas aftësive të tij ushtarake ai ka qenë një konsulent i Booz Allen Hamilton në Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë dhe për Forcat Mbretërore Tokësore Saudite. Ai është diplomuar për Menaxhimin e Sigurisë nga Universiteti Ushtarak i Amerikës dhe është aktualisht kandidat për Master në Menaxhim dhe Udhëheqje në Liberty University.

Daniel Fiott⁵

3. PASOJAT GJEOPOLITIKE TË KRIZËS SË EUROZONËS: RASTI I POLITIKËS SË PËRBASHKËT TË MBROJTJES DHE SIGURISË

Hyrje

Ky studim analizon aftësinë e Bashkimit European (BE) për të tejkaluar shqetësimet gjeopolitike në kuadrin e krizës së Eurozonës. Hipoteza fillestare e tij është se kriza e Eurozonës ka ndikuar marrëdhëniet e brendshme të BE-së dhe dimensionet e jashtme të saj, sidomos lidhur me partnerët si SHBA dhe Kina. Duke përkufizuar dimensionet politike si mbrojtja dhe siguria si mekanizma të rëndësishëm politikë dhe materialë për tejkalimin e shqetësimeve të gjeografisë si edhe duke pasur parasysh se si kriza e Eurozonës ushtron presion ndaj buxheteve kombëtare, synohet të shihet se deri në ç'pikë është e aftë BE-ja për të “zbutur” forcat gjeopolitike. Kjo është një përpjekje që kërkon kohë jo vetëm nga perspektiva analitike e krizës në vazhdimësi të Eurozonës por edhe sepse nëse supozohet se Eurozona dhe BE-ja janë në grahmat e “rindërtimit të rrëmujshtëm të Europës” (Pisani-Ferry, Sapir & Wolff, 2012) mund (dhe ndoshta duhet) që perspektiva gjeografike “të vëzhgohet me kujdes” gjatë procesit të rimëkëmbjes dhe reformës. Një përpjekje e tillë mbetet e rëndësishme pavarësisht se çdo lëkundje gjeografike nga kriza e Eurozonës mund të ndihet edhe në terma afatgjatë dhe edhe pse nuk nevojitet të shpejtohet për arritjen e konkluzioneve për nënkuptimet gjeopolitike (Baru, 2009).

Kriza e Eurozonës është një term abstrakt që dështon të përshkruajë saktësisht faktorët e ndryshëm që kanë goditur anëtarët e Eurozonës dhe BE-në. Kriza mund të shpjegohet nëpërmjet të paktën gjashtë faktorëve kryesorë që përforcojnë njëri-tjetrin (ky mund të quhet edhe një rreth vicioz): spekulimet financiare, borxhi publik, konsolidimi fiskal, pabarazitë strukturore,

⁵ Studiues doktorant, Instituti për Studime Europiane, Vrije Universitet Bruksel.

kriza ekonomike globale dhe mungesa e qeverisjes. Duhet theksuar se kriza e Eurozonës nuk ka prekur të gjithë anëtarët e BE-së në të njëjtën mënyrë. Vende anëtare si Greqia janë prekur prej një kohe të gjatë nga faktorë thelbësorë që do të çonin në problemet me borxhin dhe kriza e tregut të pronave kanë qenë të pranishme në Spanjë dhe Irlandë shumë kohë përpara fillimit të krizës. Ajo që transformoi këta faktorë në probleme sistematike, ajo që rriti zhvillimin e tyre ishte “stuhia e përkryer” krijuar nga risku i kredive në sektorin bankar të SHBA nëpërmjet krizës së falimentimeve në vitin 2007, e cila së pari rrethoi sistemin bankar amerikan për t’u përhapur më pas gradualisht në të gjithë sistemin financiar global (Eichengreen *et al*, 2009).

Kriza financiare me origjinë nga SHBA dhe ngecja në rritjen globale që rezultoi prej saj, ndikuan në veçanti Eurozonën. Vende si Greqia u përfshinë në zgjerime fiskale për të luftuar krizën dhe për të rikthyer rritjen por ata e bënë këtë, në disa raste, duke pasur borxhe publike të larta dhe nivele të ulëta të mbledhjes së taksave. Mbështetja e institucioneve financiare si bankat me fonde publike rezultoi në një zgjerim të mëtejshëm të borxhit të qeverisë (Coeuré, 2012). Në vijim kjo vuri menjëherë në pikëpyetje aftësinë e këtyre qeverive për pagimin e borxheve dhe për mbështetjen e rritjes ekonomike (në fund të vitit 2010 zona euro po përjetonte një rritje të PBB-së reale prej -4%) (European Central Bank, 2012, p. 70)). Këtu spekulantët financiarë dhe agjencitë e vlerësimit të kredive luajtën një rol kryesor. Kostot e larta të huas për bonot shtetërore dhe reflektimi i besueshmërisë shtetërore në treg, jo vetëm dëmtuan aftësinë e qeverisë për të ripaguar interesat por gjeneruan përfitime afatshkurtra për institucionet financiare nëpërmjet grumbullimit të ripagimeve me interesa të larta. Kriza e zonës euro është tema ku përqendrohet pjesa e parë e këtij studimi.

Kriza e Eurozonës vazhdon duke rrezikuar jo vetëm ekzistencën e Eurozonës por edhe unitetin evropian. Ajo ka përkeqësuar një sërë çështjesh politike dhe socio-ekonomike duke përfshirë populizmin në rritje, retorikën merkantiliste, papunësinë (sidomos ndërmjet të rinjve ku Spanja po përballlet me një shifër prej 50% të papunësisë mes të rinjve), varfërinë dhe pabarazitë. BE-ja ka dëshmuar rënien e qeverive të Berlusconi (Itali), Brown (Britani e Madhe), Cowen (Irlandë), Kiviniemi (Finlandë), Pahor (Slloveni), Papandreu (Greqi), Radicova (Sllovakia), Rutte (Holandë), Sarkozy (Francë) dhe

Socrates (Portugali). Gjithashtu ka pasur rritje popullore dhe sukses elektoral të partive populiste dhe ekstremiste të së Djathtës dhe të Majtës të cilat ja kanë dalë mbanë për shkak të nacionalizmit në rritje dhe rishfaqjes së proteksionizmit.

Por si lidhet kriza e Eurozonës me gjeografinë? Si ndërthuret problemi aktual i vështirësive në pagesa dhe likuiditetet me shqetësimet gjeografike? Një mendim është se “shqetësimet e provokuara nga kriza e vazhdueshme ekonomike po rritin rëndësinë e gjeografisë, duke dobësuar rendet shoqërore dhe krijime të tjera të njerëzimit dhe duke lënë si të vetmen pengesë kufijtë natyrorë të globit” (Kaplan, 2009). Një tjetër ide është se kapitalizmi, organizimi politik dhe kulturor ku bazohet Eurozona ka kompromentuar pushtetin ekonomik dhe politik të fuqive si BE-ja duke lejuar ekonomitë në zhvillim si Kina që të përdorin plotësisht avantazhet e tyre gjeografikë (për shembull burimet) pa i kushtuar shumë vëmendje interesave të BE-së dhe të SHBA-së, duke fragmentuar kësaj rëndin botëror dhe vështirësuar veprimet e përbashkëta (Burrows dhe Harris, 2009, fq. 30). Pjesa e dytë e këtij artikulli diskuton kuptimin dhe nënkuptimet politike të gjeografisë.

Në parim, ky artikull interesohet vetëm për të zbuluar nëse kriza e Eurozonës do të sjellë dobësimin e faktorëve të cilët BE-ja i përdor për të tejkaluar pengesat dhe sfidat e gjeografisë. Megjithatë, përpara kësaj do të ishte mirë të kuptohej se kriza e Eurozonës nuk është burimi i të gjithë problemeve të BE-së por se ajo ka sjellë probleme të mëdha dhe të përkeqësuar strukturorë që kanë ndikuar BE-në për një periudhë të gjatë kohe.

Për disa, rënia e Europës filloi që në vitet 1980 me ekspozimin e kontinentit kundrejt shokut dhe luhatshmërisë së çmimit të energjisë, me rënien e konkurrencës industriale të tij, sistemin fiskal të fragmentuar dhe vënien në pikëpyetje të vlefshmërisë të kredive të tij (Kennedy, 1988, p. 473 & p. 475). Të tjerë argumentojnë se aftësia e Europës për të tejkaluar gjeografinë do të gërryhen sepse, ndryshe nga SHBA dhe Kina, ajo nuk ka deri më sot “mjete ushtarake dhe politike të qëndëruar për zbatimin e kompetencave [të saj]” (Schmidt, 1989, p. 375). Kompetencat ushtarake janë mjete kryesor për të menaxhuar më mirë dinamikën gjeopolitike. Pra ata që nuk janë të aftë të përballen me presionet gjeografikë, ata “elementë të dobët në organizmat politikë dhe ekonomikë të botës”, do të tronditen

(Mackinder, 1904, p. 422). Duke analizuar Politikën e Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë të BE-së (PPMS) dhe politikat kombëtare të vendeve anëtare, seksioni i tretë i artikullit pyet nëse kriza e Eurozonës ka ndikuar kapacitetet e mbrojtjes së BE-së dhe si pasojë aftësinë e saj për “të zbutur” gjeopolitikat.

Çfarë është kriza e Eurozonës?

Kriza e Eurozonës nuk mund të shpjegohet vetëm nëpërmjet një faktori pasi shkrirja e një sërë elementesh të ndryshme mundësoi spiralizimin nga një krizë e vogël në Greqi tek një që përfshiu të gjithë Eurozonën dhe BE-në. Siç u theksua dhe në hyrje, ekzistojnë të paktën gjashtë faktorë të cilët shpjegojnë krizën, duke filluar me krizën ekonomike globale të vitit 2008. Duke analizuar vetëm dy indikatorë mund të thuhet se ndikimi tek BE-ja ishte shumë i madh. Së pari, rritja reale e PBB-së në të gjithë BE shkoi nga 3% në vitin 2007 në 0.5% në vitin 2008 dhe në -4.2% në vitin 2009. Së dyti, papunësia në BE u rrit nga 7.2% në vitin 2007 në 9.7% në vitin 2010 (OECD, 2012a). Problemi i mungesës së rritjes ekonomike dhe papunësisë ende po shqetëson BE-në. Këta dy faktorë specifikë e bëjnë thelbësore çështjen e borxhit kombëtar. Kriza ekonomike globale që filloi në fund të viteve 2000 solli eventalisht krizën e borxheve së pari me Dubain dhe më pas me Greqinë. Në shumicën e rasteve, borxhi privat u transferua në borxh publik për të mbajtur larg shqetësimin e tregjeve dhe atë moral në sektorët bankarë dhe financiarë (de Grauwe, 2010).

Portugalia, Irlanda, Greqia dhe Spanja (të ashtuquajturit “PIGS” (ang. derr)) vuajnë të gjithë nga borxhet kombëtare, pavarësisht se për arsye të ndryshme.⁶ Vite të tëra shpenzimesh publike të përkeqësuar dhe evazioni fiskal nënkuptonin se Greqia do të shtypej lehtë prej tregjeve. Në vijim borxhi kombëtar u rrit nga 105.4% e PBB-së në vitin 2007 në 157.7% të saj në vitin 2011 (Lojtsch, Rodriguez-Vives and Slavik, 2011, p. 17).⁷ Aftësia e Greqisë për të marrë borxh përpara dhe pas garancisë prej 240 miliardë Euro dhënë nga Trojka BE, Banka Qendrore Europiane (BQE) dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) u bë shumë e vështirë. Nga gushti deri në dhjetor të vitit 2011 nivelet e interesit për bonot Greke 10 vjeçare kërcyen në 4.4.5%

⁶ Duhet kujtuar se edhe Hungaria u ekspozua ndaj shkëlqimit të tregut.

⁷ Shifrat janë aplikuar brenda kuadrit evropian të Procedurës së Deficitit të Tëpruar. Shiko Tabelën 4 te Lojtsch, Rodriguez-Vives & Slavik.

(European Central Bank, 2012a). Spekulimi mbi besueshmërinë e Portugalisë për të ripaguar borxhin bëri që vendi të merrte një garanci prej 78 miliardë Euro në maj të vitit 2011 edhe pse arsyet për mjerimin e Portugalisë mbeten të paqarta. Siç ka theksuar edhe Krugman “Historia e makroekonomisë portugeze është më e vështirë për t’u treguar se sa ajo e Greqisë, Spanjës dhe Irlandës. Greqia kishte hua të madhe qeveritare, Irlanda dhe Spanja kishin lëkundje të brendshme. Portugalia, vazhdon ai, nuk ka qenë edhe aq keq nga ana fiskale pjesa e PBB-së që zinte borxhi në fillim të krizës ishte afërsisht e krahasueshme me Gjermaninë. Megjithatë, ajo gjithashtu nuk kishte çmime të larta të brendshme. Kishte shumë hua të sektorit privat por nuk është e lehtë që të shpjegohet pse” (2011).

Problemet me tregun e pronësisë në Spanjë, dobësuan bankat private, detyruan qeverinë të ndërhynte për rikapitalizimin e bankave me para publike dhe nxitën një garanci bankare prej 100 miliardësh nga Instrumenti European për Stabilitet Financiar (IESF). Kriza e vazhdueshme e borxhit kombëtar në Spanjë mund të kërkojë ende një garanci të plotë qeveritare ndërsa bonot po arrijnë marzhin e paqëndrueshëm prej 7% (*ibid.*) Problemet fillestare të Irlandës nuk lidheshin me borxhin qeveritar por me një masë huash të paqëndrueshme të dhëna nga bankat drejt zhvilluesve të pronave, të cilët me rritjen e filluskës kërkuan 100 miliardë Euro kredi. Problemi i Italisë nuk ishte as tregu i pronësisë dhe as borxhi qeveritar por mbajtja e besueshmërisë. Bonot 10-vjeçare arritën në 7.06% në nëntor 2011 (*ibid.*) për shkak të viteve të rritjes sterile. Që prej vitit 2003, PBB reale e Italisë nuk ka kaluar 2.2% dhe në vitin 2009 ajo ndaloi në -5.5% (Eurostat, 2012). Prandaj qeveria Monti, e nxitur nga institucionet ndërkombëtare si FMN është përfshirë në një proces reformash dhe liberalizimi (International Monetary Fund, 2012).

Në secilin rast qeveritë kombëtare përkatëse e kanë pasur të vështirë të marrin hua para në tregun ndërkombëtar. Për më tepër shndërrimi i shpejtë i borxhit privat në borxh të qeverisë dhe prej ndikimit të shtrëngimeve buxhetore në shpenzimet e sektorit publik (të cilat u miratuan nën presion dhe në shkëmbim të fondeve të garancisë) kanë rezultuar në më pak kërkesë prej konsumatorëve, më pak rroga, rritje të ulët ekonomike, rënie të të ardhurave prej taksave dhe më shumë paqëndrueshmëri politike dhe shoqërore. Të gjithë këta përbëjnë faktorët kryesorë të cilët ndikojnë aftësinë e qeverisë për të reduktuar borxhet kombëtare. Konsolidimi fiskal në terma afatgjatë është një nga

mënyrat për të qetësuar presionin e tregut por nga ana tjetër kjo mund të çojë shumë shpejt në mbytjen e faktorëve që nevojiten për reduktimin e borxhit. Ndërsa zgjedhja ndërmjet masës dhe kohës së konsolidimit fiskal është politike dhe ideologjike, ndoshta qasja më pragmatike në terma afatgjatë do të ishte vendosja në ritme të njëjta të nivelit të konsolidimit fiskal me atë të rritjes ekonomike. Siç argumenton një raport i fundit i OECD: “hapi i konsolidimit ka nevojë për të balancuar kërkesat për konsolidim me efektet e shkurtimeve fiskale në kërkesën totale.” Raporti shton se ky hap duhet të varet nga rritja, niveli i financave publike dhe politikat monetare që përmbajnë reduktimin fiskal (Sutherland, Hoeller dhe Merola, 2012, fq. 13).

Besueshmëria kombëtare përcaktohet gjerësisht nga kombinimi i spekulimit financiar dhe rolit të agjencive për vlerësimin e kredive. Borxhi i Eurozonës dhe i vendeve të BE-së është kryesisht pasojë e investuesve globalë që janë vendosur jashtë Europës. Nëse një vend rrezikon të dështojë për pagimin e borxhit të tij kombëtar, strategjia ka qenë ripagimi i kësaj duke huazuar më shumë para. Problemi është kur vende si Greqia marrin hua më shumë, kjo kryhet me nivele interesi akoma më të lartë. Nuk është vështirë të kuptohet përse institucionet financiarë do të ishin komodë me një situatë të tillë pavarësisht nëse ato motivohen nga frika apo lakmia (Véron, 2011), sidomos nëse vendet si Greqia eventualisht mund të paguajnë huat afatshkurtra nëpërmjet garancive. Sigurisht në terma afatgjatë nëse borxhet nuk ripaguhen atëherë investuesit mund të humbasin duke shkruar koston e borxheve ose duke u tërhequr, siç ndodhi kur investuesit morën përsipër thujse 56% të borxheve të Greqisë gjatë negociatave për garanci.

Thënë kjo, pabarazitë e theksuara strukturore të Eurozonës kanë dhe do të vazhdojnë të luajnë rol thelbësor në krizën e kredive (de Grauwe, 2010). Problemi kryesor është se ndërsa Eurozona ka monedhën e saj të përbashkët dhe bankën qendrore⁸, asaj i mungon ende autoriteti fiskal qendror përgjegjës për taksimin dhe rishpërndarjen e përbashkët i cili mund të ndërhyjë si një huadhënës e në rastin më të keq për adresimin

⁸ BQE si banka të tjera qendrore ka fuqinë për të emetuar para dhe për të kontrolluar nivelin e interesit me synim mbajtjen nën kontroll të inflacionit (si pasojë e një frike specifike gjermane) por asaj i mungojnë fuqitë fiskale që lidhen me Rezervën Federale të SHBA-së, Bankën e Anglisë dhe Bankën Popullore të Kinës.

e pabarazive makroekonomike. Ndryshe nga sistemet federale në SHBA dhe Kinë, Eurozona nuk ka një zonë optimale të monedhës së saj. Për më tepër, kriza e likuiditetit në shumë vende nuk po ndihmohet nga përplasja për huat e bankave ndërkufitare brenda Eurozonës. Pa një autoritet qendror ka pak arsye që të detyrojnë bankat për huadhënie ndër-kufitare (Pisani-Ferry *et al*, 2012, fq. 2). Paqëndrueshmëria tjetër strukturore lidhet me mungesën e konvergjencës ndërmjet anëtarëve të Eurozonës. Ekziston një nivel i ulët konvergjence në prodhueshmëri dhe nuk ka lëvizshmëri të forcës punëtore sikundër ndodh edhe në sistemet federale amerikane dhe kinezë për të kompensuar mungesat nga forca punëtore në vendet produktive. Gjithashtu ekzistojnë mungesa në konkurrueshmëri, pabarazi të dukshme në tregti ndërmjet veriut dhe jugut (ka pasur një deindustrializim në Europën Jugore) (Aglietta, 2012, fq. 4) dhe vështirësi për menaxhimin e cikleve të ndryshëm të biznesit dhe specializimeve individuale të secilit anëtar të Eurozonës.

Së fundmi faktori tjetër domethënës është vështirësia e qeverisjes politike brenda Eurozonës. Është e vërtetë se pavarësisht se me drojë udhëheqësit e BE-së kanë gjetur zgjidhje për krizën. Për mirë ose keq ka pasur një përgjigje (1 trilion Euro nga IESF, kompaktëshmëria fiskale, roli ekspansionist më shumë se kurrë i BQE-së dhe propozimet për bashkim fiskal dhe bankar.) Megjithatë, në zemër të saj, kriza e Eurozonës karakterizohet nga ngërçi politik. Një element i rëndësishëm i problemit janë frikërat gjermane se integrimi fiskal do të nënkuptonte njehsimin e borxheve ose futjen e një tregu për përdorim të përbashkët të bonove nëpërmjet Eurobondeve çka do të nënkuptonte në vazhdim për vendet me rritje si Gjermania detyrimin për të paguar gjithmonë për vendet në deficit. Ky fakt vështirë se mund t'i shitet publikut gjerman si dhe është ofendues kundrejt ndjeshmërisë gjermane. Vështirësitë e qeverisjes politike dhe kohezionit të Eurozonës si edhe faktorët ekonomikë dhe financiarë që u listuan më sipër janë kryesorë për analizimin e kapacitetit të BE-së për menaxhimin e forcave gjeografike.

Gjeografia dhe Politikat

Shumë përdorin termin gjeopolitikë pa e përcaktuar se çfarë kuptojnë me të. Në SHBA ku termi vuan mbipërdorimin ai është sinonim me “ndikimin” por është “një term popullor” me aplikim të gjerë (O’Tuathail, 1996). E përkufizuar thjesht “gjeopolitika” perceptohet si ndikimi i gjeografisë mbi politikën e jashtme ose

më tepër si sfidat që gjeografia vendos mbi politikbërësit dhe mjetet që ata përdorin për të tejkaluar shqetësime si konfigurimi specifik i tokës, deteve dhe oqeanëve. Shqetësimet gjeografike megjithatë lidhen gjithashtu edhe me shpërndarjen globale të burimeve natyrore dhe metodat që përdoren për sigurimin e tyre. Për shembull, vendet që kanë nevojë për importimin e lëndëve të para nëpërmjet oqeanëve dhe deteve mund t'ju duhet të konsiderojnë sigurimin e furnizimit e cila mund të bëjë të domosdoshme ndërtimin dhe mirëmbajtjen e një flote. Për më tepër ndërsa duhen miliona vjet që shelfet kontinentalë të rivijëzojnë hartat globale, ndikimet meteorologjike si shkrija e akujve në arktik mund të asistojnë në alternimin e dinamikave gjeografike.

“Gjeopolitika” është ndërveprimi ndërmjet gjeografisë dhe politikave dhe për këtë arsye termi ka zgjuar kundërshti që kur u krijua prej Rudolf Kjellén (1916). Pa dyshim që shqetësimet gjeografikë kanë çuar shpesh në formulimin e hipotezave për mungesën e hapësirës gjeografike duke shtuar hapësirën e pakët për manovrim në terma politikë. Pasoja e errët në vijim të ideve të individëve si Thomas Malthus, Karl Haushofer dhe Rudolf Hess zor se nevojitet të shpjegohet (Coker, 1910). Thënë kjo nën dritën e ndryshimeve të fuqisë botërorë dhe krizës ekonomike globale, dinamikat ndërmjet gjeografisë dhe politikave mbeten të rëndësishme. Edhe pse gjeopolitikët kritikë kanë theksuar me bindje tendencën klasike për të parë gjeopolitikën si një pseudoshkencë ende nevojitet që politikbërësit të mos marrin realitetet materiale të botës si të mirëqena (Guzzini, 2011). Nga siguria energjetike tek “grabitja e tokës”, në një botë shumëpolëshe, gjeografia ka rëndësinë e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në terma teorikë ka dy mënyra kryesore se si gjeografia mund të ndikojë vendimet politike. Një shkollë mendimi thekson se faktorët gjeografikë përcaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë sjelljet e politikës së jashtme. “Deterministët” kanë bindjen se aftësitë e teknologjisë për të kushtëzuar gjeografinë janë të mbivlerësuara duke qenë se teknologjia mundet që aktualisht të hapë aksesin drejt terrenit të ri. A nuk e bëri shpikja e trenit më të lehtë arritjen e kufijve të tokës dhe a nuk e bënë raketat hapësirën jashtë tokës më të arritshme? - do të pyesnin deterministët. Teknologjia mund të alternojë dinamikat dhe shpejtësinë politike por ajo nuk mund të ndryshojë në vetvete “faktorë më të qëndrueshëm prej të cilëve varet fuqia e një kombi”

(Morgenthau, 1978, fq. 117). Sipas kësaj pikëpamjeje vendet që rrethohen nga hapësira ujore si për shembull SHBA dhe Britania e Madhe kanë qenë veçanërisht të predispozuar për dominancë gjeografike globale, e ashtuquajtura “dora e Zotit” (*ibid.*, fq. 40). Ndërkohë vendet që lidhen me masivë toke dhe pa hapësirë ujore si Gjermania kanë qenë më pak të predispozuar për këtë. Deterministët mund dhe të pretendojnë se kriza e fundit në tregun e shtëpive në Spanjë dhe kriza në vazhdimësi e sektorit bankar dhe borxhit kombëtar nuk do të kishte ndodhur kurrë nëse vendi nuk do të kishte në kufirin e tij jugor bregun tundues dhe me shumë diell mesdhetar.

Rryma tjetër e mendimit konsideron gjeografinë si kushtëzuese mbi vendimet e politikës së jashtme. Ata besojnë se kushtet gjeografike në vend që të përcaktojnë sjelljet e politikës së jashtme, theksojnë rolin e shkencës ushtarake dhe teknologjisë për tejkalimin e sfidave gjeografike. Sikundër barbarët gjermanë përdornin patkonjtë e kuajve për të tejkaluar sulmin nga legjionet Romake, për shembull ashtu qëndrimi pasiv e bën detyrën e gjetjes së të dyshuarve si terroristë në vende si Pakistani dhe Afganistani më të lehtë. Disa mund të theksojnë se epoka digjitale ka vajtur edhe më tej duke tejkaluar gjeografinë. Pa dyshim ndërsa financa lëviz lirshëm ndërmjet tregjeve tërësisht të digjitalizuar mund të argumentohet se toka dhe deti nuk përbëjnë tamam pengesa të pakalueshme për rrjedhjen e kapitalit, edhe pse tregjet e burimeve të energjisë zakonisht reagojnë kundrejt pjesëve të globit të pasura me burime natyrore. Hapësira kibernetike gjithashtu mund të citohet si një përparim, por jo pa problematikën e saj me gigabajtët dhe fibrat optikë që zëvendësojnë kufijtë natyralë si lumenjtë dhe malet.

Ndryshimi ndërmjet dy pozicioneve mund të duket i vogël por kjo thotë diçka thelbësore rreth agjencive të atyre që zhvillojnë politikën e jashtme. Nëse gjeografia dikton vendimet politike, atëherë fati i çdo vendi është i vendosur. Nëse gjeografia kushtëzon kryesisht vendime të tilla atëherë roli i shkencës dhe teknologjisë në kontrollin e tokës, deteve dhe oqeanëve është thelbësor. Për qëllim të kësaj analize, ky artikull i përmbahet pikëpamjes se gjeografia kushtëzon në vend që të përcaktojë politikën e jashtme. Kjo pikëpamje merret gjerësisht sepse nëse deterministët kanë të drejtë atëherë rajone si Europa do të duhej t'i ishin “nënshtruar” tashmë fatit të tyre gjeopolitik. Nëse diktatet e gjeografisë janë absolutë atëherë a nuk do të mbetej BE-ja një moçal Euroaziatik? Megjithatë është fakt se pavarësisht të

gjithë shqetësimeve gjeografikë seriozë që prekin BE-në, blloku është i aftë për të “zbutur” forcat gjeopolitike pa avancime në shkencat ushtarake dhe teknologji. Megjithatë, nëse do të ndodhte një mungesë avancimesh të tilla, atëherë gjeografia mund të ishte një tipar më i dukshëm në politikën e jashtme të BE-së. Siç thekson Mackinder “balanca aktuale e fuqive në një kohë të caktuar pa dyshim që është produkt nga njëra anë i kushteve gjeografike ekonomike dhe strategjike dhe nga ana tjetër i numrit relativ, fuqisë, pajisjeve dhe organizimit të njerëzve konkurrues” (1904, fq. 437).

Për sa i përket kësaj, gjeografia e Europës ofron si shpresë ashtu edhe shqetësim në terma strategjikë. Malet e Europës ndajnë kontinentin nga Azia, deti Mesdhe ndan Europën nga Afrika, ajo ka një klimë të moderuar që lejon zhvillimin e bujqësisë dhe përdorimin e energjisë alternative, një mbulesë pyjore të gjerë, shumë kullota dhe ara, kultivimi zhvillohet në baza të gjera thuajse kontinentale (European Soil Bureau Network, 2005); bregdeti llogaritet përafërsisht 37,000 km me shumë porte natyrore dhe ishuj të largët si Malta, Gjibraltari dhe Qipro. Për më tepër BE-ja ka stoqe alumini, boksite, kromi, bakri, fuqi hidroelektrike, hekur, xeherorë, magnez, gaz natyror, naftë, potas, kallaj, uranium dhe zink. Megjithatë, BE-ja varet për sigurimin e një sërë burimesh natyrore nga vende si Kina dhe kontinente si Afrika. Duke pasur parasysh konsideratat mjedisore dhe afërsinë gjeografike me shtetet e paqëndrueshëm ose të dështuar, BE-ja ekspozohet kundrejt një sërë zonash të nxehta që përbëjnë sfida për sigurinë e saj.

Atëherë cilat janë pasojat nëse BE nuk do të ishte e aftë të “zbuste” gjeografinë në rajonet fqinje me të dhe/ose në rajone më të largëta? Një implikacion i kësaj lidhet me burimet natyrore. Për shembull, vendet e Lindjes si Shqipëria, Armenia, Gjeorgjia, Kirgistani dhe Taxhikistani janë veçanërisht vulnerabël ndaj reduktimit të rezervave ujore, prodhimit bujqësor në rënies dhe rritjes së problemeve shëndetësore (ENVSEC dhe Zoi, 2011). Më gjerësisht, rajoni i Azisë Qendrore ka gjasa të preket nga temperaturat në rritje dhe nga kushtet e ndryshueshme të motit. Kazakistani dhe Uzbekistani si bashkëpronarë të detit Aral dhe të lumenjve tributarë Syr-Daria dhe Amur-Daria kanë përjetuar një përkeqësim të shëndetit njerëzor, humbje të biodiversitetit dhe presione migratore (UNEP, UNDP dhe OSCE, 2003). Kaukazi jugor me të gjithë instabilitetin politik të tij ka gjithashtu shumë gjasa që të thahet më shumë. Vendet si Ukraina, që kanë rëndësi

kryesore për prodhimin bujqësor rajonal, ka gjasa të përballen me rritje të përmbytjeve dhe zjarreve në pyje (ENVSEC dhe Zoi, 2012).

Në krahun jugor BE-ja ende përballlet me presione nga Afrika Veriore dhe Sub-Sahariane. Rritja më e ngadaltë ekonomike në BE po ushqen shumë vende në Afrikë duke ndikuar tek aftësia e ekonomive Afrikane për të eksportuar në BE për shkak të kërkesës së ulët. Një sërë vendesh afrikane janë importues neto të burimeve si Nafta dhe kësisoj rritja e çmimeve përbën ushqim për tregjet e brendshëm të energjisë dhe ushqimit (Kganyago, 2012). Çmimet e ushqimit më të larta dhe më të paqëndrueshme, siç shpjegon Brown luajnë rol kryesor në paqëndrueshmërinë politike në një sërë vendesh në zhvillim. Siç paralajmëron ai pas krizës politike dhe revoltave në Afrikën e Veriut “fermerë dhe ministra të jashtëm bëhuni gati për një epokë të re në të cilën pamjaftueshmëria e ushqimit në botë do të formësojë politikatat globale” (2011). Pa dyshim që kriza në ushqim, së bashku me problemet politike në rajone si Sahel dhe Briri i Afrikës mund të ngatërrojnë gjithnjë e më shumë BE-në.

Për t’u marrë me rënien nga probleme të tillë potencialë të kërkesës BE-ja ka burimet materiale (politike, ekonomike dhe ushtarake) që nevojiten. Kriza ekonomike ka sfiduar për një kohë të gjatë aftësitë e shteteve për të mbajtur këto burime edhe pse duhet pasur kujdes për krahasimin e BE-së me aktorë të tjerë, duke qenë se për këtë ekzistojnë një sërë precedentësh historikë që provojnë të kundërtën. Për shembull, rënia eventuale e Perandorisë Osmane (1299-1922) u ndihmua, ndërmjet të tjerash edhe nga paaftësia e komandantëve ushtarakë për të kuptuar mjetet moderne të luftës dhe nga kostoja e shtrenjtë që përfshinte mbajtja e një force ushtarake aq të madhe në një terren gjeografik me ato përmasa (Darling, 1996, fq. 8-11). Dinastia Ming (1368-1644) njëherë e një kohë hodhi në det flotën më të madhe të botës, por rreth vitit 1433 Kina u tërhoq nga detet dhe oqeanet nën rrezikun e përkeqësimit ekonomik të brendshëm dhe presionet e jashtme nga Mongolët duke u bërë kësisoj edhe më e dobët dhe më e mbyllur (Fairbank, 1969, fq. 455-456). Siç tregojnë edhe këta dy shembuj të shkurtër, pasojat e ashpra që vijnë nga vendimmarrja e varfërisë, kapacitetet e dobëta ushtarake, shqetësimet ekonomike dhe presionet gjeografike. Artikulli orientohet tashmë drejt formës dhe forcës së politikës së mbrojtjes të BE-së.

PPMS, kriza e Eurozonës dhe gjeopolitika

Duhet bërë e qartë se gjeografia nuk ka qenë drejtpërdrejt përgjegjëse për krizën e borxheve kombëtarë të Eurozonës, por kriza mund të ndikojë aftësinë e BE-së për të menaxhuar gjeografinë. Ky seksion interesohet për ndikimin që kriza e Eurozonës ka në politikën e mbrojtjes së BE-së dhe në politikat e mbrojtjes të vendeve anëtarë si edhe në aftësinë e BE-së për të “zbutur” gjeopolitikën. Aftësitë ushtarake janë ende mënyra kryesore për të tejkaluar shqetësimet gjeografike. Patjetër që mbrojtja nuk është e vetmja fushë që ndikohet prej krizës së Eurozonës (trendet gjeografike, faktorët ekonomikë dhe tensionet që dalin në pah nga kërkesa për resurse janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm). Megjithatë, mbrojtja është një zonë e rëndësishme për t’u përqendruar për një sërë arsyesh. Kriza ekonomike botërore ka thënë mjaft për rritjen e borxhit të SHBA, duke detyruar superfuqinë që të ndër marrë shkurtime në buxhetin e mbrojtjes dhe të rishikojë drejtimin e saj strategjik. Domosdoshmëria e SHBA-së për të rritur përfshirjen në rajonin e Azisë dhe Paqësorit (Panetta, 2012) vë në pikëpyetje vullnetin e Uashingtonit për siguri në Europë dhe aftësinë e BE-së për t’u përballur e vetme me forcat gjeopolitike. Kjo detyrë në vazhdim po bëhet e vështirë për shkak të presioneve buxhetore të vendeve anëtarë të BE-së kanë ndikim potencial mbi vullnetin afatgjatë të vendeve anëtare për PPMS dhe NATO.

Zhvendosja e SHBA nga Europa drejt Paqësorit përfaqëson një sfidë për ekuilibrin e brendshëm të fuqive ndërmjet vendeve anëtare të BE-së. Në sferën ekonomike aktualisht flitet për një BE që zhvillohet “me dy grupe” ku anëtarë të Eurozonës integrohen në vija federaliste më shumë sesa vendet si Mbretëria e Bashkuar që nuk janë pjesë e saj. Por në fushën e mbrojtjes një BE me dy grupe duket të jetë më pak e mundshme. Britanikët ende luajnë një rol kryesor në këtë fushë (Simón, 2011). Është e vërtetë se britanikët nuk e kanë shfrytëzuar rastin për të luajtur një rol udhëheqës në PPMS, sidomos duke pasur parasysh faktin se ata po mënjanojnë gjithnjë e më shumë në qeverisjen ekonomike. Megjithatë, Britania e Madhe mbetet një lojtar kryesor në mbrojtje. Jo vetëm që ajo harxhon vazhdimisht më shumë se 2% të PBB-së së saj për mbrojtjen por ajo ka edhe një kapacitet industrial të madh për prodhimet e mbrojtjes. Thënë kjo, stili tradicional Britanik “shikoj - pushë” i gjeostrategjisë që nënkupton rrëshqitjen ndërmjet Europës dhe SHBA duke pasur qëllim të mbajë “izolacionizmin e përkryer”, duhet të përfundojë duke pasur

parasysh riorientimin amerikan, hapat federalë në qeverisjen ekonomike dhe financiarë që janë ndërmarrë në zonën Euro dhe konsolidimin fiskal.

Sërish duhet pasur kujdes që të mos mendohet se reduktimet në buxhetin e mbrojtjes të vendeve anëtarë të BE-së përbëjnë në vetvete një hap negativ. Edhe pse, siç pritet duke pasur parasysh se ato po zhvillohen, ekonomitë në zhvillim si Kina, India dhe Brazil po shpenzojnë më shumë për mbrojtjen. BE-ja asnjëherë nuk do të mund të barazohet me shpenzimet për mbrojtjen të SHBA në të ardhmen e afërt edhe pse në disa vende anëtare shpenzimet për mbrojtjen janë rritur që kur filloi kriza e Eurozonës. Ndoshta nxitur nga shumat që SHBA po shpenzonte për mbrojtjen, shumë vende anëtare të BE-së kishin filluar reduktimin e buxheteve për mbrojtjen shumë përpara krizës duke shpresuar se rritja ekonomike mund të inkurajohej (Liberti, 2011, p. 15). Dunne dhe Nikolaidou kanë arritur në përfundimin se “ekziston një lidhje negative ndërmjet rritjes dhe kostos ushtarake. Kësisoj vendet me kosto të lartë ushtarake kanë rritje të ulët” (2011, fq. 5). Pra, pavarësisht shqetësimeve të sigurisë që vijnë nga Turqia, Greqia dhe Qipro të cilat kanë shpenzuar për mbrojtjen në vitin 2001 përkatësisht 3.4% të PBB-së së tyre nuk mund të vazhdonin kësaj dhe përqindja e PBB-së u reduktua nga 3.4% në 2.3% në Greqi dhe në 2.1% në Qipro në vitin 2010 (SIPRI, 2011). Kjo tregon se në politikën e mbrojtjes një sërë vendesh anëtare të BE-së po reagojnë më shumë ndaj forcave afatgjata makroekonomike dhe strukturore sesa ndaj krizës të Eurozonës.

Ndërsa është e vërtetë se shumë vende anëtare po reduktojnë shpenzimet dhe po ulin numrin e trupave (mesatarja e përqindjes së PBB-së të BE-së që shpenzohet për mbrojtjen shkoi nga 1.7% në vitin 2001 në 1.4% në vitin 2010) (*ibid.*), përtej minimumit prej 2% të kërkuar prej anëtarëve të NATO-s), më e rëndësishmja është se përse harxhohen buxhetet e mbetura dhe si organizohen reduktimet në shpenzime në nivel evropian. Inkoherenca në shpenzime si investimet në avionë transportues pa pasur avionët gjuajtës të duhur është më shqetësuese sesa shuma që harxhohet aktualisht. Racionalizimi i buxheteve të mbrojtjes ofron një mundësi për racionalizimin e rolit të forcave tokësore, detare dhe ajrore që mund të çojë në një modernizim të tejskajshëm të forcave ushtarake. Megjithatë siç ka theksuar me të drejtë Maulny, kur zhvillohet ky racionalizim mbi baza tërësisht kombëtare, ristrukturimi i mbrojtjes mund të

mos marrë parasysh për racionalizimin e katalogut të forcave të mbrojtjes së BE-së dhe konkurrueshmërinë në treg (Maulny, 2010). Nevojitet të pyetet se sa reduktime në shpenzime kombëtarë duhen ndërmarrë krahasuar me iniciativat në nivel evropian (për shembull Paketën e Komisionit të BE-së për Mbrojtjen” (O’Donnell, 2012) e cila synon reduktimin e kostove, shtimin e rritjes ekonomike dhe sigurimin e një fuqie ushtarake të përgjithshme.

Gjendja e forcave të mbrojtjes në Europë është ende e ndarë në linja kombëtare dhe aktualisht është ekspozuar më shumë ndaj presionit si rrjedhojë e krizës së Eurozonës duke përbërë një analizë interesante. Përsa i përket kapaciteteve, njësitë ushtarake të përbashkëta të 27 vendeve anëtare të BE-së kanë rënë gjatë një periudhe 10 vjeçare (1999-2009) me 14.129 njësi për forcat tokësore dhe me 14.129 njësi për forcat e përbashkëta ajrore (duke përfshirë helikopterët). Përjashtim këtu bëjnë forcat e përbashkëta detare të cilët janë rritur me 408 anije (Keohane and Blommestijn, 2009). Për më tepër, ka pasur rënie të numrit të stafit dhe të forcave të dislokuara në përputhje me rënie prej 10 miliardë Euro të mesatares së shpenzimeve për mbrojtjen në buxhetet e BE 27 gjatë periudhës 2007-2010. Kjo periudhë 3-vjeçare ka dëshmuar një rënie në BE 27 me 216, 533 persona në personel ushtarak dhe 63,201 në personel civil. Numri total i kombinuar i forcave të armatosura të qëndrueshme ra me 17283 nga viti 2007 në 2010 dhe numri total i trupave të përbashkët të dislokuara për të njëjtën periudhë ra me 5550 (European Defence Agency, 2008 and 2012). Edhe me këto rënie këto tendenca nuk tregojnë një çmilitarizim drastik (Whitney, 2011) në terma afatshkurtër dhe afatmesëm. Rënie në shpenzime dhe forca ka aktualisht nuk vënë në pikëpyetje aftësinë e BE-së për të menaxhuar shqetësimet gjeografike.

Megjithatë, nëse vendet anëtare nuk racionalizojnë kapacitetet e forcave dhe buxhetet e mbrojtjes shpenzohen në terma afatgjatë bazuar në strategji ambicioze politike, komerciale dhe industriale, atëherë pamja do të ndryshojë. Nëse kriza e Eurozonës ka theksuar një dinamikë të rëndësishme gjeografike, ajo është se ndërmjet bërthamës qendrore të shteteve evropiane dhe periferisë më të dobët të Jugut fatet e vendeve anëtare janë më të ndërlidhur se kurrë më parë. Tamam sikundër kriza ekonomike në Greqi përbën një shqetësim kryesor për shtetet si Gjermania ashtu edhe dobësia ushtarake në disa vende anëtare do të prekë gradualisht të gjithë. Këtu po vendosim një

pyetje kundërshtuese me përgjigje të hapur. Meqenëse vendet anëtare të ngarkuar me borxhe po humbasin sovranitetin kundrejt strukturave më federaliste në sferën ekonomike, përse duhet që BE-ja të shtojë një grumbullim vendesh anëtare më të vegjël duke mbivendosur përpjekjet për mbrojtjen?

Në fakt aktualisht vendet anëtare janë ende të mirëpajisura me forca ushtarake por me një përjashtim të mundshëm të sektorit ajror, nuk ekzistojnë mjaftueshëm projekte bashkëpunuese në nivel europian, ka një intensitet të ulët të kërkimit dhe zhvillimit dhe sektori i mbrojtjes në BE nuk është efikas (Ecorys *et al*, 2010, pp. 38-40). Kriza e Eurozonës Euro nuk ka penguar vendet anëtare që të investojnë për kapacitete ushtarake si Mjetet Ajrore pa Pilot (UAV-s) të cilët do t'ju mundësojnë atyre, edhe duke pasur parasysh konsideratat morale të përdorimit të tyre, një hegjemoni globale në terma të fuqisë së rëndë ushtarake (Fiott, 2010). Vendet anëtare janë sigurisht më pak ambicioze kur vjen fjala për projekte për investime në mbrojtje. Për shembull, ndërsa SHBA investon thuajse 6 miliardë dollarë në vit për UAV, BE edhe pse në dijeni të vlerës së teknologjisë nuk investon të njëjtën shumë (European Commission, 2007a and European Defence Agency, 2007). Vendet anëtare ende insistojnë për përdorimin e kuadrit teologjik të protokollit të Traktatit të Lisbonës për Bashkëpunimin e Strukturuar të Përhershëm (BSP) sesa për iniciativa konkrete (Mölling and Brune, 2011, p. 55). Ndërsa është e vërtetë se kriza e Eurozonës ka formuar bashkëpunimin franko-britanik për mbrojtjen nëpërmjet Traktateve të Lankasterit, kjo nuk është veçse një gjest i vogël nëse merret parasysh kuadri i plotë i faktorëve me të cilët përballet mbrojtja e BE-së (shqetësimet për resurset, globalizimi i zinxhirëve të ofertës së BE-së, nivele të ulëta shërbimesh ushtarake dhe faktin se sektori i mbrojtjes është më pak një sipërmarrje komerciale sesa një që përmban veprim ushtarak. Ana komerciale dhe industriale e PPMS-së ka padysim një rëndësi në rritje. E sapolindura Baza e Teknologjisë Industriale të Mbrojtjes Europiane (BTIME) është thelbësore këtu. Si për “Paketën e Mbrojtjes së BE-së” e cila me anë të dy direktivave që prej vitit 2009 është përpjekur të lehtësojë zhvillimin e tregut të pajisjeve europiane të mbrojtjes dhe të tregut të sigurimit të prokurimeve. Pra, kjo paketë duhet të ndihmojë për bërjen e tregut të mbrojtjes europian më konkurrues edhe nëse “pengesat që e karakterizojnë do të jenë ende prezent kryesisht për shkak të forcave të tregut dhe kërkesave të klientëve” duke përfshirë rivalitetin strategjik industrial ndër BE,

kostot e forcës së punës njerëzore të kualifikuar, një mungesë aksesi për te kapitali dhe aksesin te njohuria dhe shpenzimet kombëtare (Ecorys *et al*, 2010, p. 47). Pra, duke pasur parasysh se tashmë theksi është vënë tek rritja ekonomike e Eurozonës pritet që të vazhdohet të ketë një zhvendosje normative në bazë të PPMS e cila nuk do të orientohet më vetëm drejt operacioneve ushtarake dhe civile por gjithashtu tek rritja ekonomike. Për dëshirën e udhëheqjes politike, integrimi do të vijë edhe njëherë tjetër nga tregu (Liberti, 2011, p. 45).

Gjithashtu, ekzistojnë pyetje thelbësore që duhen bërë rreth faktit nëse duhet që tregu të luajë një rol më thelbësor në PPMS (Fiott, 2011). Për shembull, ristrukturimi i industrive kombëtare të mbrojtjes duke synuar një racionalizim në nivel evropian të kapaciteteve prodhues dhe shpenzimeve do të përfshinte humbjen në vende pune në shumë vende anëtare. Sigurisht që ka edhe përfitime ekonomike për t'u bërë në sektorin e mbrojtjes, sidomos duke shitur pajisje civile dhe ushtarake dhe shërbime të fuqive në rritje dhe aspirantë si për shembull (Brazili, Rusia, India, Kina dhe Koreja e Jugut (BRIKKJ)). BRIKKJ janë përfitues neto të Investimeve Direkte të Huaja (FDI) dhe “ky tipar ndoshta do të përsëritet edhe në sektorin e mbrojtjes” si edhe të qenit marrësit kryesorë të transfertave të armëve në rajone si BE-ja (Ecorys *et al*, 2010, p. 291). Për shembull, në vitin 2011, Gjermania ishte një nga eksportuesit kryesorë të armëve për vende si Brazili dhe Koreja e Jugut (SIPRI, 2012). Ndërkohë që ishte një burim potencial përfitimi për firmat e mbrojtjes së BE-së, ka një argument të drejt moral që duhet theksuar rreth eksportimit nga vendet e BE-së të pajisjeve të mbrojtjes drejt BRIKKJ. Duhet parë nëse kjo rezulton në furnizimin e garës rajonalet e armatimeve apo shërben për fuqizimin e mëtejshëm të konkurrentëve strategjikë të BE-së. Në këtë drejtim, opinioni publik për mbrojtjen e BE-së duhet konsultuar për zhvillime të tilla. Problemi sigurisht është se përveç Nënkomitetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes (SIMB) në Parlamentin European i cili ka pak fuqi politike dhe ligjore, qytetarët nuk kanë një lidhje të drejtpërdrejtë për përmbajtjen dhe drejtimin e PPMS-së.

Megjithatë BTIME në formim e sipër ngre në mënyrë paradoksale shqetësimet e saj për sigurinë sidomos në kuadër të frikërave aktuale se shtete si Kina të cilat duan të përfitojnë nga kriza e Eurozonës, po përpiqen të zgjerojnë portofolat e aksioneve të jashtëm duke blerë aksione në infrastrukturën kryesore si portet dhe firmat e teknologjisë së lartë si edhe duke

investuar në sektorë ekonomikë thelbësorë si mbrojtja (Godement, Parello-Plesner and Richard, 2011). Sikundër theksojnë edhe Hanemann dhe Rosen ekonomitë në zhvillim si Kina po përdorin krizën e Eurozonës për t'u pykëzuar në tregjet Europiane, për zgjerimin e zinxhirëve të prodhimit dhe për të rritur kapitalin njerëzor dhe njohuritë teknologjike. Ndërsa firmat ekonomike si Huawaei Technologies dhe Lenovo Group janë përgjegjëse për “shumicën dërrmuese të marrëveshjeve” në BE (80% saktësisht), vlera e marrëveshjeve për investime direkte të huaja që është bërë nga ndërmarrjet që zotërohen prej shtetit si China Ocean Shipping Group Company renditen më lart në BE si vlerë e përgjithshme (Hanemann and Rosen, 2012, pp. 45-46). Kjo përbën një rrezik politik. Për shembull ndërsa investimet direkte të huaja kineze në BE natyrisht që kanë filluar përpara krizës së Eurozonës, Hanneman dhe Rosen vlerësojnë se në vitin 2011 asetet kryesorë kinezë të investimeve të huaja direkt përfshinin 3,631 milionë dollarë në Industri Kimike, Plastikë dhe Gomë, 34 milionë dollarë në bioteknologji, 253 milionë dollarë në pajisje ajrore, mbrojtje dhe hapësirë, dhe 1,357 milionë në komunikime, pajisje dhe shërbime (*ibid.*, p. 41).

Lexuesi liberal ndoshta do të argumentonte se investimet e huaja direkt kineze në Europë do të sillnin kapital të ri, mundësi punësimi, rritnin prodhueshmërinë dhe se kjo do të shërbente si mënyrë për të sjellë Kinën në të njëjtat standarde si BE me anë të Tregut Unik. Të tjerë mund të argumentonin se BE-ja nuk ka pse të shqetësohet për ekspozimin e investimeve të huaja të drejtpërdrejta ndaj ekonomive në zhvillim si Kina në terma afatshkurtër duke pasur parasysh se balanca e hyrje-daljeve të investimeve të huaja direkte ka rënë që prej vitit 2007 (hyrjet kanë rënë me pothuaj 436 miliardë dollarë ndërsa daljet kanë rënë me thajse 555 miliardë (OECD, 2012b). Duke shkuar më tej dhe me njëfarë justifikimi të tjerët mund të theksojnë se përcaktimi i Kinës si rrezik për infrastrukturën e mbrojtjes europiane nuk është e mbështetur nga ana cilësore duke pasur parasysh se në vitin 2010 SHBA ishte ende investitori i huaj më i madh në BE i ndjekur, sipas investimeve prej Kanadasë, Hong Kongut, Zvicrës Brazilit, Japonisë, Kinës, Indisë dhe Ruisë (Eurostat, 2010).

Nëse këto argumente konsiderohen si duhet, me siguri që ende ka kuptim që BTIME ende në lindje e BE-së duhet mbrojtur nga pronësia potenciale e konkurruesve globalë të BRIKKJ dhe nga partnerët tradicionalë si SHBA. Siç shpjegon një raport

veçanërisht alarmant nga Michael Brzoska, BTIME me shumë gjasa kërkon mbrojtje prej investimeve të huaja direkte nga konkurruesit në sektorë të ndjeshëm si hapësira ajrore (Brzoska, 2007, p. 11). Kjo ide ka filluar të fitojë terren, ndërsa publikimet nga Komisioni Europian (2007b) dhe nga Komiteti Social dhe Ekonomik Europian (2012) sugjerojnë. Megjithatë siç thekson edhe Brzoska “ndërsa në numrin rritja në numrin e aktiviteteve të kujdesshëm për ushqimin e një qasjeje europiane për gjenerimin e teknologjisë së mbrojtjes dhe kapaciteteve të prodhimit të Europë janë të dukshme, nuk ka iniciativa të njëjta për mbrojtjen e këtyre kapaciteteve nga kontrolli i jashtëm ose nga pronësia në nivel intelektual”. Siç vazhdon më tej ai” për shkak të rrezikut të dyfishtë të humbjes së konkurrueshmërisë dhe të kontrollit Europian, fokusi aktual për përmirësimin e konkurrueshmërisë duhet balancuar nga zhvillimi i politikave dhe instrumenteve për mbrojtjen e aseteve kryesorë (2007, p. 11).

Nëse kriza e Eurozonës nuk e bën BE-në më të besueshme ndaj partnerëve të huaj për investim, kjo nuk është justifikim për lejimin e konkurruesve strategjikë që të zotërojnë pjesë në sektorë kritikë të ekonomisë europiane. Shitja e pjesëve të sektorëve kritikë tek konkurrentët me shumë gjasa do të sfidonte aftësinë e BE-së për të tejkaluar shqetësimet gjeografike edhe pse përfitimet tregtare po promovohen aktualisht nga një sërë aktorësh (shih: Bekkers *et al*, 2009). Megjithatë, ende nuk ka një kuadër në nivel Europian për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte (Hanemann and Rosen, 2012, p. 61), ai paraqitet i fragmentuar. Kjo sjell një “garë për vendin e fundit” duke qenë se procedurat kombëtare favorizojnë “shkurtimet” dhe mbikëqyrjet për të siguruar përfitime ekonomike afatshkurtër (Istituto Affari Internazionali, 2010, p. 325). Deri tani vetëm 10 vende anëtare të BE-së⁹ po zbatojnë shtrëngesa për mbrojtjen, transportin dhe telekomunikacionin dhe Lituania është anëtari i vetëm që nuk ka një frenim të theksuar të investimeve të huaja direkte në mbrojtje dhe siguri për vendet jashtë BE-së dhe jashtë NATO (Hanemann and Rosen, 2012). Kjo situatë ka çuar në një sërë thirrjesh nga mbikëqyrësit në nivel europian për të parë tregun e brendshëm dhe nga mbikëqyrësit tregtarë për fusha si mbrojtja, teknologjitë thelbësore ndër të tjera (Roller and Véron, 2008 & Godement, Parello-Plesner and Richard, 2011, p. 10).

⁹ Austria, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Lituania, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe Britania e Madhe

Konkluzione

Në fushën e PPMS-së kriza e Eurozonës kërcënon të lërë kapacitetet e BE-së për menaxhimin e gjeografisë, të cenueshme në terma afatgjatë duke ndikuar llojet e përpjekjeve rristrukturuese dhe racionalizimeve ushtarake të bëra nga vendet anëtare si rezultat i konsolidimit fiskal si edhe nga shitja potenciale e fushave kryesore të infrastrukturës së mbrojtjes së konkurrentëve strategjikë. Këta dy faktorë specifikë do të ndryshonin në vazhdimësi aftësinë e BE-së për të menaxhuar shqetësimet që lidhen me sigurinë të cilat dalin nga fqinjët e saj të afërt dhe për të siguruar interesat e saj në nivel global. Vështirësia për kohezion politik, mungesa e rritjes ekonomike dhe rristurimi i borxheve gjithashtu do të ndikojnë tek aftësitë e BE-së për të menaxhuar forcat gjeografike. Për të përsëritur observimin e Kaplan edhe njëherë dobësimi i rendeve ekonomike, politike dhe shoqërore çon një shtet ose në rastin tonë një rajon të tërë drejt ekspozimit ndaj kufijve natyrorë të globit (2009). Ndërsa gjeopolitika nuk duhet të shndërrohet në vetvete në bazën kryesore për politikat e mbrojtjes dhe sigurisë së BE-së, kapacitetet ajrore, detare dhe tokësore përfaqësojnë elementët kryesorë të cilët mundësojnë për tejkalimin e gjeografisë. Krahas kësaj, janë edhe dimensionet e reja të botës kibernetike dhe UAV-ve të cilën BE-ja duhet ta eksplorojë atë siç duhet dhe me kujdesin moral dhe politik të nevojshëm.

Topografia politike e botës po ndryshon, dhe pa mjetet e nevojshme për të tejkaluar piket dhe vështirësitë, BE-së do t'i duhet të testohet. Parkoializmi ka një efekt shumë të theksuar anësor për krizën e Eurozonës edhe nëse kriza nuk është tjetër, përveçse shumë serioze, një vrimë e zezë në konstelacionin e problemeve europiane. Kriza ka nxjerrë në pah se borxhet kombëtare që ka një vend, e ekspozojnë atë ndaj një rreziku mjaft real dhe ngjithës: kriza në Greqi u përhap shpejt në Spanjë dhe Itali. Ndërsa do të ketë një ndjesi më të ulët urgjence në mbrojtje krahasuar me krizën e Eurozonës, vendet anëtare mund të bien pre e rënies së fuqisë ushtarake nëse programet rristrukturuese nuk ndërmerren në mënyrë të përbashkët në nivel BE-je dhe nëse infrastruktura ushtarake thelbësore nuk mbrohet. Në terma afatgjatë, nëse humbet dëshira politike për më tepër integrim, kriza e Eurozonës do të kishte shërbyer si një moment thelbësor në histori që ka sfiduar aftësinë e BE-së për të çarë përpara në botë dhe për të tejkaluar shqetësimet gjeografike.

REFERENCAT

- Aglietta, M. (2012) "Europe and the World Economy at the Tipping Point", paper presented at the European Parliament, 27 June 2012 for a conference entitled *Governing Globalisation in a World Economy in Transition*, organised by the Madariaga - College of Europe Foundation and the Institute of European Democrats.
- Baru, S. (2009) "Geopolitical Implications of the Current Economic Crisis", *Strategic Analysis*, Vol. 33, No. 2 (March), pp. 163-168.
- Bekkers, F., Butter, M., Anders Eriksson, E., Frinking, E., *et al* (2009) "Development of a European Defence Technological and Industrial Base", *TNO Final Report for the European Commission*.
- Brown, L. (2011) "The New Geopolitics of Food", *Foreign Policy*, (May/June).
- Burrows, M.J. & Harris, J. (2009) "Revisiting the Future: Geopolitical Effects of the Financial Crisis", *The Washington Quarterly*, (April), vol. 32, No. 2, pp. 27-38.
- Brzoska, M. (2007) "The Protection of the European Defence Technological and Industrial Base", *Briefing Paper for the European Parliament*, (2 October).
- Coeuré, B. (2012) "Managing Sovereign Debt: A Seismic Shift in Demand and Supply Dynamics?", *Speech to the 12th IMF Annual Forum on Managing Sovereign Risk and Public Debt*, Rio de Janeiro, (28-29 June).
- Coker, F. (1910) *Organismic Theories of the State: Nineteenth Century Interpretations of the State as Organism or as a Person* (New York: Longmans Green).
- Darling, L.T. (1996) *Revenue-Raising and Legitimacy: Tax Collection and Finance Administration in the Ottoman Empire, 1560-1660*, (Leiden: E.J. Brill).
- De Grauwe, P. (2010a) "Crisis in the Eurozone and How to Deal With It", *CEPS Policy Brief*, (February), No. 204.
- De Grauwe, P. (2010b) "A Mechanism of Self-Destruction of the Eurozone", *CEPS Commentaries*, (9 November) 2010.
- Dunne, P. & Nikolaidou, E. (2011) "Defence Spending and Economic Growth in the EU15", *RePEc: UWE Working Paper*, (March), No. 1102.
- Ecorys Research and Consulting, *et al* (2010) "FWC Sector Competitiveness Studies: Study on the Impact of Emerging Defence Markets and Competitors on the Competitiveness of the European Defence Sector", *Final Report for the European Commission*, (February).

- Eichengreen, B., Mody, A., Nedeljkovic, M. & Sarno, L. (2009) "How the Subprime Crisis Went Global: Evidence from the Bank Credit Default Swap Spreads", *NBER Working Paper*, (March), No. 14904.
- ENVSEC & Zoi Environment Network (2011), *Climate Change in the South Caucasus: A Visual Synthesis*. See: www.envsec.org/publications/climatechangesouthcaucasus.pdf. (Accessed 10 June 2012).
- ENVSEC & Zoi Environment Network (2012), "Climate Change in Eastern Europe 2011: Belarus, Moldova, Ukraine". See: <http://issuu.com/zoienvironment/docs/ccee-englishweb?mode=window&backgroundcolor=%23222222>. (Accessed 12 June 2012).
- European Central Bank (2012a) "Long-Term Interest Rate Statistics for EU Member States", (10 August). See: www.ecb.int/stats/money/long/html/index.en.html. (Accessed 15 August 2012).
- European Central Bank, (2012b) "Money and Credit Growth after Economic and Financial Crises – A Historical Global Perspective", *ECB Monthly Bulletin*, (February).
- European Commission (2007a) "Study Analysing the Current Activities in the Field of UAVs". See: http://ec.europa.eu/enterprise/policies/security/files/uav_study_element_2_en.pdf. (Accessed 18 July 2012).
- European Commission (2007b) "A Strategy for a Stronger and More Competitive European Defence Industry", *Communication from the Commission*, COM(2007) 764 final, Brussels (5 December).
- European Defence Agency (2007) "Background on New EDA Initiative on UAVs". See: www.eda.europa.eu/news/07-05-14/background_on_new_eda_initiative_on_uavs. (Accessed 16 July 2012).
- European Defence Agency (2008) "Defence Data of EDA Participating Member States in 2008". See: www.eda.europa.eu/Libraries/Documents/National_Defence_Data_in_2008.sflb.ashx. (Accessed 2 July 2012).
- European Defence Agency (2012) "Defence Data: EDA Participating Member States in 2010". See: www.eda.europa.eu/libraries/documents/defence_data_2010.sflb.ashx. (Accessed 2 July 2012).
- European Economic and Social Committee (2012) "Need for a European Defence Industry: Industrial, Innovative and Social Aspects", *own-initiative opinion report*, (11 July), Brussels.
- European Soil Bureau Network (2005), "Soil Atlas of Europe", European Commission.

- Eurostat, (2010) "FDI inward flows by main partner 2010". See: [http://epp.eurostat.ec.europa.eu/statistics_explained/index.php?title=File:FDI_inward_flows_by_main_partner_2010_\(1\)_EUR_1_000_million.png & filetimestamp=20120110161256](http://epp.eurostat.ec.europa.eu/statistics_explained/index.php?title=File:FDI_inward_flows_by_main_partner_2010_(1)_EUR_1_000_million.png&filetimestamp=20120110161256). (Accessed 1 August 2012).
- Eurostat (2012) "Real GDP Growth Rate-Volume". See: [http://epp.eurostat.ec.europa.eu/tgm/table.do?tab=table & init=1 & plugin=1 & language=en & pcode=tec00115](http://epp.eurostat.ec.europa.eu/tgm/table.do?tab=table&init=1&plugin=1&language=en&pcode=tec00115). (Accessed 15 August 2012).
- Fairbank, J.K. (1969) "China's Foreign Policy in Historical Perspective", *Foreign Affairs*, (April), Vol. 47, No. 3, pp. 449-463.
- Fiott, D. (2010) "Should the EU be Using More Unmanned Aerial Vehicles?", *Europe's World*, (27 October).
- Fiott, D. (2011) "The Political Economy of European Defence", *Ideas on Europe*, (27 January).
- Godement, F., Parello-Plesner, J. & Richard, A. (2011) "The Scramble for Europe", *ECFR Policy Brief*, (July), No. 37.
- Guzzini, S. (2011) "Marxist Geopolitics: Still a Missed Rendez-Vous?", *Geopolitics*, Vol. 16, No. 1, pp. 226-229.
- Hanemann, T. & Rosen, D.H. (2012) "China Invests in Europe: Patterns, Impacts and Policy Implications", *Rhodium Group Report*, (June).
- Harvey, D. (2006) *Spaces of Global Capitalism: Towards a Theory of Uneven Geographical Development*, (New York/London: Verso).
- International Monetary Fund (2011) "Reforms Key to Italy's Efforts to Outgrow Crisis", *IMF Survey: Italy Economic Review*, (10 July). See: www.imf.org/external/pubs/ft/survey/so/2012/car071012a.htm. (Accessed 1 August 2012).
- Istituto Affari Internazionali, Manchester Institute of Innovation Research & Institut des Relations Internationales et Stratégiques (2010) "Study on the Industrial Implications in Europe of the Blurring of Dividing Lines between Security and Defence", *Report for the European Commission*, (June).
- Kganyago, L. (2012) "The Impact of the Eurozone Crisis on African Economies", *speech to the NEPAD Business Foundation*, Sandton (17 April).
- Kaplan, R.D. (2009) "The Revenge of Geography", *Foreign Policy*, (May/June).
- Kennedy, P. (1988) *The Rise and Fall of the Great Powers: Economic Change and Military Conflict from 1500 to 2000*, (London: Unwin Hyman).
- Keohane, D. & Blommestijn, C. (2009) "Strength in Numbers? Comparing EU Military Capabilities in 2009 with 1999", *EU*

- Institute for Security Studies Policy Brief*, (Paris: EU Institute for Security Studies).
- Kjellén, R. (1916) *Staten som Lifsform*, (Stockholm, Gebers).
- Krugman, P. (2011) "Portugal? O Nao!", *New York Times*, (10 January) See: <http://krugman.blogs.nytimes.com/2011/01/10/portugal-o-nao/>. (Accessed 15 August 2012).
- Liberti, F. (2011) "Defence Spending in Europe: Can we do Better without Spending More?", *Notre Europe Policy Paper*, (June), No. 46.
- Lojsch, D.H., Rodriguez-Vives, M. & Slavik, M. (2011) "The Size and Composition of Government Debt in the Euro Area", *Occasional Paper*, (October), No. 132.
- Maulny, J.P. (2010) "L'Union européenne et le défi de la réduction des budgets de défense", *Les Notes de l'IRIS*, (September).
- Mölling, C. & Brune, S.C. (2011) "The Impact of the Financial Crisis on European Defence", *Study for the European Parliament*, (April).
- Morgenthau, H.J. (1978) *Politics Among Nations: The Struggle for Power and Peace*, (New York: Alfred A. Knopf).
- O'Donnell, C. (2012) "Integrating the EU Defence Market: An Easy Way to Soften the Impact of Military Spending Cuts?", *EU Institute for Security Studies*, (12 July).
- OECD (2012a) "Country Statistical Profile: European Union", (18 January). See: www.oecd-ilibrary.org/economics/country-statistical-profile-european-union_20752288-table-eu. (Accessed 4 August 2012).
- OECD (2012b) "FDI in Figures", (July). See: www.oecd.org/industry/internationalinvestment/investmentstatisticsandanalysis/FDI%20in%20figures.pdf. (Accessed 2 August 2012).
- O'Tuathail, G. (1996) *Critical Geopolitics: The Politics of Writing Global Space*, (University of Minnesota Press).
- Panetta, L. (2012) "The US Rebalance Towards the Asia-Pacific", speech given at the 11th IISS Asia Security Summit on 2 June 2012, Singapore.
- Pisani-Ferry, J., Sapir, A. & Wolff, G.B. (2012) "The Messy Rebuilding of Europe", *Bruegel Policy Brief*, (March), No. 1.
- Pisani-Ferry, J., Sapir, A., Véron, N. & Wolff, G.B. (2012) "What Kind of European Banking Union?", *Bruegel Policy Contributions*, (June), No. 12.
- Roller, L.H. & Véron, N. (2008) "Safe and Sound: An EU Approach to Sovereign Investment", *Bruegel Policy Brief*, (November), No. 8.

- Schmidt, H. (1989) *Men and Powers: A Political Retrospective*, (New York: Random House).
- Simón, L. (2011) "The Euro-debt Crisis: From Finance to Geopolitics?", *RUSI Analysis*, (2 December).
- Simón, L. & Rogers, J. (2011) "British Geostrategy for a New European Age", *RUSI Journal*, (April), Vol. 156, No. 2.
- Stockholm International Peace Research Institute (2011) "Military Expenditure Data 1988-2011". See: <https://docs.google.com/spreadsheet/ccc?key=0AonYZs4MzIzIbDQyQWd3TDNMcXILVU1abFRKVEh4WEE#gid=0>. (Accessed 2 August 2012).
- Stockholm International Peace Research Institute (2012) "Arms Transfers Database".
See: www.sipri.org/databases/armstransfers/background. (Accessed 27 July 2012).
- Sutherland, D., Hoeller, P. & Merola, R. (2012) "Fiscal Consolidation: How Much, How Fast and By What Means?", *OECD Economic Policy Papers*, (April), No. 1.
- UNEP, UNDP & OSCE (2003) "Environment and Security: Transforming Risks into Cooperation – The Case of Central-Asia and South Eastern Europe". See: www.iisd.org/pdf/2003/envsec_cooperation.pdf. (Accessed 10 June 2012).
- Véron, N. (2011) "Markets, Politics and the Euro", *Vox*, (23 June).
- Whitney, N. (2011) "How to Stop the Demilitarisation of Europe", *ECFR Policy Paper*, (November), No. 40.

Dr. Arben Shehu

4. KRIZA EKONOMIKE DHE KRIMI I ORGANIZUAR

Abstrakt

Krimi i organizuar është trajtuar dhe studiuar si një fenomen i cili sjell në mënyrë të paevitueshme mungesë stabiliteti ekonomik, politik e shoqëror.

Lufta kundër krimit të organizuar ka përbërë në vazhdimësi një ndër drejtimet kryesore të kontributit të organizatave ndërkombëtare për fuqizimin e institucioneve në vendet e rajonit, por në të njëjtën kohë edhe një ndër kushtet bazë që duhet të plotësojnë qeveritë e këtyre vendeve për realizimin e aspiratës së integritetit në BE dhe në NATO.

Deri tani jemi mësuar që kriminalitetin ta trajtojmë si një prej faktorëve në dobësimin e stabilitetit dhe të sigurisë por se cili është efekti që sjellë kriza ekonomike në tendencat e tij është ende për t'u sqaruar.

Për të diskutuar në lidhje me këtë "feed-back" duhen pasur parasysh karakteristikat, aktiviteti, mënyra e organizimit dhe veçoritë e kriminalitetit në Shqipëri por edhe në vendet e tjera të rajonit.

Legjislacioni shqiptar dhe institucionet e përfshira në luftën kundër krimit të organizuar duhet të pasqyrojnë vetëdijen për karakteristikat e veprimtarisë së organizuar kriminale, zhvillimin dhe mënyrën e reagimit të saj ndaj situatës politike, sociale dhe po kështu asaj ekonomike.

Fjalë kyçe: krimi i organizuar, legjislacion, bashkëpunim ndërkombëtar, rajonal

Kriza ekonomike është një biznes planetar për organizatat kriminale. Klanet kriminale kanë ndërhyrë me prepotencë në bankat amerikane për të ricikluar miliona dollarë.¹⁰ Në Greqi përfitojnë nga korrupsioni dhe kryejnë aktivitete të paligjshme

¹⁰ www.repubblica.it Roberto Saviano "Mafie, i padroni della crisi Perché i boss non fanno crac" 27.08.2012

me karburantet. Në Spanjë infiltrohen në tregun e pasurive të paluajtshme dhe kanë si qëllim përfitime kolosale.¹¹ Europa tashmë duket se i është nënshtruar pushtetit të burimeve të të ardhurave të organizatave kriminale me shpresën se ato do të ndikojnë në rimëkëmbjen e tyre.

1. *Krimi dhe ekonomia*

Lidhja midis ekonomisë dhe krimit mund të shqyrtohet nga këndvështrime të ndryshme por për objektin e këtij shkrimi, të rëndësishme paraqiten dy prej tyre.¹² E para lidhet me analizën që bën teoria ekonomike për të shpjeguar sjelljen kriminale. E dyta lidhet me interesin që kanë ekonomistët për të analizuar se cilat janë efektet e veprimtarisë kriminale në sistemin ekonomik. Në lidhje me aspektin e dytë, duhet bërë një dallim i mëtejshëm ndërmjet veprimtarive kriminale pasi këto veprimtari mund të jenë:

- Aktivitete kriminale **me efekt shpërndarës**, në të cilat u merret disa individëve për t'ua dhënë të tjerëve (vjedhje dhe grabitje, por edhe korrupsioni etj.) si dhe
- Aktivitete kriminale të cilat konsistojnë në **prodhimin**, shpërndarjen dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve (prostitucioni, kontrabanda, tregtia e drogës e kështu me radhë).

Efektet e veprimtarisë kriminale në ekonomi mund trajtohen si në një perspektivë afat-shkurtër ashtu edhe në afat-gjatë. Për të vazhduar me analizën tonë duhet të kemi përcaktuar kuptimin e veprimtarisë kriminale dhe të sjelljes kriminale. Thjesht, koncepti “kriminale” duhet të konsiderohet si sinonimi i termit “e paligjshme”. Ekzistojnë përkufizime të ndryshme ndërmjet të cilëve po përmendim atë sipas të cilit:

“...aktivitetet e paligjshme janë si aktivitetet e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve, shitja përdorimi apo mbajtja e të cilave është i ndaluar me ligj, por edhe ato aktivitete që ndonëse ligjore, janë kryer nga subjekte të paautorizuar .”¹³

Termi “i paligjshëm” duhet të analizohet në një kuptim të gjerë. Në të, do të përfshihen edhe sjellje që ndonjëherë e kemi të vështirë për t'i konsideruar si të tilla psh: parkimi në një

¹¹ Mafie padroni della crisi, Perche I boss non fanno cracc .Roberto Saviano. 27.08.2012

¹² Giorgio Rhone *Ekonomia dhe krimi XXI Century* (2009)

¹³ Miratuar nga ISTAT Raporti 2008, fq. 2

zonë ku nuk lejohet, tregtimi i artikujve tregtare pa u pajisur me licencë.

Teoria ekonomike etiketon si kriminale të gjitha sjelljet dhe aktivitetet që janë të ndaluara me ligj, të tilla që nëse zbulohen janë të ndëshkueshme.

1.a Teoritë ekonomike të sjelljes kriminale

Sa më sipër ndihmon për të kuptuar mundësitë dhe shpjegimet e sjelljes kriminale bazuar në instrumentet e teorisë ekonomike.¹⁴ Një nga bazat e disiplinës është hipoteza e *vendimit racional*, sipas të cilës çdo subjekt bën zgjedhjen e preferuar rationale duke pasur parasysh alternativat që i janë vënë në dispozicion. Kjo teori mund të gjejë zbatim në subjektet që ushtrojnë aktivitete kriminale duke iu referuar racionalitetit, që e thënë ndryshe janë ato raste që udhëhiqen nga përfitimi. Megjithatë është e qartë se në përzgjedhjet që bëjnë individët, në fakt ka të përfshirë shumë më tepër se racionaliteti. Motivet apo ana subjektive e individit nuk janë të përfshira në teorinë e racionalitetit të vendimit dhe për këtë arsye nuk mund të trajtohen nga teoria ekonomike.

Duke iu referuar dallimit¹⁵ mes pasionit dhe interesit mund të themi se teoria ekonomike ka të bëjë kryesisht me pasojat e përzgjedhjes së interesit dhe jo të emocioneve. Në këtë këndvështrim teoria ekonomike nuk ka shumë për të thënë në lidhje me vepra të tilla penale si: vrasja në gjendje të tronditjes së fortë psikike, dhuna në familje etj. Megjithatë, ajo ndihmon për të kuptuar veprimet e kriminelëve në rastin e aktiviteteve të kryera nga organizatat kriminale të cilat karakterizohen nga fitime të jashtëzakonshme.

Sipas kësaj teorie, një individ vendos të thyejë ligjin, nëse përfitimi i pritshëm nga kryerja e një veprimi të tillë e tejkalon përfitimin e parashikuar për të njëjtin aktivitet të kryer në mënyrë të ligjshme. Duke cituar themeluesin e teorisë ekonomike të sjelljes kriminale Gary S. Becker,¹⁶ mund të themi se: *“Disa njerëz bëhen “kriminelë” jo për shkak se motivet e tyre themelore ndryshojnë nga ato të njerëzve të tjerë, por për shkak se përfitimet e tyre dhe kostot janë të ndryshme”*.¹⁷

¹⁴ Eide, Rubin, Shepherd 2006, për një më konciz , v Cooter, ULEN 20085, chaps. XI, XII.

¹⁵ Albert O. Hirschman “Pasionet dhe interesat. Argumentet politike për kapitalizmin para triumfit të tij”, 1977.

¹⁶ Çmimi Nobel për Ekonomi.

¹⁷ Krimi dhe ndëshkimi: një qasje ekonomike, “Journal of Political Economy” 1968, 76, 2, p. 176.

Teoria e *vendimmarrjes në pasiguri* ndihmon për të shpjeguar një tjetër tipar të sjelljes kriminale të vrojtuar, përkatësisht faktin se përse një person i cili mund të zgjedhë mes dy aktiviteteve, një të paligjshme dhe një të ligjshme, shpesh vendos të investojë burimet e veta në të dyja. Një shembull tipik është ai i evazionit fiskal. Shumë tatimpagues deklarojnë të gjitha fitimet dhe disa të tjerë nuk deklarojnë asgjë (pavarësisht se kanë aktivitet). Ekziston dhe një zonë e madhe gri e shkelësve të ligjit në mënyrë të pjesshme, të personave që deklarojnë vetëm një pjesë të të ardhurave të tyre. Këto subjekte sillen si investitorë, të cilët shpërndajnë pasurinë e tyre në aktivitete të ndryshme, dhe përmes kësaj tentojnë të zvogëlojnë rrezikun për zbulimin e shkeljeve. Kjo metodë përdoret nga ana e organizatave kriminale të cilat shpesh investojnë në aktivitete të ligjshme duke “infektuar” këto të fundit me metodat e tyre të paligjshme të pastrimit të parave .

Sipas teorisë ekonomike, një politikë racionale e zbatimit mund të synojë reduktimin e përhapjes së kriminalitetit, por fatkeqësisht duke mos arritur çrrënjosjen plotësisht por dobësimin. Ajo që duhet të theksohet është se në përgjithësi, politikat e hartuara për të luftuar kriminalitetin nuk janë tërësisht racionale. Kjo pasi politikat janë rezultat i vendimeve të marra në bazë të një zinxhiri të gjatë dhe kompleks organesh vendimmarrëse. Për më tepër, në rastin e politikave për të luftuar krimin, dështimi i koordinimit është një rezultat shpesh i pritshëm.

Për sa i përket dallimit mes aktiviteteve kriminale të shpërndarjes dhe atyre të prodhimit si shembuj klasikë të aktiviteteve të llojit të parë janë vjedhja, mashtrimi dhe grabitja. Prania e këtyre krimeve imponon kosto jo vetëm për viktimat direkte, por për shoqërinë në tërësi. Para së gjithash, ne kemi një vetëshkatërrim real të burimeve që lidhen me ushtrimin e aktiviteteve kriminale, si p.sh. të tilla që shkaktohen nga hajduti i cili thyen një dritare për të hyrë për të vjedhur në një apartament. Sigurisht që çdo aktivitet kriminal do të passjell reagim të individit dhe të shoqërisë.

Teoria ekonomike e krimit e përqëndron reagimin në rreth tre raste¹⁸:

- A) efekti i parandalimit “privat”,
- B) efekti i “parandalimit publik”,
- C) efekti i “rishpërndarjes së krimit”.

Çfarë efekti ka kriza ekonomike në rastin e aktiviteteve shpërndarëse dhe atyre prodhuese?

¹⁸ Cooter, ULEN 20085, fq. 470 e vazhdim.

Është e qartë se në rast krizash ekonomike i gjithë aparati shtetëror është i çorientuar. Gjithë energjia e aparatit shtetëror drejtohet në modifikimin dhe krijimin e mekanizmave financiare duke lënë mënjanë fushat e tjera shumë të rëndësishme për shoqërinë. Në këtë atmosferë rritet tendenca e kryerjes së krimeve ordinere (si vjedhjet, korrupsioni.) Kjo sepse vëmendja e organizmave shtetërore në luftën kundër krimit është e dobësuar, mekanizmat në dorën e këtyre organizmave ulen (fondet për përgjime, hetime speciale etj.), e për pasojë kriminalitetit lulëzon.

Por aktivitetet të cilat njohin shpërthimin e tyre në kohë krize ekonomike janë ato me karakter prodhues (trafikim i lëndëve naktike, pastrim i parave etj.)

Në rastin e veprave penale me karakter prodhues ky lloj aktiviteti kriminal zhvillohet në një ambient tërësisht paqësor në rast krize ekonomike. Kjo sepse ashtu sikurse do të shpjegohet më poshtë, të ardhurat nga këto lloj aktivitetesh përdoren nga institucionet bankare, dhe jo vetëm, për të rimëkëmbur shoqërinë.

Në të vërtetë kjo “ndihmë” është vetëm një kurth që e implikon ekonominë e ligjshme dhe e detyron atë t'i nënshtrohet më pas krimit pa kushte.

2. Efekti i krizës ekonomike

Kapitalet mafioze po përfitojnë nga kriza ekonomike europiane, dhe në përgjithësi nga kriza ekonomike për t'u infiltruar në kapilarët e ekonomisë së ligjshme. Gjithsesi, kapitalet mafioze nuk janë vetëm efekti i krizës botërore por janë para së gjithash shkak i saj, për shkak të prezencës së tyre në flukset ekonomike. Aq sa përfitimet e organizatave mafioze u konsideruan si i vetmi kapital investimi likuid në dispozicion të disa bankave për vitin 2008 në Itali.¹⁹

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar për periudhën janar 2007 - shtator 2009, bankat amerikane dhe europiane kanë humbur më shumë se 1 miliard dollarë në asete dhe jo në kredi të këqija. Shumë banka të mëdha dështuan, u shkrinë me institucione të tjera bankare. Në këtë mënyrë mund të evidentohet lehtësisht se cili ka qenë momenti i saktë në të cilin organizatat kriminale italiane, ruse, ballkanike, japoneze u bënë vendimtare për ekonominë ndërkombëtare.²⁰

¹⁹ Deklaratë e drejtuesit të sektorit të Drogës dhe Krimit në OKB, Antonio Maria Costa.

²⁰ www.repubblica.it Roberto Saviano “Mafie, i padroni della crisi Perché i boss non fanno crac”, 27.08.2012.

Kjo ka ndodhur në gjysmën e dytë të 2008, kur likuiditeti u bë problemi kryesor i sistemit bankar. Sistemi bankar ishte praktikisht i paralizuar për shkak të mungesës së gatishmërisë së bankave për të dhënë hua. Vetëm organizatat kriminale kishin mundësinë të investonin shuma të mëdha parash me qëllim pastrimin e tyre.

Një studim i fundit tregoi se 97.4% e të ardhurave nga trafiku i drogës në Kolumbi është ricikluar rregullisht nga kanalet bankare në SHBA dhe Europë përmes transaksioneve të ndryshme financiare.²¹ Sigurisht që diskutohet për shuma të tilla si qindra miliarda dollarë. Riciklimi është bërë përmes një sistemi aksionesh, një mekanizëm i cili identifikohet si ai i “kutive kineze”. Sipas këtij sistemi, paratë në mënyrë virtuale (sistemit bankar) kanë kaluar nga një vend në tjetrin dhe kur ato arrijnë në një tjetër kontinent janë pothuajse të pastra dhe mbi të gjitha humbasin gjurmët e këtij itinerari. Pra, kreditë ndërbankare filluan të finanohen sistematikisht me paratë që vinin nga trafiku i drogës dhe aktivitete të tjera të paligjshme. Disa banka u shpëtuan vetëm falë këtyre parave. Shumica e 352 miliardë dollarëve me burim tregtinë e drogës u zhytën në sistemin ligjor financiar dhe u ricikluan plotësisht. Kjo jo vetëm që dëshmon se në kohën e krizës, sistemi “imunitar” i bankave është shumë i ulët, por edhe se në kohën e rimëkëmbjes së ekonomisë fondet me prejardhje të paligjshme do të përcaktojnë politikat financiare të bankave. Kjo dinamikë është në bazë të diskutimit për peshën që organizatat kriminale kanë mbi ekonominë në kohë krize financiare.

Duke qënë se paratë e drogës janë kaq të dobishme për bankat dhe vendet që riciklojnë ato, lufta kundër drogës në shumë shtete perëndimore është bërë “me frena dore”, sidomos në kohën e krizës ekonomike në të cilën likuiditetit monetar shihet si një oaz në shkretëtirë. Në këtë mënyrë nga ana e strukturave shtetërore i kushtohet vëmendje vetëm fazës së prodhimit të aktiviteteve të organizatave kriminale, duke lënë pas dore fazën e pastrimit të parave. Pra, luftohet Mikroekonomia e drogës, por jo Makroekonomia. Mjafton të themi se në qoftë se në Kolumbi janë marr masa mjaft kufizuese për të parandaluar futjen në banka të shumave të mëdha të parave të cilat dyshohen me prejardhje të paligjshme, në SHBA ligji për privatësinë dhe fshehtësinë bankare lejon krijimin e një fondi bankar, pa e ditur origjinën e saj. Në këtë mënyrë lind dyshimi se institucionet amerikane dhe europiane nuk e kanë të lehtë të godasin grupet e rëndësishme me peshë në transaksionet financiare.

²¹ Gaviria dhe Daniel Alejandro Mejia Universiteti i Bogota.

Kapitalet kriminale po kthehen në banka edhe në Europë. Në këtë kontekst, momentet më kritike ishin kriza financiare në Rusi - shkaqet e të cilës i atribuohen edhe përhapjes së mafias ruse - dhe ajo globale e vitit 2003 dhe 2007-2008. Sektori financiar pati një gjendje pasigurie, dhe në këtë mënyrë bankat u treguan të gatshme për organizatat kriminale që kishin para për të investuar.

Bankat në Europë dhe me gjerë janë përdorur dhe po përdoren për mbledhjen e sasive të mëdha të fondeve të paligjshme të fshehura në miliarda dollarë që janë të transferuara mes bankave²². Nju-Jork dhe Londër do të bëheshin dy "lavanderitë" më të mëdha të parave të pista në botë. Gjatë krizës, bankat bëhen më të përshtatshme dhe mbi të gjitha të sigurta për riciklim.

3. Lufta kundër krimit të organizuar dhe kriza ekonomike

Organizatrat kriminale tradicionale që ekzistojnë pavarësisht se mbeten të lidhura ngushtësisht me territorin në të cilën ata operojnë nën kontroll të rëndë, kanë zgjeruar gradualisht fushat e tyre të ndikimit. Kjo për shkak të mundësive të ofruara nga globalizimi ekonomik dhe përhapja e teknologjisë, ngritja e aleancave me grupet kriminale në vende të tjera, si Cosa Nostra amerikane, organizatat kriminale Kolumbiane dhe Meksikane, mafia turke, Mafia ruse, mafia nigeriane, mafia shqiptare.

Vendet e Europës Lindore, janë të përfshira të gjitha në një sistem të organizuar. Këto organizata ose grupe kriminale të lidhura me rrjetet kriminale të qëndrueshme kanë zhvilluar me praktikitet marrëveshjet për të menaxhuar biznesin e përbashkët të paligjshëm, për të koordinuar njerëzit e tyre, paratë dhe median nëpërmjet ndarjes së zonave të influencës dhe të tregjeve. Ky program është kryer jo vetëm në lidhje me trafikun e drogës dhe pastrimit të parave të mëdha, por edhe në të gjitha aktivitetet e tjera të paligjshme.

Organizatrat kriminale përdorin në favor të tyre çdo ndryshim të trendit dhe faktorëve gjeopolitike pasi janë gjithmonë në kërkim të përfitimeve dhe në të njëjtën kohë ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekt në të njëjtat procese të natyrës gjeopolitike.

²² Kreu i seksionit të riciklimit të Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara, Jennifer Shasky Calvery, në shkurt 2012, gjatë një seance në konferencën mbi krimin e organizuar.

Krimi i organizuar modern ofron një gamë të shërbimeve për klientët potencial dhe nga kjo pikëpamje ky aktivitet nuk ndryshon nga një biznes normal. Tregtia e paligjshme në thelb është e lidhur me kërkesën për mallra dhe shërbime të paligjshme dhe është pikërisht kjo kërkesë në thelb të modifikimit të strukturës kriminale.

Kjo është fytyra më e re e krimit të organizuar, një organizatë kriminale i cila në dukje sa vjen dhe bëhet më e ngjashme me një organizatë kriminale transnacionale, e cila karakterizohet nga multi-trafikimi dmth mundësia e furnizimit me lloje të ndryshme të mallrave dhe shërbimeve të paligjshme.

Sipas të dhënave të reja organizatat e mëdha kriminale me strukturë tradicionale dhe hierarkike, për shkak të presionit nga organet shtetërore kanë zhvilluar një fleksibilitet operacional të admirueshëm. Ky organizim karakterizohet nga rrjete të vogla “të strukturave qelizore” të ngjashme me ato të grupeve terroriste, i përbërë nga një minimum prej tre deri në një maksimum prej pesë subjektsh. Ky sistem individësh të cilët pas një operacioni janë zhdukur apo zëvendësuar dhe shpesh pa gjurmë, sigurojnë vazhdimësinë e trafikut pa rrezik për qendrën e organizatës.

Fitimi është një motivim shumë më i fortë se përhapja e terrorizmit motivuar nga elementë fetarë apo çlirimtare.

Rrjeti i trafikantëve pa atdhe dhe pa kufij po ndryshojnë botën shumë më rrezikshëm se terroristët. Çdo aktivitet i paligjshëm gjeneron para e cila në një pjesë të madhe të saj pastrohet nëpërmjet operacioneve financiare.

Kriza aktuale ekonomike paraqet një rast të jashtëzakonshëm për t’u zgjeruar dhe forcuar për organizatat kriminale të cilat disponojnë sasi të mëdha parash. Përveç aktiviteteve ilegale tradicionale të narkotikëve edhe armëve organizatat kriminale janë drejtuar për nga veprimtari të cilat kanë fitime të mëdha dhe rrezik më të vogël si trafiku i qenieve njerëzore, kontrabanda farmaceutike, mbetjet toksike dhe mbeturinat, veprat e artit dhe së fundi krimet kompjuterike.

Ashtu sikurse pretendohet nga specialistët, krimi i organizuar nuk mund të luftohet vetëm. Askush prej vendeve dhe Qeverive nuk mund të jetë i suksesshëm kundër tij për shkak të eliminimit të kufijve dhe barrierave fizike të lëvizjes, atyre tregtare dhe ligjore.

Në këtë këndvështrim bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar mbetet rruga e vetme. Harmonizimi, përafrimi i legjislacionit si dhe ekzistenca e vullnetit të vërtetë për të ndëshkuar sjelljet kriminale është thelbi i këtij suksesi.

REFERENCA

- Aromaa, K., Lehti, M., *Foreign companies and crime in Eastern Europe*, Helsinki, 1996.
- Barbagli, M. (a cura di), *Perché è diminuita la criminalità negli Stati Uniti?*, Bologna, 2000.
- Becker, G.S., *Crime and punishment. An economic analysis*, in "Journal of political economy", 1968, LXXVI, pp. 169-217.
- Bertoni, A. (a cura di), *La criminalità come impresa*, Milano, 1997.
- Bini, M., *Il polimorfismo dell'impresa criminale*, in *La criminalità come impresa* (a cura di A. Bertoni), Milano, 1997, pp. 1-14.
- Blumstein, A., Cohen, J., Nagin, D. (a cura di), *Deterrence and incapacitation: estimating the effects of criminal sanctions on crime rates*, Washington, 1978.
- Bonger, W., *Criminality and economic conditions*, Bloomington, Ind., 1969.
- Box, S., *Power, crime and mystification*, London, 1983.
- Braithwaite, J., *Crime, shame and reintegration*, Cambridge, 1989.
- Clarke, C.T., *From criminet to cyber-perp: toward an inclusive approach to policing the evolving criminal mens rea on the Internet*, in "Oregon law review", 1996, LXXV, 10.
- Cook, P.J., Zarkin, G. A., *Crime and the business cycle*, in "Journal of legal studies", 1985, XIV, pp. 115-128.
- Cools, M.J.M., *Crime by employees in large corporations: the concept of employee crime*, in "Security journal", 1991, II, 1.
- Ehrlich, I., *Participation in illegitimate activities: a theoretical and empirical investigation*, in "Journal of political economy", 1973, LXXXI, 3, pp. 521-565.
- Green, G.S., *Occupational crime*, Çikago, 1990.
- Sutherland, E. H., *Principles of criminology*, Çikago, 1939 (tr. it: *La criminalità dei colletti bianchi e altri scritti*, Milano, 1986).
- Wilson, J. Q., Cook, P.J., *Unemployment and crime. What is the connection?*, in "Public interest", 1985, LXXIX, pp. 3-8

Kudret Selimaj

5. KONTEKSTI HISTORIK DHE DUKURITË E TERRORIZMIT NË EUROPE

Abstrakt

Terrorizmi, si një sfidë për sigurinë në tërësi, shfaqet në forma e në vende të ndryshme. Kjo ese përqendrohet kryesisht në terrorizmin në Europë. Ajo paraqet përqasje rreth përkufizimit të terrorizmit dhe përpjekjet për arritjen e një përcaktimi më të përgjithshëm të kufijve të këtij nocioni, nisur nga konteksti tradicional evropian si dhe mjedisi aktual i veprimtarisë terroriste. Synohen të qartësohen qëllimi strategjik i kësaj dukurie, shkaqet e faktorët për lindjen dhe zhvillimin e terrorizmit. Pas një përshkrimi të shkurtër, trajtohen fillesat dhe evoluimet ndër vite të disa organizatave terroriste në Spanjë e Francë dhe në Irlandën e Veriut, parë në rrafshin teorik e historik. Nëpërmjet këtij punimi teorik evidentohen drejtimit e synimet kryesore të këtyre organizatave kryesore terroriste dhe qartësohen tiparet e tyre specifike.

Hyrje

Mjedisi i ri gjeopolitik i mbas Luftës së Ftohtë karakterizohet nga probleme sigurie të një bote të fragmentizuar dhe me zhvillime të paparashikueshme, ku tipike e dalluese janë dukuri të tilla, si konfliktet e brendshme e ato ndërshtetërore, ushtrimi i dhunës dhe intoleranca, terrorizmi, të cilët bashkëjetojnë dhe mpleksen e veprojnë njëkohësisht me paqen, dialogun, demokracinë, stabilitetin dhe mirëqenien ekonomike.

Fenomeni i terrorizmit, që doli në pah si sfida kryesore e shteteve në shekullin XX me në krye SHBA dhe partneret e tyre euroatlantike, hyri në një epokë të re, me parametra e perspektiva të reja, duke lënë të anashkalohen probleme të tjera, njësoj imediate të njerëzimit, siç janë ato të zhvillimit të ekonomisë dhe të proceseve demokratike të vendeve të Botës së Tretë, borxhit të tyre të jashtëm, apo dhe problemet ambientale të rruzullit tokësor.

Deri më parë, kjo lloj veprimtarie ishte më shumë një metodë e aplikuar në luftërat me intensitet të ulët, por aktualisht ajo ka marrë përmasa të tjera. Edhe pse është zgjeruar hapësira e veprimit të akteve terroriste, janë sofistikuar format dhe teknikat e veprimit dhe është shtuar arsenali i armëve që përdorin. Në thelb, objektivat dhe synimet e tyre janë po ato të dhunës së egër e të pamëshirshme ndaj kundërshtarëve të vet deri në asgjësimin fizik të tyre.

Kërcënimet nga veprimet terroriste janë rritur sot në të gjithë botën. Kjo për shkak se terroristët jo vetëm se janë sot më të pajisur se kurrë, por edhe më pak të identifikueshëm se më parë. Terroristët përdorin dhunën ose kërcënimin me anë të dhunës, të drejtuar kundër objektivave njerëzore ose jonjerëzor për të mbjellë frikë, duke detyruar qeveritë ose kërcënuar shoqërinë për motive politike.

“Kjo e keqe e ditëve të sotme, e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me dukuri të tjera të përafërta mbarëbotërore, si krimi i organizuar, pastrimi i parave, trafiku ilegal i armëve, drogës dhe qenieve njerëzore është një kërcënim real për të gjitha vendet dhe popujt. Prandaj vëmendja jonë duhet të përqendrohet fuqimisht tek instrumentet e duhur dhe më të përshtatshëm për të luftuar vetë bazat dhe burimet e terrorizmit, duke marrë në konsideratë të dy aspektet: aspektin ndërhyrës dhe atë parandalues. Madje, duke e klasifikuar luftën kundër terrorizmit si një tip të ri lufte dhe, për më tepër, duke e radhitur atë si elementin më të rrezikshëm ndaj sigurisë kombëtare dhe asaj botërore...”* (Meidani, 2003)

Në këtë mënyrë shfaqet një nevojë imediate për studimin e fenomenit të terrorizmit dhe të pasojave të tij në strukturat e sigurisë, si në kuadër ndërkombëtar, ashtu edhe në kontinent, rajonin tonë e në secilin vend. Kështu nevojitet studimi i formimit të regjimeve të sigurisë rajonale, studimi i mjeteve politike, ushtarake e ekonomike të cilat shtetet preferojnë të venë në përdorim në funksion të rritjes graduale të bashkëpunimit në nivele të caktuara të politikës së jashtme, si dhe studimi i frymës së re që erdhi në politikën e të vetmes superfuqi të shekullit XX, të SHBA.

Interesat kombëtare shqiptare sot janë më shumë se kurrë të kërcënuara nga veprimet terroriste, për shkak të angazhimeve politike dhe ushtarake të shtetit shqiptar, anëtarësinë në NATO dhe aleancës me SHBA, pjesëmarrjen në iniciativat ndërkombëtare, angazhimeve për ngritjen e shtetit të bazuar në ligj, paqëndrueshmërisë politike rajonale, etj. Terroristët besojnë se duke kërcënuar nëpërmjet veprimeve të terrorit do të

detyrojnë Shtetin Shqiptar të heqë dorë nga detyrimet e tij politike dhe të përmbushë kërkesat e tyre.

Në tërësinë e veprimeve terroriste më të zakonshme përfshihen vrasjet, zjarrvëniet, aktet shkatërruese, marrjet peng, rrëmbimet, sulmet, sabotimet dhe mashtrimet. Më pak të mundshme nga ana e terroristëve mund të jenë përdorimi i armëve speciale dhe dëmtimi i ambientit.

Krahas shkrimeve të vijueshme për terrorizmin sidomos këto dhjetë vjetët e fundit, ende meritojnë më shumë vëmendje e trajtim në rrafshin teorik, por edhe në kontekstin historik, aftësitë, mundësitë dhe qëllimi i terroristëve në mjedisin europian e rajonal, pasojat që rrjedhin prej tyre, krahas shqyrtimit të lëvizjeve të ndryshme terroriste, ndikimit të ideologjive politike dhe besimeve fetare në motivet e terroristëve, mjedisit operacional të terroristëve si dhe analizës së psikologjisë së terroristëve. Kjo edhe për faktin se terrorizmi nuk përbën thjesht një taktikë.

Parë nga ana teorike, terrorizmi nuk përbën aspak një kërcënim të ri. Vetëm përhapja, komplikimi e ndërvarësia e disa faktorëve të zhvillimit, shkalla dhe intensiteti i tij paraqesin dukuri të reja. Ndryshe nga e kaluara, kur nëpërmjet terrorizmit përgjithësisht janë zgjidhur detyra të niveleve taktike, në mjedisin aktual terrorizmi zgjidh detyra të shkallës strategjike. Nisur nga kjo, përballimi i këtij dimensionit të ri strategjik të luftës, kërkon një mënyrë të re të menduari, teknologji të reja dhe organizim tërësisht të ri e, për më tepër, një konceptim të ri, të thellimit në brendinë dhe elementët ndërthurës të tij.

Strategjitë e luftës kundër terrorizmit synojnë të frenojnë këto kërcënime nëpërmjet operacioneve antiterroriste dhe kundërterroriste. Operacionet antiterroriste përfshijnë masa mbrojtëse për të zvogëluar cenimin e personelit dhe pasurisë nga sulmet terroriste. Operacionet kundërterrorizmit lidhen me masat sulmuese për të parandaluar, zvogëluar dhe përgjigjur veprimeve terroriste. Si të gjithë operacionet joluftarake, edhe në veprimet mbrojtëse dhe sulmuese ndaj terrorizmit, vetëpërmbajtja përbën një kërkesë të veçantë. Përdorimi i forcës tejkaluese mund të dëmtojë civilët, të çekuilibrojë opinionin publik dhe atë ndërkombëtar e rajonal dhe ndryshojë përqendrimin e përpjekjeve.

Përkufizimi i terrorizmit

Terrorizmi në përgjithësi është një vepër e paligjshme e dhunshme ose kërcënim për përdorim dhune, që synon krijimin e frikës për të ndryshuar sjelljen e të tjerëve për qëllime politike. Fjala

terrorizëm do të thotë: dhunë e paramenduar ndaj masës jo luftuese me qëllim ndikimin e opinionit publik për të arritur më pas, në goditjen e objektivave me natyrë politike, ushtarake apo ideologjike. Për rrjedhojë, marrin kuptimet e tyre fjalët terrorist dhe terrorizoj.

Terrorizmi konsiston në kryerjen e një krimi nga një individ, një grup apo nga një shtet. Terrorizmi përdoret për të ngjallur te njerëzit një ndjenjë frike e cila në shumë raste është shumë më e madhe se pasojat e vërteta të aktit. Këto akte kanë për objektiv goditjeje popullsinë ose institucionet e strukturat e rëndësishme të një shteti. Shkaqet e terrorizmit janë politike, për destabilizimin e një shoqërie por edhe për hakmarrje. Qëllime të ndryshme kanë çuar në themelimin e organizatave të veçanta të cilat më pas nëpërmjet mesazheve të tyre me karakter politik ose fetar ngjallin frikë dhe panik në radhët e popullsisë. Shumë ide politike janë instrumentalizuar nga organizata terroriste për të justifikuar veprimet e tyre. Si rrjedhojë, grupe terroriste ekzistojnë mbi baza ideologjike apo fetare si dhe faktorë të ndryshëm, si p.sh. nacionalizmi, seperatizmi, egocentrizmi.

Ndonëse ky term ka lindur në shekullin XVIII, metodat e konceptimit, planëzimit, realizimit e bashkërendimit të elementëve përbërës të tij kanë ekzistuar gjithnjë. Për shembull: në perandorinë romake grupe vrasësish vrisnin legjionarët që patrullonin kufirin. Ndonjëherë, terrorizmi përdoret edhe për të bërë presion. E para që ka përdorur këtë lloj terrorizmi ka qenë në 1871 qeveria e Tierit kundër pushtuesit prus. Terrorizëm të kësaj natyre ka përdorur Franca gjatë luftës në Algjeri kur ishte nën udhëheqjen e gjeneralit de Gol (de Gaulle) por gjithashtu edhe Britania e Madhe në Irlandën e Veriut.

Terrorizmi, sipas disa analistëve europianë, përbën përdorimin e qëllimshëm të dhunës ose të kërcënimit për përdorimin e dhunës, nga ana e grupeve të segmenteve të një vendi të caktuar ose të një shteti sovran të caktuar, për të arritur objektiva radikalë strategjikë e politikë nëpërmjet akteve të paligjshme të frikësimit.

Terrorizmi është diçka sentimentale e paramenduar dhe e mirëllogaritur. Masakra është një mjet për të arritur qëllimin, është pjesë e atmosferës së tronditjes dhe të frikës që dëshiron e paracakton të krijojë terroristi, me qëllim që të dobësojë autoritetet dhe të fitojë vëmendjen e opinionit publik për realizimin e qëllimit të tij të veçantë.

Në kërkim të një përcaktimi sa më të plotë, mjaft studiues arrijnë në përfundimin se terrorizmi është dhunë e paramenduar dhe e motivuar politikisht kundër objektivave jo luftuese nga

grupe ndërkombëtare apo agentë klandestinë, me qëllim nënshtrimin e një audience.

Mjaft përkufizime të përafërta mund të gjejmë në librin e Aleks P. Schmid "Terrorizmi Politik" në të cilin shihet qartë se deri tani, megjithëse këto përkufizime janë të përafërta ato dallojnë nga njëri-tjetri, sepse shprehin në një farë mënyre edhe qëndrimin e qeverive dhe autoriteteve me kombësi të ndryshme që kanë një këndvështrim jo të njëjtë në lidhje me terrorizmin. Pra, në një situatë të tillë kur ideologjia, politika dhe besimi fetar janë të pleksuara e përfshirë së bashku, një përkufizim i përgjithshëm, i saktë dhe i përbashkët është vështirë të arrihet. Nga kjo është e kuptueshme se thënia që "Një njeri terrorist nga njëra anë, është një luftëtarë i lirisë nga ana tjetër" është produkt i sistemit ndërkombëtar.

Gjithsesi, thelbi i gjithë përkufizimeve është pak a shumë i njëjtë, por problemi më tepër qëndron në pikën më delikate, atë të përcaktimit se kush janë terroristët. Ky problem ka ekzistuar dhe shpesh ka qenë një shkak për interpretime të ndryshme nga shtete të ndryshme, për të njëjtin grupim ose lëvizje të armatosur.

Departamenti i Mbrojtjes i ShBA-së jep një përkufizim më të përgjithshëm e disi më të specifikuar të terrorizmit, duke e përcaktuar atë si përdorim të paramenduar të dhunës ose i kërcënimit për dhunë, për të ngjallur frikë, i destinuar për të shtrënguar ose në përpjekje për të frikësuar qeveritë apo shoqëritë për arritjen e qëllimeve që janë përgjithësisht politike, fetare ose ideologjike.

Në ditët e sotme ka shumë dilemë në lidhje me përcaktimin e terrorizmit. Përcaktimi i terrorizmit si armë e të dobëtëve dhe si një kundërpërgjigje e justifikuar ndaj një kundërshtari më të fortë do të krahasohet me faktin se shumë akte terroriste janë kryer ndaj popullit të vet (atentatet në Spanjë). Gjithashtu në ditët e sotme vërehet se si aktorë të rinj, teknologjitë dhe taktikat e reja po ndryshojnë natyrën e terrorizmit, ku theksojmë faktin se efekti më i madh i tij është të shumëfishojë forcën nëpërmjet përhapjes së frikës. Duke ju referuar një thënie të strategut të shquar kinez Sun Tzu "Të pushtosh duke luftuar në të gjitha betejat tuaja nuk është arritja më e shkëlqyer, ajo do të ishte nëse ju e thyni armikun pa luftuar". Kjo është dhe esenca e terrorizmit, thyerja e rezistencës së armikut nëpërmjet përhapjes së frikës. Kjo frikë mund t'i detyrojë disa shtete të terrorizojnë veten më shumë se terroristët, gjë që mbetet një nga sfidat më delikate në hartimin e strategjisë kundër terrorizmit.

Gjithësesi, pavarësisht nga përpjekjet e bëra në vijim, fenomeni i terrorizmit për sa i përket përcaktimit të tij, nuk ka gjetur një

trajtim unik. Pas ngjarjeve tronditëse të 11 shtatorit 2001, relativisht ka një përjasje edhe në kontekstin europian e atë rajonal të konceptimit të dukurive të terrorizmit e të luftës kundër tij. Theksi vihet në tipare të tilla të fenomenit, si dhuna e paramenduar e cila qëndron në thelbin e vetë veprimtarisë së terrorizmit. Kjo dhunë, përgjithësisht është vlerësuar se ka në bazën e saj motivet politike, me objekt të goditjeve të natyrave të ndryshme, për të ndikuar në tërësi në një mjedis të përcaktuar qartazi që më parë.

Qëllimi i terrorizmit dhe shkaqet e lindjes së tij

Përgjithësisht, terrorizmi përkufizohet si “Përdorim i dhunës dhe frikësimit për të nënshtruar njerëzit ose për të arritur një qëllim apo synim”, ndërsa studiuesi i lashtësisë kineze, Sun Tzu e koncepton terrorizmin në këtë mënyrë *Vrit një që të frikësosh dhjetë mijë”.

Aktet terroriste përbëjnë krim, për shkak të karakterit të tyre të paligjshëm (vrasje, rrëmbim personi, dëmtim i pasurisë së përbashkët ose private etj) dhe nuk gjen asnjë justifikim në impenjimin ideologjik edhe në objektivat politikë të atyre që e shkaktojnë atë.

Qëllimi strategjik i terrorizmit në kryerjen e këtyre akteve të paligjshme është gjithashtu i rëndësishëm, sepse akte të tilla synojnë të krijojnë një frikë të madhe të përgjithshme te një kategori popullore e pikësnyuar që është më e madhe se civilët apo ushtarakët e sulmuar apo kërcënuar. Nisur nga qëllimi i paracaktuar, terrorizmi përbën një zgjedhje të paramenduar politike, nga aktorë të ndryshëm, të cilët përdorin tërë fuqinë e tyre për të shkakuar dëmtime me pasoja të rënda. Përdorimi i forcës prej terroristëve përbën një akt të qëllimshëm për të shkatërruar e shkakuar vrasje e plagosje, për të ndikuar në sjelljen e të tjerëve, për t’iu imponuar atyre vullnetin e terroristëve, për të detyruar në marrjen e vendimeve dhe bërjen e përzgjedhjeve në përputhje me këtë lloj imponimi.

Ndonëse pasojat e veprimeve terroriste janë të ankthshme, tronditëse e të padurueshme, me mjaft rëndësi konsiderohen jo thjesht dhimbjet apo dëmtimet që shkaktohen, por veçanërisht ndikimi në aspektin social, në sjelljen dhe qëndrimet e atyre që bëhen objektiva të goditjes.

“Dhuna sporadike, në krahasim me dhunën e gjatë e të pandërprerë, rezultojnë të jetë më efektive nga ana psikologjike, duke krijuar frikë, ankth si dhe ndjenjën e cenueshmërisë si dhe gërryerjen e dëmtimit e mjeteve të besimit, solidaritetit, bashkëpunimit dhe ndërvarësisë së shoqërisë.” (Alison M. Jagger, 2005)

Në funksion të qëllimit të paracaktuar, terroristët qartësojnë dhe realizojnë objektivat e goditjes, si shkatërrim të sistemeve, sulm mbi objekte të caktuara, eliminim të personave apo grupe personash të veçantë etj.

Qëllimi politik, sipas elementëve përbërës, dallon terrorizmin nga krimi i zakonshëm dhe ai i organizuar. Qëllimi politik, në vetvete, është shprehje e gjendjes përfundimtare të dëshiruar. Ai shpreh udhëheqjen dhe orientimet e udhëzimet për përdorimin e mjeteve e të instrumenteve të caktuara. Për arritjen e këtyre qëllimeve përqendrohet në vendin dhe kohën e duhur, në çastin vendimtar, me fshehtësi, mjeshtëri e befasi fuqia goditëse dhe shtrënguese apo edhe përpjekjet për arritjen e bindjeve, për përmbushjen e qëllimeve përkatëse. Terroristët, si dhe propaganda subversive ndjekin qëllime politike ndryshe nga krimi i zakonshëm dhe ai i organizuar, të cilët përgjithësisht ndjekin qëllime ekonomike. Qëllimi politik i terrorizmit, si një mënyrë e kalkuluar strategjike e të menduarit, synon minimin e zhvillimit normal të funksionimit të shtetit, ndryshimin e mjedisit strategjik apo të rrethanave strategjike. Në shërbim të qëllimit të paramenduar, terroristët mbajnë në konsideratë e vlerësojnë më përparësi veçanërisht të kuptuarit e kulturave, bindjeve e pikëpamjeve të kundërshtarëve të tyre, të aleatëve aktualë e të mundshëm si dhe të asnjansëve.

Qëllimet e një organizate terroriste nuk janë përherë të qarta dhe për më tepër, mund të ndryshojnë vazhdimisht. Përveç kësaj, qëllimet terroriste hartohen në mënyrë shumë radikale, me synimin e vetëm për të përjetësuar organizatën terroriste. Disa analistë marrin në konsideratë edhe një fakt tjetër, atë se për realizimin e qëllimeve të tyre terroristët krahas dhunës përdorin edhe negociatat.

Të gjitha format dhe mjetet e dhunës së paramenduar terroriste qëndrojnë gjithnjë në shërbim të arritjes së përfundimeve të caktuara politike. Krahas kësaj, drejtim tjetër i këtyre formave e mjeteve është krijimi i panikut dhe vendosja në gjendje frikësimi, paniku e pasigurie e opinionit publik apo e një pjese të këtij opinionit publik.

Terrorizmi tenton të manifestohet (të shfaqet) me intensitet të ndryshëm, si fenomen i pranishëm në zonat urbane, në nivel pse jo edhe global. Terrorizmi ushqehet nga urrejtja e armiqësisë, të cilat çojnë në një mjedis strategjik krejt të ri, gjenerojnë efekte dhe rezultate strategjike, mund të kenë konsekuenca politike, përfundojnë në një situatë dhune të pakufishme, në anomali dhe në standarde ekstreme të veprimit.

Faktorët që çojnë në terrorizëm janë të ndryshëm dhe shpesh të pashpjegueshëm, të palogjikshëm, për vetë faktin e pasojave

shpesh katastrofike që i sjellin vetë njerëzimit, duke vënë në plan të parë synimin për asgjësimin e kundërshtarit apo edhe vetë një sistem shtetëror apo pjesë të institucioneve të caktuara të tij.

Përmasat e urrejtjes terroriste rriten së tepërmi, aq sa terroristët arrijnë në gjykimin dhe vendimin se e vetmja rrugë është asgjësimi i kundërshtarit, nëse ky i fundit nuk heq dorë nga qëndrimet, format e sjelljes dhe vendimet e mëparshme, përpara kryerjes së aktit terrorist. Për më tepër, terroristët qartësojnë, përcaktojnë e kanë pikësynim sidomos përmasat e ndryshimit të ardhshëm të planëzuar, njëherazi me realizimin e përshtatjes me situatën e re e në vijim që arrihet.

Nëpërmjet mjeteve të dhunshme ose kërcënimit për përdorimin e dhunës, për ndryshimin radikal të strukturave të caktuara apo edhe për ndryshimin e menjëhershëm e të ndjeshëm të kushteve të caktuara, terroristët bazohen në strategji dhe plane të hartuar e përpunuar që më parë. Kështu, në lidhje me kundërshtarin, terroristët paraprakisht përcaktojnë me kujdes faktin se çfarë vlerëson më shumë ky kundërshtar dhe atë se në hapësirën strategjike dhe në rrethanat strategjike të krijuara, cilat janë pikat më të dobëta të tij, duke bërë të mundur që edhe veprimet sado të vogla, me pak përpjekje me burime jo të shumta materiale dhe jomateriale të kenë ndikime të konsiderueshme strategjike.

“Rezultati apo ndikimi strategjik në terrorizëm është të krijojë një ndjenjë dobësie, kërcënimi e frikësimi. Ai është parashikuar të krijojë një gjendje frike që është e madhe dhe mjaft e qëndrueshme për të ndikuar sjelljet e aktorëve të caktuar.” (Tilly, 2004)

Terrorizmi mund të lulëzojë në regjime demokratike, i frymëzuar nga njerëz që kërkojnë pushtetin dhe nga paaftësia e tyre për ta marrë këtë me mjete demokratike, përdorin dhunë. Kjo vihet re sidomos në momente kyçe të veprimtarive e funksioneve të shtetit, siç janë zgjedhjet e ndryshme presidenciale, parlamentare e lokale.

Terroristët përbëjnë një subjekt kompleks, jo thjesht në pikëpamje të organizimit e funksionimit të veprimeve të tyre, por edhe në lidhje me motivimin e tyre e të njerëzve në tërësi. Jo pak herë përzierja e motiveve politike rezulton e padallueshme menjëherë nga motivet e karakterit personal. Në këtë kuadër, në mjaft raste shtypi nëpërmjet lajmeve të tij sensacionale rrit vlerën e akteve terroriste duke bërë që akti terrorist pasardhës të jetë dhe më i dhunshëm, në mënyrë që të tërheqë më tepër vëmendjen e njerëzve dhe njëkohësisht të shtojë më tepër frikën e pasigurisë. Shtypi është gjithnjë e më tepër konkurrent që kërkon vënien në garë të çdo informacioni, duke harruar shpesh çmimin që paguhet.

Nga format më të përhapura të terrorizmit aktualisht konsiderohen terrorizmi me origjinë konfliktin nacional-etnike; terrorizmi me origjinë konfliktin ideologjiko-fetar. Terrorizmi me

originë konfliktin nacional-etnik ka përhapje të gjerë, ku veçohet IRA në Irlandën e Veriut, ETA në Spanjë etj. Ndërsa terrorizmi me originë konfliktin ideologjik e politik, paraqet një formë tjetër dukurie, ku më tipike paraqiten organizata RAF në Germani, Brigata Rossa në Itali, Organizata terroriste 17 Nëntori në Greqi. Synimi i tyre është shkatërrimi i sistemeve kapitaliste në vendet e zhvilluara dhe realizimi i një barazie sociale. Por ka edhe një krah të djathtë me synime të kundërta me ato të majta, aktivitetet të shtuar kanë sidomos kundër të huajve në Europën Perëndimore.

Terrorizmi me origjinë konfliktin ideologjiko-fetar, si përfaqësues më të spikatur ka lëvizjet integraliste Islamike me burim kryesor Lindjen e Mesme.

Fillesat e terrorizmit dhe zhvillimi i tij

Përdorimi i terrorit për arritjen e qëllimit nuk është diçka e re. Aktet e dhunshme ose kërcënimet me dhunë janë përdorur historikisht për të frikësuar individë apo qeveri në mënyrë që ato t'iu binden kërkesave të terroristëve. Terrorizmi në një farë mënyre mund të quhet si lufta e të varfërve pasi në përgjithësi nuk kushton shumë financiarisht, ka rrezikshmëri më të ulët, është shumë efektiv dhe lejon të dobëtin të sfidoj të fortin. Prandaj dhe sot ai shikohet i shtrirë në ato vende që janë të pafuqishëm politikisht, ekonomikisht e ushtarakisht që të imponohen për zgjidhjen e problemeve të tyre kombëtare, ideologjike apo religjioze.

Terrorizmi ka qenë një taktikë e njohur për të arritur objektiva politike që në përdorimin e parë të njohur nga historia prej Jul Cezarit i cili e kishte si praktikë të merre robër për të siguruar nënshtrimin e tribunave të mundura. Duke u afruar në kohë, masakra e përgjakshme e Shën Bartolomeut e 23-24 gushtit 1572 dhe "terrori" i zyrtarizuar nga Jakobinët në vitet 1791-1794, në kërkim të republikës duke asgjësuar Aristokracinë, përbëjnë shembuj klasik të terrorizmit. Giotina Jakobine asgjësoi rreth 40.000 vetë në Francë gjatë asaj kohe dhe efekti më i madh i saj ishte frikësimi i njerëzve me këtë terror. Për të kaluar më vonë, terrorizmi shtrihet edhe në Terrorin "e Bardhë" dhe "të Kuq" të Revolucionit e Kundërrevolucionit Rus në 1917-1918. Në aspektin historik, terrorizmi ka qenë një metodë mjaft e përdorur, ku mjaft diktatura e kanë zbatuar në mënyra të ndryshme terrorin për të arritur qëllimet e tyre politike ose religjioze.

Gjatë pjesës së fundit të shekullit të kaluar, dhuna terroriste u përhap në shumë vende duke u bërë kështu një mënyrë serioze e shprehjes së qëndrimit politik. Në aspektin e trajtimit linear historik, një shembull terrorizmi është terrorizmi serb, një princip që bëri të mundur vrasjen e arkidukës Franc Ferdinandit në

Sarajevë në prag të Luftës së Parë Botërore dhe që me kalimin e kohës është zhvilluar në mënyrë dramatike deri në terrorizmin e organizuar shtetëror nën diktaturën e Millosheviçit në dhjetë vitet e fundit të shekullit të kaluar, gati në të gjithë territorin e ish-Jugosllavisë. Nga ana tjetër, në qoftë se më parë aktet terroriste kanë qenë trajtuar si incidente, me kalimin e kohës ky ndikim është rritur, deri në shkaktimin e një numri shumë të madh viktimash, duke u shndërruar në sfidën e kohës së sotme e të ardhshme.

Zhvillimi i strukturave të terrorizmit është bërë në të njëjtën kahje kohore duke modernizuar e sofistikuar strukturën dhe përbërjen e celulave të tij deri në organizata terroriste ndërkombëtare si Xhihadit Isalmik, Al-Kaeda e shumë organizata të tjera që janë në afërsi të vendeve të origjinës edhe në disa shtete pse jo edhe kontinente. Në aspektin e modernizimit strukturat terroriste kanë kaluar në një stad të ri të shfrytëzimit të teknologjive moderne të pajisjeve të komunikimit, mjeteve e armatimeve të veprimit luftarak dhe të eliminimit të informacionit dekonspirues. Statistikat tregojnë se 20 vjetët e fundit numri i akteve terroriste në Europë është në rritje dhe gjeografia e përhapjes së tyre është zgjeruar, janë shtuar dëmet materiale dhe viktimat si rezultat i përdorimit të mjeteve gjithnjë e më të sofistikuar.

Në Ballkan e sidomos në atë Perëndimor, terrorizmi nuk është një dukuri e panjohur. Në historinë e terrorizmit në rajon evidencohen mjaft viktima të shquara, si Arkiduka Ferdinand në vitin 1914; Gjenerali Aleksander Protogeroff në vitin 1928; historiani Milan Shufli në vitin 1931; Drejtori i Agjencisë Jugopress, Toni Schlegel në vitin 1929; mbreti i Jugosllavisë, Aleksandër Karadjeordjevic bashkë me ministrin francez, Louis Barthou në vitin 1934. Përveç këtyre, lufta e lëvizjes ORIM kundër një fraksioni tjetër maqedonas shkaktoi në të njëjtët vite 884 viktima dhe në vitin 1924 në Zagreb shpërtheu një tren i tërë për të vrarë një delegacion politik që ishte i gatshëm të nënshtrohej ndaj Mbretit Aleksandër.

Gjatë shekullit 20, kërcënimi në Ballkan është karakterizuar para së gjithash nga synimet nacionaliste e objektivat rajonalë. Gjithashtu, gjatë konflikteve të viteve 1990, terrorizmi nuk u eksportua jashtë siç kishin frikë disa vende europianoperëndimore.

Megjithatë, luftërat që shpërthyen në vitet 1990 në Ballkanin Perëndimor e shndërruan atë në një terren kultivues për mbartjen e terrorizmit të huaj e grupeve islamike xhihadiste. Këto grupe ishin duke shfrytëzuar mungesën e sigurisë e

paqëndrueshmërinë politike, ekonomike e shoqërore që vinte si rrjedhojë e kësaj mungese, çka e bëri rajonin një zonë tërheqëse, për krijimin e lehtësirave stërvitore e rekrutuese.

11 shtatori 2001 në Ballkanin Perëndimor u paraqit si një paradoks, nga njëra anë, vendet perëndimore e kuptuan kërcënimin real që ekzistonte në rajon: kërcënimi terrorist që ndryshon thellësisht prej të mëparshmit sepse nuk lidhej më me pretendime nacionaliste ose objektiva rajonale, por mbështetej në një rrjet transnacional që synonte ta “eksportonte” terrorizmin jashtë.

Europa ka një trashëgimi të sulmeve të dhunshme terroriste që shkon prapa në kohë deri te perandoritë multietnike të Rusisë, Austro-Hungarisë dhe Gjermanisë. Në vitet 1960 dhe sidomos në vitet 1970, kontinenti, përfshi Suedinë, përjetoi një numër sulmesh terroriste. Në Angli, Spanjë dhe Francë bombardimet terroriste ndodhin në intervale të rregullta. Në shumë drejtime sulmet e armatosura të të “tjerëve” shfaqin sfida tradicionale ndaj sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo formë e dhunshme e protestës kundër rendit ekzistues politik do të jetë me ne për një kohë të gjatë.* (Sundelius, 2006)

Në vitet '70 Europa ishte në qendër të akteve terroriste. Baskët dhe IRA morën një opinion të keq për shkak të atentateve të tyre vdekjeprurëse. Grupe terroriste kishte gjithashtu në Itali, të përfaqësuar nga Brigadat e Kuqe, në Gjermani nga grupi Baader-Mainhof, në Greqi me 17 Nëntorin etj.

Opinion i publik perëndimor dhe qeveritë përkatëse nuk i morën seriozisht këto grupe, por kur vrasjet arritën nivele të larta (në Itali u rrëmbye dhe u vra ish-kryeministri dhe lideri demokristian Aldo Moro), atëherë politika ndryshoi rrënjësisht liberalen.

Në shfaqjet e terrorizmit të sotëm shpesh është e vështirë të dallosh një akt terrorist të motivuar politikisht prej dhunës së shfaqur nga kriminelë apo individë në një shoqëri të gjerë. Krahas këtyre, të vështirë dhe të diskutueshme e me vlerësime të kundërta, paraqiten lëvizjet e armatosura me karakter çlirimtar nga popuj që kanë qenë e vazhdojnë të jenë nën dhunën e shtypjen e regjimeve “demokratike” të tipit Serbo Sllav apo Zionist.

Një variant tjetër i terrorizmit është ai që zhvillohet në kuadrin e kryengritjeve. Këto kryengritje mund të jenë separatiste ose mund të përfshijnë gjithë vendin. Në përgjithësi, ato janë revolta të një shkalle të gjerë dhe drejtohen kundër shtetit nga forca guerrilase ose paraushtarake që veprojnë brenda kufijve të shtetit që sulmohet. Megjithatë, këto forca kryengritëse shpesh kanë edhe një komponent terrorist që synon të minimizojë kredibilitetin, ligjshmërinë dhe mbështetjen publike ndaj shtetit, duke drejtuar akte terroriste ndaj popullsisë civile. Shembujt më tipik konsiderohen vrasjet në

shtresat e pambrojtura të popullsisë, si në Algjeri, Nepal, Siri Lanka etj. ku në mënyrën me mizore janë ekzekutuar familje të tëra, me gra e fëmijë dhe të moshuar, duke mos bërë asnjë dallim.

Dukuri të terrorizmit në rajonet baske të Spanjës e Francës.

Organizata terroriste në Spanjë, ETA [Euskadi ta Askatasuna], grupi terrorist për Atdheun dhe Lirinë e Baskëve, u krijua në vitin 1959, si një lëvizje nacionaliste për t'i bërë qëndresë shtypjes politike të popullit bask që nga mbarimi i luftës civile spanjolle [1936-1939]. Objektivat kryesore që në fillim të këtij grupi terrorist ishin mbrojtja dhe çuarja përpara e gjuhës euskera dhe e shfaqjeve kulturore baske. Gjithsesi, synimi kryesor ka qenë krijimi i një atdheu të pavarur në rajonin bask, pra i një shteti bask. Kushtet e vështira të lindjes së ETA-s dhe të veprimit të udhëheqësve baskë përfshijnë edhe faktin se pas Luftës Civile Spanjolle, qeveria baske mërgoi dhe se politika e saj ishte e ndërvarur tërësisht nga Fuqitë Aleate. Por ngjarjet morën një rrjedhë tjetër, në momentin kur Aleatët njohën diktaturën e Fransisko Frankos. Anëtarët e ETA-s ishin nacionalistë, por ndryshonin nga nacionalistët baskë tradicionalë dhe konservatorë. Anëtarët e ETA-s ishin të përkushtuar ndaj aksionit dhe ishin të vendosur të përdornin masa të dhunshme.

Vrasja e kryeministrit Krrelo Blankos, një figurë e fuqishme, në dhjetor 1973, i shkaktoi një dëm të madh regjimit të Frankos. Kjo vrasje evidentoi një element tjetër të rëndësishëm e thelbësor të ETA-s. Ky element konsiston në faktin se kjo organizatë terroriste e dhunshme kontrollonte të gjitha aspektet e luftës revolucionare, politike, sociale e kulturore. Luftërat e brendshme në vetë radhët e kësaj organizate terroriste e midis drejtuesve të saj evidentojnë edhe një dukuri tjetër, atë që epërsia e ushtrisë ndaj udhëheqjes politike, jo gjithnjë është pranuar nga ETA.

Konfliktet e thella të brendshme kanë qenë vazhdimisht të pranishme në gjirin e ETA-s, qysh nga krijimi i saj, veçanërisht në vitin 1974 gjatë Asamblesë së Gjashtë, që çoi në përçarjen e kësaj organizate terroriste. Ajo, përfundimisht u nda në dy fraksione, ETA Politiko-Ushtarake dhe ETA Ushtarake, të cilat kishin qëndrime të ndryshme politike e strategjike. Debatu kryesor dhe papajtueshmëria midis këtyre dy fraksioneve lidhej me çështjen e përdorimit të forcës së armatosur. Fraksioni politik [i cili formoi një parti të re politike, atë të Krahut të Majtë Bask], në përgjithësi braktisi dhunën.

Fraksioni ushtarak përbënte pjesën më të madhe të organizatës ETA-s dhe vijoi strategjinë e tij të dhunës. Strategjia e këtij fraksioni si dhe shkalla e dhunës kanë pësuar ndryshime,

duke filluar që nga viti 1970. Dukuri tipike shfaqen për sa i përket vënies në veprim e formave të reja të dhunës, ndryshe nga më parë. Ndryshimet e konsiderueshme vëreheshin në strategjinë e dhunës, duke vënë theksin në strategjinë e dhunës së padallim të, ndryshe nga ajo e përzgjedhjes që përdorej më parë. Ngjarjet e ndodhura në Madrid, në shtator 1974, pas shpërthimit të një bombe, konkretizojnë më së miri pikërisht këtë prirje strategjike të dhunës.

Dukuri të tilla janë përsëritur edhe të tjera herë, si në qershor 1987 në Katalonjë me shpërthimin e një bombe shumë të fuqishme. Në lidhje me përpjekjet për negociata, rëndësi të veçantë paraqet Dokumenti KAS [KAS, d.m.th. Koordinadora Abertzale Socialista - forumi për bashkërendimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare Baske].

Dokumenti KAS përcaktonte pesë kushte negocimi me qeverinë spanjolle: amnistia; liritë demokratike; dëbimi i forcave shtetërore të sigurimit nga Euskadia; përmirësimi i kushteve të jetesës dhe të punës të klasës punëtore; autonomia e shtetit që përfshinte sovranitetin e Euskadisë. Siç treguan ngjarjet, shumica e këtyre kushteve u përmbushën pas vdekjes së Frankos në vitin 1975. Në bazë të Kushtetutës Spanjolle të vitit 1978 u vendos një demokraci e re, e mbështetur në sundimin e ligjit, që interesohet në mënyrë të veçantë për të drejtat shoqërore. Në tetor 1979 u miratua Statuti i Autonomisë së Vendit Bask.

Në fakt, ETA, në thelb nuk ishte një organizatë që kishte për qëllim të rrëzonte diktaturën e Frankos. Frankoja nuk ishte shkak, por vetëm një kusht i përshtatshëm për dhunën e ETA-s. Kjo argumentohet edhe me faktin se, me gjithë autonominë e gjerë politike që gëzonte vendi i baskëve, dhuna e ETA-s u rrit ndjeshëm pas vdekjes së Frankos. Krahas kësaj, Herri Batasuna, dega politike e ETA-s, që u krijua më 1978 dhe u njoh si parti politike e ligjshme, merre pjesë rregullisht në jetën politike të vendit bask, duke qenë pjesëmarrëse në zgjedhjet vendore dhe të përgjithshme.

Policia spanjolle e franceze i dhanë disa herë goditje të rënda bandës terroriste gjatë viteve 1980 e 1990. Kështu ndodhi pas Operacionit Sokoia [në Hendaja, Francë] të nëntorit 1986, të kryer nga policia franceze në bashkëpunim me shërbimin informativ spanjoll. Në këtë operacion u arrestuan individët që ishin përgjegjës për financimin e ETA-s si dhe u kapën armë, para e një sërë dokumentesh të rëndësishme. Operacioni përbën një shembull bashkëpunimi të gjerë midis Francës e Spanjës në çështjet e terrorizmit. Një goditje mjaft e fuqishme iu dha terroristëve gjatë një operacioni tjetër policor, atij të marsit të vitit 1992, ku u arrestuan kryetarët e ETA-s. Kësaj organizate

terroriste iu deshën disa muaj për të rimarrë veten pas goditjes nga policia. Një nga karakteristikat kryesore të ETA-s është se ajo gjithnjë ka mundur të mbijetojë dhe se mbijetesa mund të konsiderohet si suksesi i saj.

Aktualisht, fuqia sulmuese e goditëse e ETA-s paraqitet e ndryshueshme dhe mbështetja që ajo ka në rajonin bask është e konsiderueshme. Sipas analistëve të mjedisit të sigurisë e të luftës kundër terrorizmit, mbështetja e madhe e kësaj organizate shtrihet në territorin bask. Kjo ndihmë ka qenë thelbësore për suksesin e ETA-s. Mbështetja shoqërore e veprimeve terroriste, vitet e fundit ka ardhur duke rënë. Gjithsesi, relativisht gjatë gjithë historisë së kësaj organizate, rezultoi se 15 për qind e popullsisë bask është e prirur të mbështesë ETA-n dhe të bashkëpunojë me të me të gjitha format.

Strategjia e dhunshme terroriste në Spanjë ka ndryshuar gjatë rrjedhës së kohës. Nga studimet dhe analizat e kryera, dilet në përfundimin se ETA ka sulmuar njerëz të përfshirë nga i gjithë spektri i shoqërisë spanjolle, si civilë, politikanë, ushtarakë, punonjës të policisë dhe prokurorisë së shtetit etj. Në veçanti, nga më tronditëset rezultoi një strategji dhune lidhur me vrasjen e njerëzve të shquar, si politikanë, gjykatës e profesorë. Por kjo organizatë ka vrarë edhe njerëz të thjeshtë, vetëm e vetëm se bënë pjesë në partinë qeverisëse ose në një parti politike kombëtare.

Gjatë vitet '50 në Gjermani, sipas analistit William Blum, evidentohen qartë dukuritë më tipike të veprimeve terroriste dhe shumëllojshmëria e tyre. "Komisioni i hetimit i juristëve të lirë mendimtarë të zonës sovjetike" dhe "Shoqata e refugjatëve politikë nga Lindja" ishin vetëm dy nga grupet e ndryshme të përfshira në fushatën kundër Gjermanisë Lindore. Veprimet e ndërmarra nga këto subjekte shkonin nga krimi rinor te terrorizmi (Blum, 2005). Lista e hollësishme e nismave përfshinte:

- dëmtimin, nëpërmjet eksplozivëve, zjarrvënies, qarqeve të shkurtra dhe metodave të tjera, e centraleve energjetike, kantierëve detare, një dige, kanaleve, ndërtesave publike, shpërndarësve të benzinës, dyqaneve, një stacioni radioje, karrocave shitëse në rrugë, mjeteve të transportit publik;

- nxjerrjen nga shinat të trenave të mallrave, me plagosjen e rëndë të shumë punëtorëve, djegien e automobilave që transportoheshin në një nga këta trena dhe shkatërrimin e mekanizmave të trysnisë së ajrit të të tjerëve;

- prishjen e rrugëve dhe të urave hekurudhore; vënien e eksplozivit mbi një urë hekurudhore të linjës Berlin-Moskë, për fat e zbuluar në kohë: qindra veta do të kishin vdekur;

- përdorimin e acideve speciale për të dëmtuar makineritë industriale me rëndësi jetike; futjen e rërës në turbinat e një fabrike,

duke sjellë ndalimin e saj; vënien e zjarrit një fabrike për prodhimin e tjegullave; nxitjen e grevave nëpër fabrika; vjedhjen e skemave teknike dhe prototipave të zhvillimeve të reja teknologjike;

- vrasjen e 7 mijë lopëve të një ekonomi bujqësore, duke helmuar mbulesën e fillit të dyllit të përdorur për lidhjen e ushqimit të kafshëve;

- hedhjen e sapunit në qumështin pluhur për shkollat e Gjermanisë Lindore;

- sulmet dhe shkatërrimin e selive të së majtës në Berlinin Lindor e në atë Perëndimor, vjedhjen e listave të anëtarëve; rrëmbimet e sulmet ndaj eksponentëve të së majtës e, në disa raste, edhe vrasjen e tyre;

- shpërthimin e bombave me erë të rëndë për të ndërprerë grumbullimet politike;

- hedhjen e balonave aerostatikë që shpërthenin në ajër, duke shpërhapur mijëra fletushka propagande mbi kokën e gjermanolindorëve;

- zbulimin, pas një arrestimi, e sasive të mëdha të kantaridinës, që duhej të përdorej për prodhimin e cigareve të helmuara për të vrarë drejtuesit e Gjermanisë Lindore;

- përpjekjen për të sabotuar Festivalin botëror të Rinisë në Berlinin Lindor duke shpërndarë ftesa të rreme, premtime të rreme për ushqim e strehim falas, lajmërimë të rreme anulimesh veprimtarie;

- kryerjen e sulmeve kundër pjesëmarrësve me eksplozivë, bomba ndezëse e gozhda antipneumatike, vënien e zjarrit një ure druri që ndodhej në një rrugë që të çonte në selinë e Festivalit;

- falsifikimin dhe shpërndarjen e sasive të mëdha të taloneve për racionimin e ushqimit, p.sh. për 27 ton mish, për të sjellë pështjellim, pamjaftueshmëri furnizimesh e zemërim popullor;

- dërgimin e kartelave fiskale false dhe të direktivave e dokumenteve qeveritare krejt të sajura për të rritur çorganizimin dhe joefektshmërinë në industri e në sindikata;

- dhënien e “ndihmave dhe sigurimin e komoditeteve me rëndësi të madhe” gjermanëve të Lindjes që kryen një revoltë më 17 qershor 1953; gjatë dhe pas rebelimit, stacioni radiofonik amerikan i Berlinit Perëndimor RIAS (Radio In the American Sector) transmetoi në territorin e Gjermanisë Lindore programe nxitëse duke i bërë thirrje popullit t’i bënte qëndresë qeverisë; RIAS-i transmetoi edhe paralajmërimë ndaj dëshmitarëve të një çështjeje që diskutohej nga “komisioni i hetimit i juristëve të lirë mendimtarë të zonës sovjetike” se do të shënoheshin në listën e “të akuzuarve” të përpiluar nga vetë komiteti, po të gënjenin.

Incidentet terroriste në Mbretërinë e Bashkuar

Shumica e veprimeve terroriste në Mbretërinë e Bashkuar qysh nga Lufta e Dytë Botërore, kanë qenë ato të terrorizmit irlandez në Irlandën e Veriut. Terrorizmi i kohëve të sotme në Irlandën e Veriut, i filluar në vitin 1969 dhe që njihet me emrin “Trazirat”, filloi si vijim i lëvizjes për të drejtat civile. Këto veprime u ndërmorën nga pjesëtarë të caktuar të bashkësisë katolike për të kundërshtuar praktikat diskriminuuese të kryera ndaj kësaj bashkësie. Shumë njerëz që merrnin pjesë në një lëvizje për të drejtat e plota civile të pakicës katolike, edhe kur të drejtat arriheshin të fitoheshin, vazhdonin të mbanin qëndrimin e mëparshëm të shkëputjes nga Britania dhe bashkimin me Republikën. Nacionalistët më ekstremë nuk donin që për çështjet e të drejtave civile të përdorej zgjidhja që do ta linte Ulsterin pjesë të Mbretërisë së Bashkuar.

Terrorizmi irlandez në Britaninë e Madhe i ka fillimet më 31 tetor 1971, me bombardimin e restorantit që ndodhej në pjesën e sipërme të Kullës së Postës në Londër. Më pas, në shkurt 1972, një akt tjetër i tillë u krye ndaj ushtarëve në një pijetore në Oldershot, një qytet kazermash në jug të Anglisë. Këto incidente shkaktuan bujë të madhe dhe e drejtuan vëmendjen te çështja e IRA-s [Ushtria Republikane Irlandeze]. Shpërthime të vijueshme bombash ndodhën në Britani; në Londër shpërthyen bomba pranë gjykatës kushtetuese penale. Akte të tilla protestonin kundër referendumit për statusin e Irlandës së Veriut, në të cilin fitoi shumica protestante, në favor të qëndrimit pjesë e Bashkimit.

Deri në fund të vitit 1973, në Britaninë e Madhe u kryen rreth shtatëdhjetë incidente terroriste nga IRA, si shpagim ndaj burgosjes së terroristëve irlandezë që kishin sulmuar Uoild Beilin.

Duke studiuar konceptet dhe praktikat terroriste të kësaj periudhe, evidentohet prirja e një taktike të re, ajo e vendosjes së bombave në kutitë postare dhe në koshat e mbeturinave anës rrugëve të qyteteve. Në dukuritë e reja të veprimeve u përfshinë goditjet me armë nga automjetet në ecje, hedhje bombash nga automjetet në ecje [bomba të mbushura me gozhdë që hidheshin nga dritaret e makinave që ecnin me shpejtësi], si dhe sulme me bomba në restorante. Me gjithë një periudhe rënie në vitin 1977, përsëri ndodhën incidente të bujshme, si shpërthimi i një bombe me gozhdë në Çelsi Berrëks në tetor 1991.

Krahas terrorizmit irlandez, vërehet se kanë ndodhur edhe një numër incidentesh të tjerë trazirash sociale dhe fushatash të dhunshme shumë të ngjashme me terrorizmin, të cilat për arsye të përkufizimit ligjor të terrorizmit të përdorur në Mbretërinë e Bashkuar, deri në kohën kur u vu në fuqi ligji i ri, nuk

klasifikoheshin si të tilla. Disa demonstrime anarkike të ndodhura vitet e fundit, nganjëherë, të karakterizuara si antikapitaliste dhe antiglobaliste, kanë degjeneruar në rebelime duke shkaktuar plagosje në njerëz dhe dëmtime të rënda të pronës. Ky lloj demonstrimi, sipas analistëve britanikë, rezulton se po bëhet një dukuri në rritje me përmasa ndërkombëtare.

Pavarësisht nga procesi i paqes me Irlandën e Veriut, kërcënimi më i madh i mundshëm për sa i përket terrorizmit të brendshëm në Britani ka qenë ai i terrorizmit irlandez. Studimi i këtyre dukurive evidencon faktin se në qarqet zyrtare ka prirje në rritje për të trajtuar e vlerësuar si terrorizëm edhe veprime të tilla, si prishjet e qetësisë, demonstrimet apo fushatat e dhunshme. Megjithëse kërcënimet dhe rastet e këtyre prishjeve rezultojnë në rritje, ndjeshmëria e përgjithshme e publikut ende nuk i barazon ato me aktet e llojit të terrorizmit irlandez.

Lidhur me terrorizmin irlandez, me gjithë përpjekjet e jashtëzakonshme për t'i dhënë atij një goditje tërësore, ndonëse relativisht ka rënie të intensitetit të tij, ai nuk është eliminuar krejtësisht. Mosmarrëveshjet midis bashkësive janë problem për zgjidhje, gjë që bënë të domosdoshme një proces politik sa më të efektshëm, krahas përdorimit të mjeteve e teknikave më racionale kundër terrorizmit.

Nga vështrimi teorik i incidenteve terroriste të Britanisë arrihet në përfundimin se këto dukuri lidhen veçanërisht me plagët shoqërore shekullore si në rastin e Irlandës së Veriut, ku ekstremistët iu kundërvunë procesit të paqes, përballë fuqive legjitime për ta mbajtur shoqërinë për ta bashkuar. Roli i forcave të sigurisë në uljen e efikasitetit të organizatave terroriste është një çështje thelbësore që u ofron e mundëson qeverive të ruajnë, zhvillojnë e konsolidojnë procese demokratike e paqeje e të zgjidhin të drejta politike e ligjore.

Bashkëpunimi ndërkombëtar, vlerësohet se mund të marrë vlerën e një faktori thelbësor në përpjekjet për frenimin e dhunës terroriste dhe atje ku është e përshtatshme, për të ndihmuar në ndërmjetësimin e dhënien fund të dhunës.

Konkluzione

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, terrorizmi po merr përmasat e një të keqeje të madhe, veçanërisht në vendet ku ekzistojnë mundësi që terroristët të përdorin armë të shkatërrimit në masë, si dhe për shkaqe të tjera që lidhen me konfliktet nacionale, prapambetjen kulturore, anarkizmin, fundamentalizmin e ekstremizmin.

Si nga forca shkatërruese e mjeteve të përdorimit të terrorizmit, ashtu edhe nga dobësia e objektivave të goditura

prej tij, efektet e terrorizmit marrin përmasa të konsiderueshme, nisur edhe nga vlerësimi aktual i karakteristikave të shoqërisë së sotme e prirjet e saj për të ardhmen.

Ngjarjet tronditëse të 11 shtatorit ushtruan një ndikim të ndjeshëm mbi strategjitë e përgjithshme të vendeve të Europës në luftën kundër terrorizmit. Në mënyrë të veçantë kjo reflektohet në dënimin e sulmeve terroriste nga këto vende si dhe e konsensusit të tyre të ri kundër terrorizmit.

Gama dhe gjerësia e solidaritetit europian e rajonal ndaj autoriteteve të SHBA-së, pas këtij akti kriminal pësoi një rritje si individualisht, ashtu edhe me statusin e vendit anëtar të Bashkimit Europian. Këto vende e të tjerë jashtë këtij bashkimi deklaruan qartazi se sulmet e 11 shtatorit ishin sulme kundër bashkësisë ndërkombëtare në tërësi dhe shprehën përkrahjen për popullin amerikan dhe ndaj politikave të SHBA-së kundër akteve të terrorizmit. Krahas hedhjes poshtë të këtyre akteve terroriste, një trajtim të veçantë patën kërkesat për marrëdhënie të ndërsjella për të luftuar terrorizmin në çdo vend të Europës, të rajonit tonë e në Shqipëri.

Këto risi në politikat kombëtare e më gjerë, tashmë janë një realitet i padiskutueshëm e janë të deklaruara qartë e në formë të prerë, sidomos në mbështetje të vendimeve të Kombeve të Bashkuara kundër terrorizmit e në mënyrë të veçantë të Rezolutave 1368 dhe 1373 të Këshillit të Sigurimit. Rezoluta e parë i dënon sulmet terroriste në mënyrë të vendosur dhe i cilëson si kërcënim ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, duke njohur të drejtën e natyrshme individuale ose kolektive për vetëmbrojtje, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara. Rezoluta e dytë, e cila lidhet me kërcënimet ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare të shkaktuara nga aktet terroriste, konsiderohet edhe më e rëndësishme për vendet e Europës e të rajonit tonë për shkak që deklaroi se të gjitha shtetet duhet të parandalojnë dhe të bëjnë të pamundur financimin e terrorizmit si dhe të marrin një sërë masash të tjera të domosdoshme. Kjo rezolutë u drejtohet e u bën thirrje të gjitha shteteve që, përpara se t'i japin statusin e refugjatit një azilkerkuesi, të marrin masat e duhura në përputhje me dispozitët përkatëse të së drejtës kombëtare e ndërkombëtare, përfshirë standardet ndërkombëtare të së drejtave të njeriut, për t'u siguruar që ai person nuk ka planifikuar, ndihmuar ose marrë pjesë në kryerjen e aktiviteteve terroriste.

Frika e sulmeve nga terroristët e huaj nuk është matur asnjëherë si duhet, por besohet se Shqipëria mund të pësojë sulme të ngjashme me ato të vendeve të tjera europiane. Pozicioni gjeografik i vendit e bën atë tërheqës për terroristët

ndërkombëtarë për ta përdorur si urë kalimi, për më tepër, për shkak se Shqipëria është pjesë e koalicionit ndërkombëtar që përpiqet të ruajë paqen në Irak, kjo mund të nxisë kundërpërgjigje të terroristëve ndaj saj.* Hroni, 2008)

Këto kërcënime janë të lidhura pazgjidhshmërisht sidomos me varfërinë pasi Shqipëria konsiderohet një nga vendet më të varfra në Europë. Kjo sugjeron marrjen në konsideratë të parashikimit se disa shqiptarë do të tërhiqen drejt aktivitetit kriminal për sa kohë që të mos dilet nga varfëria dhe derisa niveli i korrupsionit për të mirat publike do të mbetet i lartë. Gjithsesi, merret në konsideratë fakti që rritja e standardeve të jetesës së shqiptarëve të thjeshtë do të ketë një ndikim të ndjeshëm pozitiv mbi kërcënimet e tjera në mjedisin e sigurisë.

BIBLIOGRAFIA

- John Garson. "Natyra e terrorizmit modern", 2002.
- Xavier Raufer. "Rreziqet e reja për Perëndimin, e ardhmja e terrorizmit", 2000.
- Samuel Huntington. "Përplasja e Civilizimeve".
- J. Bugajski. "Tema", 2001.
- Departamenti Amerikan i Mbrojtjes. "Një vështrim mbi terrorizmin e shekullit të 21", gusht 2003, Kapitulli VI.
- Gjeneral Major Luan Hoxha. "Terrorizmi si fenomen dhe komplikimet për të ardhmen". Revista "Mbrojtja", nr. 9, 2001.
- Strategjia e Sigurimit Kombëtar, fq. 7-8.
- Prof. dr. Pajtim Ribaj. "Terrorizmi sfidë e kohës, ndikimi i tij në politikat e mjedisin e sigurisë", janar 2004.
- Dr. Daniel W. Fitz-Simons "Një studim për terroristët". Revista "Parameters".
- Lufta me intensitet të ulët "Lufta ndaj terrorizmit", Kapitulli III.
- FM-34-130. "Përgatitja zbuluese e fushës së luftimit".
- Joint Doktrine Capstone and Keystone Primer (U. S.).
- JP 5-0. Doktrine for Planning Joint Operations (U. S.).
- Guidelines for Operation Planning (GOP), Final, janar 2001, 2004.
- JP 5-00.2. Joint Task Force Planning Guidance and Procedure (U. S.).
- JP 5-03.1. Joint Operations Planning and Execution System, Vol. I. ST 101-5, Command and Staff Decision Processes, CGSC; Fort Leavenworth.
- Ligji Nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura

- të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin 9194, datë 19.02.2004.
- “Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë”, shpallur me ligj Nr. 9419, datë 12.05.2005.
- Planëzimi i operacioneve të përbashkëta (MP 5 - 0), Tiranë 2006 (Miratuar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së me urdhër Nr. 747, datë 03.11.2006).
- S. P. Huntington, *The Clash of Civilization and the Remaking of World Order*, Great Britain, London, etc., 1997.
- Prof. dr. Rexhep. Meidani, *Kurthet e shtetit-komb*, Toena, 2005.
- Prof. dr. Rexhep. Meidani, *Ballkani, një vështrim i përgjithshëm* (Mali i Zi, Bosnja, Kosova, Maqedonia, Serbia: Sfidat e ardhshme. Toena, 2001, Nga pavarësia drejt ndërvarësisë së integritit, Toena, 2002.
- Prof. dr. Rexhep. Meidani, *Globalizimi, integrimi dhe kombi shqiptar*, Toena, 2002; *Jus Gentium*, Dita, 2003).
- Prof. dr. Rexhep. Meidani, *Ballkani, një vështrim i përgjithshëm* (Mali i Zi, Bosnja).

Alida TOMJA, Doktorante²³**6. KARTA E ADRIATIKUT: INTEGRIMI I VENDEVE TË ADRIATIK 3 NË NATO**

“Ndër objektivat e shumta që kanë qeveritë, sigurimi është objektivi më i rëndësishëm dhe me karakter më të përbashkët. Ai është kusht kryesor për të gëzuar vlerat e tjera”.

KARL W. DEUTSCH

Përfshirja e vendeve të Ballkanit në një organizatë sigurie siç është NATO, është pa dyshim një ngjarje madhore historike në zhvillimet e të ardhmes së tyre. Integrimi i vendeve të Kartës së Adriatikut ka qenë një angazhim që ka filluar shumë më herët se sa nënshkrimi i kësaj karte. Pozicionimi i tyre drejt demokracive perëndimore, ishte përcaktues për zhvillimin e tyre, për krijimin e stabilitetit e të qëndrueshmërisë që do të sillte paqja në rajon.

NATO, ishte rruga e duhur që u hap për këto vende në saj të politikës së dyerve të hapura që ajo ndoqi pas viteve '90. Lancimi i programit të MAP-it (Plani i Veprimt për Anëtarësim) në vitin 1999, ndërtoi një plan të ri marrëdhëniesh midis NATO-s dhe Shqipërisë, Kroacisë e Maqedonisë. Përmes këtij programi, integrimi mori një hov tjetër zhvillimi. Intensifikimi dhe institucionalizimi i këtyre marrëdhënieve arriti pikun e tyre më të lartë me marrjen e ftesës nga Shqipëria dhe Kroacia në Samitin e Bukureshtit, e më pas me pranimin e tyre si vende anëtare të NATO-s. Rruga nga Samiti i Uashingtonit, deri në bashkimin zyrtar me Aleancën Ushtarake, ka qenë e gjatë dhe e vështirë.

²³ Alida Tomja, MSc. është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Shkencave Politike në vitin 2007. Studimet pasuniversitare, Master i Nivelit të Dytë, i ka kryer po në Universitetin e Tiranës në fushën e Marrëdhëniesh Ndërkombëtare. Aktualisht është candidate për gradën doktor në Marrëdhënie Ndërkombëtare pranë Universitetit të Tiranës. Që në vitin 2010 punon në Degën e Komunikimit me Publikun në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe në të njëjtën kohë është lektore me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave Politiko-Juridike, duke u angazhuar në mësimdhënie të Shkencave Politike.

ADRIATIK 3-shi (A3), ishte një iniciativë promovuese dhe nxitëse që Shtetet e Bashkuara të Amerikës projektuan për vendet që nga grupi i Vilnius 10-s mbetën pa ftesë në Samitin e Pragës. Por cili ishte ky grupim që do të quhej Adriatik-3, dhe që kishte si qëllim anëtarësimin e shpejtë në NATO, përmes një modeli bashkëpunimi të padëgjuar më parë në Ballkan? Cilat ishin marrëdhëniet dypalëshe që NATO-ja, krijoi me këto vende? Çfarë përmbante Karta e Adriatikut dhe cili ishte bashkëpunimi në kuadër të kësaj karte? Pikërisht në këto çështje do të fokusohet dhe ky punim. Progresi i reformave të vendeve të Adriatik 3 deri në marrjen e ftesës për anëtarësim, Pranimi i Shqipërisë dhe Kroacisë si dhe Rasti i Maqedonisë, do të jenë linjat përbërëse të këtij punimi.

Kjo temë vlen të studiohet për të kuptuar që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë treguar një interes të veçantë për pavarësinë, integritetin territorial dhe sigurinë e Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë, dhe një përkushtim të madh në ndihmën që u është dhënë këtyre vendeve për arritjen e qëllimit kryesor të tyre, atë të integritetit plotë në strukturat Euroatlantike. Në vija të përgjithshme këto do të jenë tematikat ku do të fokusohet ky punim. Konkretisht, punimi është konceptuar i ndarë në disa çështje. Do të bëhen përpjekje që të ketë vijimësi logjike ndërmjet çështjeve në mënyrë që të jetë sa më i kuptueshëm.

Fjalët kyçe

NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, Karta e vendeve të Adriatikut (A3), Plani i Veprimit për Anëtarësim, Partneritetit për Paqe.

Hyrje

Nëse dikujt do t'i thuhej para 13 apo 15 vjetësh se Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia, së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të binin dakord të bashkëpunonin në një grupim që do të quhet Karta e Adriatikut, ose Adriatik 3, dhe se qëllimi i tyre do të ishte përmbushja e standardeve për marrjen e ftesës për anëtarësim në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), përmes një modeli bashkëpunimi të padëgjuar më parë në Ballkan, ai, së paku do mendonte se, këta njerëz janë "revolucionarë" që duan të transformojnë Ballkanin me idetë e tyre. Personalisht, në atë kohë nuk do ta mendoja një gjë të tillë, sepse gjatë viteve '90 dhe në fillimet e shekullit të ri, përsëri Ballkani u bë arena e konflikteve dhe luftërave dramatike, e dhunës dhe e spastrimit etnik, duke dhënë edhe një herë

shembullin më të keq të mundshëm të trashëgimisë dhe mentalitetit të një Rajoni European (Ballkanit).

Në të vërtetë kjo është arsyeja që, kur më 2 maj 2003, në Tiranë, Sekretari Amerikan i Departamentit të Shtetit, Z. Kolin Pouell, së bashku me homologët e tij të vendeve të Kartës së Adriatikut i dha jetë kësaj iniciative, shumë zyrtarë, edhe brenda NATO-s, e vlerësuan si një “lëvizje” amerikane për të tërhequr vëmendjen, ndërsa për shumë të tjerë, ajo mbeti për një kohë të gjatë jashtë vëmendjes dhe interesimit të tyre, a thua se qëllimi kryesor i saj nuk ishte bashkëpunimi i tre vendeve candidate për anëtarësim në kuadër të përsheptimit të reformave të kërkuara nga vetë Aleanca. Por duket se vendet e Adriatik 3, kishin vendosur që në një kohë shumë të shkurtër të sfidonin jo vetëm “pesimistët”, por edhe vetveten. Ata kishin kuptuar se, për të ndërtuar të ardhmen e tyre Euro Atlantike, drejt të cilës ishin projektuar, duhet t’i kthenin kurrizin së kaluarës dhe me përkushtim të ushqenin së bashku procesin e bashkëpunimit rajonal dhe integritimit.

NATO, ishte rruga e duhur që u hap për këto vende në saj të politikës së dyerve të hapura që ajo ndoqi pas viteve '90. Prezantimi i programit të Plan Veprimit për Anëtarësim (PVA) në vitin 1999, ndërtoi një plan të ri marrëdhëniesh midis NATO-s dhe Shqipërisë, Kroacisë e Maqedonisë. Merita e këtyre të fundit qëndron në pranimin e faktit se aspirata e tyre e anëtarësimit në NATO, do të realizohej vetëm nëpërmjet reformash të të gjitha fushave, bashkëpunimit dhe realizimit të Planit të Veprimit për Anëtarësim. Përmes këtij programi, integrimi mori një hov tjetër zhvillimi.

Duhet thënë se vendet e Adriatik 3-shit, kanë pasur një mbështetje të madhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Iniciativa e saj për ngritjen e Kartës së Adriatikut, si edhe mbështetja që ajo i dha aspiratës së tyre nëpërmjet formulimit të Deklaratës së Samitit të Rigës, ishin tregues të qartë se, Amerika gjithmonë ka qenë serioze dhe e angazhuar në mbështetjen që ajo i ka dhënë Shqipërisë dhe vendeve të Adriatik 3 për anëtarësim. Vendet e Kartës së Adriatikut ishin në fokus të politikës së jashtme amerikane dhe kjo është reflektuar me politikën aktive që Shtetet e Bashkuara kanë treguar për rajonin e Ballkanit, duke pasur si qëllim t’i ndihmojë këto vende, në mënyrë që e ardhmja e rajonit të jetë paqja, stabiliteti dhe demokracia.

Ky punim synon të bëjë të qartë qëllimin e krijimit të Kartës së Adriatikut (A3) dhe objektivat që duheshin përmbushur për arritjen e këtij qëllimi. Gjithashtu, në këtë punim do të njihemi dhe me bashkëpunimin mes vendeve të Kartës së Adriatikut në kuadër të kësaj karte. Do të trajtoj shkurtimisht dhe Komisionin e Partneritetit, i cili u krijua në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rridhnin

nga Karta e Adriatikut. Kryesisht këto do të jenë linjat përbërëse të këtij punimi, e rëndësishme është të dal në pah nëse Karta e Adriatikut arriti të përmbush qëllimin për të cilin dhe u krijua dhe nëse mund të konsiderohet model i bashkëpunimit rajonal.

2. Karta e Adriatikut (A3)

Vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia, të cilat ishin vende anëtare të Partneritetit për Paqe (PfP) dhe të Këshillit Euroatlantik të Partneritetit, pas Samitit të Pragës të vitit 2002, vendosën që të ndiqnin të njëjtën rrugë që kishin ndjekur vendet Baltike (Estoni, Letoni, Lituani) në nënshkrimin e Kartës së Partneritetit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 16 janar 1998, në Uashington.

Karta e Adriatikut, ishte një iniciativë promovuese që Shtetet e Bashkuara të Amerikës projektuan për vendet që nga grupi i “Vilnius 10-s” nuk morën ftesën për anëtarësim në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut. Nga dhjetë vende të kësaj nisme, ftesën për anëtarësim e morën vetëm shtatë prej tyre, Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia duke lënë jashtë Shqipërinë, Kroacinë e Maqedoninë. Por Shtetet e Bashkuara treguan një interesim e përkushtim të veçantë në ndihmën që do iu jepej këtyre vendeve për arritjen e qëllimit kryesor të tyre, atë të integritit të plotë në strukturat Euroatlantike. Këto vende, siç e thamë edhe më lart janë mbështetur vazhdimisht nga politika e jashtme amerikane e cila ka luftuar për një Europë të pandarë, të lirë dhe në paqe.²⁴

Në këtë kuadër, më 2 maj 2003, Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, I. Meta, Ministri i Jashtëm i Maqedonisë, I. Mitreva, i Kroacisë, T. Pikula dhe Sekretari i Shtetit, Kolin Pauell, nënshkruan në Tiranë dokumentin e Kartës së Adriatikut ose A3²⁵. Karta e Partneritetit, është cilësuar si një hartë rruge për integrimin Euroatlantik të tre vendeve, duke institucionalizuar iniciativën e përbashkët të Presidentëve të këtyre vendeve ndërmarrë në Samitin e NATO-s në Pragë, në nëntor të vitit 2002, me synim realizimin e vizionit të përbashkët për një Europë të lirë, të plotë dhe të sigurt.²⁶

²⁴ “Zyrtarja e Departamentit të Shtetit komenton mbi Kartën e Adriatikut dhe Kosovën” gjendet në: <http://www.voanews.com/albanian/news/a-30-a-2003-11-14-4-1-85690732.html>

²⁵ “Adriatic Charter Reinforces Support for NATO’s “Open Door” “ gjendet në: <http://www.america.gov/st/washfile-english/2004/December/20041217142637XLrenneF0.3949396.html>

²⁶ “Historiku, si lindi dhe u zhvillua iniciativa e Kartës së Adriatikut” gjendet në: <http://lajme.shqipëria.com/lajme/artikull/iden/32246/>

Në Samitin e Pragës, të mbajtur në datat 21-22 nëntor 2002, Presidentët e Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë u takuan me Presidentin e Shteteve të Bashkuara, Xhorxh W. Bush dhe propozuan bashkërisht nismën e Adriatikut. Samiti pati një rëndësi të jashtëzakonshme, pasi vendet e Aleancës deklaruan vazhdimin e politikës së dyerve të hapura dhe inkurajuan Shqipërinë, Kroacinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në rritjen e përpjekjeve të tyre për thellimin e reformave.²⁷ Plani i Veprimit për Anëtarësim do të jetë mjeti për të mbajtur progresin e vendeve aspiruese nën vëzhgim. Të ftuarit e sotëm nuk do jenë të fundit.²⁸ Kjo ishte një ndër pikat e Deklaratës së Samit të NATO-s në Pragë.

Mund të themi se deklarata e mësipërme pohoi angazhimin e vazhdueshëm të NATO-s në rajon dhe krijoi hapësira për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve për t'i bërë ato potencialisht të mundshme për anëtarësimin e ardhshëm. Samiti i Pragës u pasua nga intensifikimi i bashkëpunimit trepalësh mes Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë me asistencën e drejtpërdrejtë të Shteteve të Bashkuara, deri sa më 2 maj të vitit 2003, Ministrat e Jashtëm të këtyre vendeve vendosën të nënshkruajnë në Tiranë dokumentin e Kartës së Adriatikut. Por cili ishte qëllimi për të cilin u nënshkrua Karta e Adriatikut dhe cilat ishin parimet në të cilat bazohej ky dokument? Cila do të ishte rruga që do të duhej të ndiqnin këta vende për realizimin e qëllimit të përbashkët madhor? Çfarë funksioni do të kishte Plani i Veprimit për Anëtarësim? Le t'i trajtojmë më poshtë këto çështje.

2.1 Qëllimi i Kartës së Adriatikut (A3)

Karta e Adriatikut ose e quajtur ndryshe Karta e Partneritetit ishte një element i rëndësishëm i bashkëpunimit rajonal në funksion të integritetit të tre vendeve të lartpërmendura në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut. Qëllimi kryesor për të cilin u ndërmor nisma e Adriatikut kishte të bënte me përmbytjen e standardeve të përcaktuara për marrjen e ftesës për anëtarësim nëpërmjet bashkëpunimit (kryesisht në fushën politike dhe të mbrojtjes, të sigurisë, ekonomisë, të të drejtave të njeriut e më gjerë) dhe realizimit të Planit të Veprimit për Anëtarësim.

Siç e thamë edhe më lartë, Karta e Adriatikut ishte një iniciativë e bazuar në Kartën e suksesshme baltike²⁹, një tjetër Kartë

²⁷ "Prague Summit Declaration" gjendet në: <http://www.nato.int/docu/pr/2002/p02-127e.htm>

²⁸ *Po aty*, Pika gjashtë e Deklaratës së Samitit të Pragës.

²⁹ Parë në: http://commdocs.house.gov/committees/intlrel/hfa87671.000/hfa87671_of.htm

Partneriteti e nënshkruar pak vite më parë mes Shteteve të Bashkuara, Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë. Struktura dhe qëllimet e Kartës së Adriatikut ishin të ngjashme me ato të Kartës Baltike.³⁰ Por pavarësisht nga ngjashmëritë, ato kanë pasur dhe diferencat e tyre. Në vijim të kësaj mund të themi që baltikët e përdorën bashkëpunimin dhe partneritetin me Shtetet e Bashkuara si element shtesë sigurie ndaj Rusisë, në një kohë kur ata kishin pak kohë që kishin fituar pavarësinë. Ndërsa vendet e Ballkanit e përdorën bashkëpunimin për të bërë më të dukshme jo vetëm anën pozitive të ndryshimit të mentalitetit ballkanas të pak viteve më parë, por dhe për të ndikuar së bashku aktorët vendimmarrës të NATO-s ndaj aspiratës së përbashkët, asaj të anëtarësimit në Aleancën e Atlantikut të Veriut. E thënë më qartë, qëllimi i Kartës së Adriatikut ishte për më shumë të përcaktonte qartë perspektivat reale që do të kishin Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia për t'u anëtarësuar në NATO, të lehtësonte ndryshimet që do të bëheshin në strukturat e mbrojtjes dhe reformat e brendshme demokratike tek të tre vendet, të rriste stabilitetin dhe sigurinë dhe për më tepër, të ndihmonte këto vende në integrimin e tyre Euroatlantik. Bashkëpunimi dhe integrimi rajonal tashmë do të ishin pararendës të integritimit në NATO dhe në Bashkimin Europian. Kjo nismë, e cila do të përshpejtonte integrimin e tre vendeve aspirante në Aleancë kërkonte që jo vetëm demokracia të fuqizohej por dhe të drejtat e minoriteteve, lufta kundër terrorizmit, trafikut ndërkufitar dhe armëve të shkatërrimit në masë, si dhe të nxiteshin reformat e nisura në Forcat e Armatosura në të tre vendet respektive.

Karta e Partneritetit do të ishte pjesë integrale e përpjekjeve të tre vendeve për anëtarësim në kuadër të bashkëpunimit dhe realizimit të procesit të Planit të Veprimit për Anëtarësim (PVA) i cili do të përbënte dhe mekanizmin kryesor që do të vlerësonte afrimin e këtyre vendeve me Aleancën. Duke përmbushur detyrimet në kuadër të Planit të Veprimit për Anëtarësim, Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia do të kishin mundësi të realizonin reforma në forcimin e demokratizimit të vendit, luftën kundër krimit dhe trafikeve, bashkëpunimin në mbajtjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, si dhe në realizimin e reformave dhe standardeve.³¹ Kjo ishte mënyra më e mirë që këto vende të fitonin besueshmërinë e Aleancës si vende që e

³⁰ "Urmas Paet Participating in Meeting of USA-Adriatic and Baltic Charter Foreign Ministers", gjendet në: <http://www.vm.ee/?q=en/node/6231>

³¹ Karta e Partneritetit ndërmjet Shqipërisë, Maqedonisë, Kroacisë dhe SHBA. Dok i arkivës së Drejtorisë së NATO në MPJ

meritonin anëtarësimin. Por çfarë përmban dhe cili është funksioni i Planit të Veprimit për Anëtarësim?

Prezantim i Planit të Veprimit për Anëtarësim

Plani i Veprimit për Anëtarësim është një mekanizëm përmes të cilit Aleanca ofron këshillime, ndihmë dhe mbështetje praktike ndaj vendeve candidate, për t'i ndihmuar ato në përgatitjen për anëtarësim në NATO. Është një manifestim praktik i politikës së “dyerve të hapura” të NATO-s dhe i ndihmon vendet që të përqendrojnë përgatitjet e tyre në plotësimin e qëllimeve dhe përparësive të trajtuara në të.³² Vendet aspiruese duhet të marrin pjesë në Plan Veprimin për Anëtarësim para se të bëhen anëtarë të Aleancës.

Siç e përmendëm dhe më lart, qëllimi i cili çoi në krijimin e Kartës së Adriatikut, kishte të bënte me përmbushjen e standardeve nga ana e Shqipërisë, Kroacisë e Maqedonisë, për marrjen e ftesës për anëtarësim në Aleancën e Atlantikut të Veriut, e për t'u bërë më pas anëtar me të drejta të plota të saj. Rruga që do të duhej të ndiqnin këta vende për të arritur këtu do të kalonte përmes bashkëpunimit dhe realizimit të objektivave dhe prioritetëve të përcaktuara në Planin e Veprimit për Anëtarësim. Dokumenti i Plan Veprimit për Anëtarësim ka një strukturë standarde të përgatitur nga Aleanca dhe që aplikohet nga të gjitha vendet pjesëmarrëse në këtë proces. Praktikiht dokumenti është i ndarë në pesë kapituj kryesorë që përfshijnë kërkesa lidhur me Çështjet Politike dhe Ekonomike, Çështje të Mbrojtjes, Burimet Financiare, Çështje të Sigurisë së Informacionit dhe së fundi, Çështje Ligjore.³³ Matja e progresit të vendeve aplikante në plotësimin e këtyre kërkesave bëhet nëpërmjet Raporteve të Progresit të përpiluara nga Aleanca, për secilin vend anëtar së bashku me objektivat për ciklin e ardhshëm, vërejtjet e rekomandimet për realizimin e reformave dhe arritjen e standardeve. Ky program vlerësohet si i vetmi instrument i miratuar zyrtar në bazë të të cilit përgatitet opinionin dhe vendimmarrja brenda Aleancës si dhe përbën mekanizmin kryesor për kryerjen dhe kontrollin e reformave.³⁴

Pavarësisht se tre vendet e Kartës së Adriatikut ishin pjesë të Plan Veprimit, kjo nuk garantonte anëtarësimin e tyre pasi

³² "NATO", Handbook; Public Diplomacy Division NATO, Brussels, 2006. fq.201. gjendet në: <http://www.nato.int>

³³ "The Membership Action Plan", gjendet në: <http://www.nato.int/docu/handbook/2001/hb030103.htm>

³⁴ *Po aty.*

çdo ftesë kushtëzohet nga kryerja me sukses e reformave.³⁵ Ky program e përgatit vendin në marrjen e ftesës për anëtarësim, por nuk e garanton atë. Kjo shpjegon dhe arsyen se pse Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia, në Samitin e Pragës të vitit 2002, në ndryshim nga shtatë vendet e tjera të grupit të Vilniusit, nuk morën ftesë për anëtarësim nga Aleanca. Arsyet tashmë janë të kuptueshme. Këto vende nuk kishin përmbushur ende standardet e kërkuara nga NATO në kuadër të Plan Veprimit për Anëtarësim. Pas datës 2 maj, të vitit 2003, kur në Tiranë u nënshkrua dokumenti i Kartës së Adriatikut (A3), Plani i Veprimit për Anëtarësim u kthye në udhërrëfyes të vërtetë dhe u bë një motiv madhor për qeveritë e tre vendeve për të punuar me përkushtim të madh, në të gjitha aspektet e reformave në mënyrë që ta meritonte ftesën për anëtarësim. Bashkëpunimi reciprok ndërmjet vendeve anëtare të kësaj nisme u thellua edhe më tej në funksion të zbatimit të reformave politike, të mbrojtjes, të sigurisë, ekonomisë e më gjerë.

2.2. Karta e Adriatikut (A3), Parimet e Kartës

Karta e Adriatikut përshkruan në vija të përgjithshme parimet kryesore ku mbështetet partneriteti, objektivat e përbashkëta, reformat demokratike, ekonomike, bashkëpunimi rajonal, të drejtat e njeriut, siguria rajonale dhe në këtë drejtim marrëdhëniet e bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara. Karta nuk vendos sanksione apo detyrime të veçanta për tri vendet por vetëm kushte të përgjithshme, të vlefshme për të gjitha vendet anëtare të NATO-s. Në përmbledhjen hyrëse të saj theksohet se progresi i të tre vendeve do të vlerësohet duke u bazuar në arritjet e tyre individuale, pra do të analizohet performanca e secilit në progresin drejt reformave të kërkuara.

Siç e kemi trajtuar dhe më lart, qëllimi parësor për të cilin u ndërmor dhe iniciativa e Kartës së Adriatikut lidhet me thellimin e bashkëpunimit mes Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kroacisë për realizimin e reformave dhe objektivave në kuadër të Planit të Veprimit për Anëtarësim, në mënyrë që të mund të merrnin ftesën për anëtarësim nga Aleanca. Nëpërmjet këtij dokumenti, të tre vendet kandidate u angazhuan të përshpejtojnë reformat e tyre demokratike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, zbatimin e politikave të orientuara drejt tregut të lire dhe rritjen e bashkëpunimit të tyre reciprok. Gjithashtu, një hap shumë i

³⁵ "NATO", Handbook; Public Diplomacy Division NATO, Brussels, 2006. gjendet në: <http://www.nato.int>

rëndësishëm ishte angazhimi për të vazhduar reformat e mbrojtjes, për të ndërmarrë hapa për të rritur sigurinë e kufirit në mënyrë që ata të mund të kontribuonin në stabilitetin rajonal.³⁶ Le të njihemi më poshtë me parimet kryesore në të cilat mbështetej Dokumenti i Kartës së Adriatikut.

Pikat kryesore të Kartës së Adriatik 3-shit: ³⁷

1. Vazhdoi në rrugën e arritjeve të Samitit të Pragës duke përforcuar mbështetjen e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për “Dyert e hapura” të Aleancës, duke nënvizuar qëllimin e integritit të plotë të Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë në NATO dhe institucionet Euroatlantike.

2. Nënvizon përkushtimin e Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë për forcimin e përpjekjeve të tyre individuale dhe të përbashkëta për intensifikimin dhe përshpejtimin e reformave të brendshme të cilat do të rrisin sigurinë, begatinë dhe stabilitetin e rajonit.

3. Vë në dukje arritjet e jashtëzakonshme të bëra nga Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia në rrugën e integritit Euroatlantik, përcakton fushat e fokusit të vazhdueshëm dhe rikonfirmon synimin e Shteteve të Bashkuara për vazhdimin e ndihmës ndaj këtyre vendeve në zbatimin e reformave të nevojshme. Vë në dukje gjithashtu, se çdo vend aspirant do të gjykohet individualisht sipas përparimeve që ka bërë drejt përmbushjes së standardeve për anëtarësim në Aleancën Euroatlantike.

4. Riafirmon pjesën e përkushtimit politik të çdo pale për forcimin e institucioneve demokratike, shoqërisë civile, shtetit të së drejtës, ekonomisë së tregut dhe Forcave të Armatosura sipas standardeve të NATO-s për të luftuar korrupsionin dhe krimin dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut e liritë qytetare për të gjithë individët në Shqipëri, Kroaci, Maqedoni dhe vendet e tjera të Europës Juglindore.

5. Vë theksin në bashkëpunimin e ngushtë rajonal dypalësh dhe shumëpalësh në fushën politike, atë të mbrojtjes dhe ekonomike midis partnerëve dhe fqinjëve të tyre, në të mirë të të gjitha vendeve të Europës Juglindore duke rritur stabilitetin dhe duke përshpejtuar integritimin e rajonit në institucionet europiane dhe transatlantike.

6. Parashikon ngritjen e Komisionit të Partneritetit në një nivel të lartë të përshtatshëm përfaqësimi, që do të mbledhet dy herë

³⁶ “Commending the Signing of the United States, Adriatic Charter”, gjendet në: http://commdocs.house.gov/committees/intlrel/hfa87671.000/hfa87671_0f.htm

³⁷ “Adriatic Charter, Fact Sheet” gjendet në: <http://www.state.gov/p/eur/rls/fs/112766.htm>

në vit apo sipas nevojës më shpesh për të shqyrtuar përparimin e bërë drejt arritjes së objektivave të Kartës.

Pas nënshkrimit të Kartës së Partneritetit nga tre vendet dhe Shtetet e Bashkuara, më 2 maj 2003, Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia e panë të nevojshme të kishte një transparencë, të miratuar bashkërisht që zhvillimet në kuadër të Grupit të Adriatikut të gjenin pasqyrim dhe në Planet Kombëtare për Anëtarësim të këtyre vendeve. Gjithashtu të tre vendet vunë në dukje se Karta e Partneritetit do të ishte pjesë shumë e rëndësishme e përpjekjeve për anëtarësim në kuadër të procesit të Plan Veprimit, i cili do të përbënte mekanizmin e vlerësimit të afrimit të tyre me Aleancën.

Në këtë kuadër, më 12 shtator të vitit 2003, Delegacionet e tre vendeve partnere, Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë, të kryesuar nga Ministrat e Mbrojtjes zhvilluan një takim në Tiranë që u finalizua me nënshkrimin e një Deklarate të Përbashkët. Në vija të përgjithshme, kjo deklaratë e vinte theksin në zotimet e tyre për të zgjeruar bashkëpunimin trepalësh dhe sigurinë rajonale. Gjithashtu, deklarata nënvizonte rolin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në procesin e integritit të tyre në Aleancën e Traktatit të Veriut.

Ashtu si në Dokumentin e Kartës së Partneritetit dhe në këtë deklaratë theksohet pikërisht bashkëpunimi trepalësh në fushën politike, ekonomike dhe në atë të mbrojtjes në mënyrë që të rritet stabiliteti rajonal dhe të përshpejtohet integrimi Euroatlantik i rajonit.

3. Komisioni i Partneritetit i Kartës së Adriatikut

Një nga pikat e Kartës së Adriatikut parashikonte ngritjen e një Komisioni Partneriteti në një nivel të lartë përfaqësimi, që do të mblidhej dy herë në vit apo më shpesh për të shqyrtuar përparimin e bërë drejt arritjes së objektivave të Kartës. Ky komision do të ngrihej në përmbushje të detyrimeve që do të rridhnin nga nënshkrimi i Kartës nën drejtimin e ministrave të Punëve të Jashtme apo zëvendësve të tyre. Sipas përcaktimit që i bëhet dhe në statutin e Kartës, takimet e Komisionit të Partneritetit do të mbaheshin dy herë në vit ose edhe më shpesh në varësi të vlerësimit të konsultimeve të fushave të përcaktuara të bashkëpunimit, si dhe të rishikimit të progresit në përmbushjen e objektivave. E thënë më qartë, synimi i këtyre takimeve konsistonte në marrjen në konsideratë të realizimit të aktiviteteve dhe planëzimin për të ardhmen. Këto takime do të zhvilloheshin në një nga qytetet e vendeve nënshkruese të kartës dhe drejtimi i kësaj iniciative të përbashkët do të bëhej përmes sistemit të rotacionit gjashtë mujor.

Takimi i parë i Komisionit të Partneritetit në nivel ministrash të Jashtëm ndërmjet Shqipërisë, Kroacisë, Maqedonisë dhe Shteteve të Bashkuara u zhvillua më 14 nëntor të vitit 2003 në Uashington. Qëllimi i këtij takimi, konsistonte në vlerësim të progresit të arritur përgjatë kësaj periudhe si dhe në përcaktimin e hapave që do të ndiqeshin më tej.³⁸ Në këtë mënyrë kanë vijuar dhe takimet e tjera të Komisionit të Partneritetit të cilat janë mbajtur përkatësisht: në Shkup më 19-20 maj të vitit 2004, në Brijuni të Kroacisë më 12-14 nëntor të vitit 2004, në Tiranë, më 2-3 maj të vitit 2005, sërish në Uashington më 13-14 shkurt 2006, në Bruksel më 3 dhjetor të vitit 2006, në Ohër në qershor të 2007-s, sërish në Kroaci në tetor të vitit 2007, e në vazhdim.³⁹ Por takimi i Komisionit të Partneritetit në të cilin kanë marrë pjesë për herë të parë Ministrat e Jashtëm të Bosnjë-Hercegovinës dhe Malit të Zi, të cilat nënshkruan parimet e Kartës së Adriatikut më 04 dhjetor të vitit 2008 në Helsinki, është zhvilluar më 8 maj të vitit 2009, në Tiranë. Në këtë takim u diskutua rreth perspektivave të zhvillimit në Ballkanin Perëndimor dhe forcimit të bashkëpunimit në funksion të integritetit të të gjithë rajonit në strukturat Euroatlantike. Gjithashtu u diskutuan çështje të sigurisë në interes të rajonit dhe më gjerë.⁴⁰ Në takimet e Komisionit të Partneritetit, krahas takimit standard të tre vendeve dhe Shteteve të Bashkuara, janë zhvilluar edhe takime të zgjeruara, në sesione të veçanta të katër vendeve me shtetet anëtare të NATO-s, të interesuara të ndihmojnë anëtarësimin në Aleancë të këtyre vendeve.

Komisioni i Partneritetit i Kartës së Adriatikut, ka luajtur rol të rëndësishëm në nxitjen e bashkëpunimit rajonal në fushat politike, ekonomike, të sigurisë, mbrojtjes, në krijimin e besimit dhe në lehtësimin e procesit të integritetit Euroatlantik të Ballkanit.

³⁸ "Historiku, si lindi dhe u zhvillua iniciativa e Kartës së Adriatikut" gjendet në: <http://lajme.shqipëria.com/lajme/artikull/iden/32246/>

³⁹ Takime të Komisionit të Partneritetit zhvillohen rregullisht dhe pas pranimit të Shqipërisë dhe Kroacisë si anëtare me të drejta të plota në Aleancën e Atlantikut të Veriut, në mënyrë që të ndihmojnë me përvojën e tyre të gjitha vendet e tjera të rajonit që do të angazhohen në plotësimin e standardeve për anëtarësim në strukturat Euroatlantike. Ministrat e Jashtëm të vendeve të Kartës së Adriatikut (A5), janë takuar së fundi në Shkup, më 15 dhjetor 2010, ku diskutuan *lidhur me perspektivën e integritetit Euroatlantik pas Samitit të Lisbonës dhe angazhimet e mëtejshme për kontributin e vendeve partnere drejt stabilitetit të Afganistanit.*

⁴⁰ "Zhvillohet në Tiranë Takimi i Komisionit të Partneritetit të Kartës së Adriatikut" gjendet në: <http://www.keminet.net/~minfagov/index.php?option>

4. Bashkëpunimi në kuadër të Kartës së Adriatikut (A3)

Karta e Adriatikut e nënshkruar fillimisht mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë është faktuar në vazhdimësi si model i bashkëpunimit të suksesshëm rajonal që i ka shërbyer realizimit të qëllimit për të cilin ajo dhe u krijua. Kjo nismë e vitit 2003 u shndërrua në një instrument të fuqishëm në funksion të nxitjes së bashkëpunimit rajonal dhe të sigurisë duke provuar kontributin e vet në arritjen e vizionit të përbashkët për një Europë të bashkuar, të lirë dhe në paqe. Me qëllim që të viheshin në jetë në mënyrë cilësore detyrimet që rridhnin nga Karta e Adriatikut, Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia (më pas dhe Bosnjë-Hercegovina e Mali i zi), kanë bashkëpunuar në nivele dhe në fusha të ndryshme ku mund të përmendim fillimisht takimin e Presidentëve të katër vendeve, takime të Delegacioneve Parlamentare, takimet në nivel Ministrash të Jashtëm, të Mbrojtjes, takime të Shefave të Shtabeve, Komandave, Drejtorive dhe ekspertëve të fushave përkatëse.

Takimi i parë trepalësh i Ministrave të Mbrojtjes, është zhvilluar më 12 qershor 2003, në Bruksel.⁴¹ Ky takim pati në qendër konsultime në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, arsimimin ushtarak, pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse të drejtuara nga Aleanca, etj. Takime të këtij niveli janë zhvilluar dhe në vijim. Gjithashtu, janë zhvilluar takime të Komisionit të Partneritetit për të cilat kemi folur më lart. Këto takime vazhdojnë të organizohen, por tashmë në kuadër të Adriatik 5-s. Nëpërmjet tyre, synohet të nxitet bashkëpunimi, shkëmbimi i eksperiencave në kuadër të Kartës në fushat politike, ekonomike, të sigurisë, mbrojtjes, kulturore e të mjedisit. Bashkëpunimi trepalësh në fushën e mbrojtjes ka qenë një objektiv mjaft i rëndësishëm. Për të përmbushur këtë objektiv, vendet partnere kanë organizuar takime të nivelit të lartë, të paktën një herë në vit, ku janë konsultuar mbi sigurinë dhe politikat e mbrojtjes. Gjithashtu kanë pasur bashkëpunim ushtarako-technik, bashkëpunim në Operacionet në Mbështetje të Paqes, krijuan një strategji të përbashkët në fushën e mbrojtjes dhe një program të përbashkët aktiviteteve ushtarake. Bashkëpunimi ka qenë jo vetëm mes vendeve të A3, por dhe me vendet e tjera të rajonit.⁴²

⁴¹ "Historiku, si lindi dhe u zhvillua iniciativa e Kartës së Adriatikut" gjendet në: <http://lajme.shqipëria.com/lajme/artikull/iden/32246/>

⁴² Demi, Leonard. Cikël Ligjëratash mbi: "Institucionet, Politikat dhe Çështje të Sigurimit Evropian", Ligjërata: Karta e Adriatikut (A3). UT, F. i Historisë, Master i Shkencës.

Gjithashtu, kanë shkëmbyer përvojë dhe informacion në fushën e edukimit ushtarak, në hartimin e dokumenteve themelore për integrim në Aleancë. Kanë nënshkruar marrëveshje të përbashkëta për përballimin e sfidave të reja ndaj sigurisë si terrorizmi, trafiku i qenieve njerëzore, armatimet e rrezikshme duke rritur sigurinë në kufi kundër këtyre fenomeneve.⁴³ Përparim ka pasur dhe në fushën e sigurimit të informacionit të klasifikuar, përmes vizitave të ekspertëve.⁴⁴

Projekti më domethënës brenda Kartës së Adriatikut është përfshirja e tre vendeve në misionin Forcat e Ndihmës së Sigurisë Ndërkombëtare (ISAF) në Afganistan.⁴⁵ Gjithashtu, janë organizuar një numër i madh stërvitjesh të përbashkëta në kuadër të Kartës që nga viti 2003, ndër të cilat mund të përmendim: “Neighbors Effort-2003”, “Eagle SAR”-2003, 2004, 2005, Stërvitja malore “Bovilla”, përgjatë viteve të ndryshme, Adriatic Phiblex-05, etj. Me rëndësi është edhe bashkëpunimi që parlamentet e vendeve të A 3-shit kanë zhvilluar në favor të përshtetimit të reformave që do të ndihmonin integrimin. Këtu mund të përmendim, takimin e Komisioneve të Sigurisë Kombëtare dhe Delegacioneve Parlamentare të vendeve të Kartës së Adriatikut në Tiranë, në vitin 2006 dhe më 24 shkurt 2009, ku miratuan një Deklaratë të përbashkët për të rritur bashkëpunimin në mbështetje të parimeve të Kartës së Adriatikut.⁴⁶ Në këtë mënyrë, në kuadër të realizimit të qëllimit të Kartës së Adriatikut, bashkëpunimi, në fushën e mbrojtjes dhe në fushat e tjera të përcaktuara në Planin e veprimit për Anëtarësim, solli rritjen e besimit reciprok, forcimin e partneritetit, shpejtimin e reformave demokratike, uljen e tensioneve e forcimin e stabilitetit rajonal, por mbi të gjitha ndihmoi këto vende në rrugën e integritit Euroatlantik.

Bazuar në ato që thamë më lartë është e lehtë të kuptohet pse Karta e Adriatikut është konfirmuar vazhdimisht si model i bashkëpunimit të suksesshëm rajonal, një model efektiv që i ka shërbyer realizimit të qëllimit për të cilin ajo u krijua. Ftesat e anëtarësimit në NATO, për Shqipërinë dhe Kroacinë, që ofroi

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Musfaj, Besnik, “Karta e Adriatikut dhe NATO” Fjalimet e mbajtura në konferencën: “Agjendë shqiptare për sigurinë rajonale” 7-8 mars 2006, Tiranë, fq. 21.

⁴⁵ Tanku, G”A-5, shembull i partneritetit për siguri”, gjendet në: <http://217.24.243.131/botime/html/revista/2009/06/faqe4.htm>

⁴⁶ “Deklarata e Parlamentarëve të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi në mbështetje të Kartës së Adriatikut” gjendet në: <http://www.parlament.al/?k=5603>

Samiti i Bukureshtit më 3 prill të vitit 2008, janë dëshmi të këtij efektiviteti të cilat flasin për vlerësim të përpjekjeve dhe arritjeve të jashtëzakonshme në reformat e ndërmarra. Në Deklaratën e Samitit të Bukureshtit thuhet: *Ne urojmë këto vende për këtë arritje historike, e fituar nga vite pune të vështirë dhe një angazhimi të treguar për sigurinë e përbashkët dhe vlerat e NATO-s. Hyrja e këtyre anëtarëve të rinj do të forcojë sigurinë për të gjithë në zonën Euro – Atlantike dhe do na sjellë ne më afër synimeve tona për një Europë të tërë, të lirë dhe në paqe.*⁴⁷ Në ndryshim nga Shqipëria dhe Kroacia, Maqedonia nuk mundi të merrte ftesën për anëtarësim dhe kjo jo për arsye të mospërbushjes së kriterëve, por për arsye se Greqia u bë pengesë si rezultat i çështjes dypalëshe të pazgjidhur mbi emrin e Maqedonisë.⁴⁸ Megjithatë, dera e saj për në Aleancë mbetet e hapur sapo të zgjidhet ky problem.

Anëtarësimi i plotë i Shqipërisë dhe Kroacisë është zyrtarizuar gjatë Samitit të Strasburg-Kehl të Aleancës, më 4 prill 2009. Në deklaratën e këtij Samiti vlerësohet roli i rëndësishëm i Kartës së Adriatikut në nxitjen e bashkëpunimit rajonal, ndërtimin e besimit, dhe lehtësimin e procesit të integritimit Euroatlantik të Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, vendet e Aleancës shprehin gatishmërinë e tyre për të mirëpritur përpjekjet e Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi e Serbisë në rrugën e tyre të integritimit.⁴⁹ Shembulli i dhënë nga Aleanca me dhënien e ftesës për Shqipërinë, Kroacinë e më pas pranimin si anëtare me të drejta të plota të tyre, shënoi fillimin e një ere të re në Ballkanin Perëndimor dhe tregoi rrugën drejt së ardhmes në të cilën një rajon i stabilizuar tashmë po integrohej tërësisht në institucionet Euroatlantike. Ky vendim jepte mesazhin e shpresës se edhe vende të tjera të rajonit, po të punonin fort në drejtim të integritimit dhe realizimit të reformave, do të bëheshin pjesë e integruar e familjes së zgjeruar Euroatlantike.

Përfundime

Së fundi, pasi u njohëm me dokumentin e Kartës së Adriatikut, me qëllimin për të cilin u ndërmor kjo nismë më 2 maj të vitit

⁴⁷ Pika 2 e Deklaratës së Samitit të Bukureshtit.

⁴⁸ *Greqia, deklaronte se emri Maqedoni, përmban në vetvete një pretendim territorial për zonën veriore të Greqisë me të njëjtin emër.*

⁴⁹ "Strasburg / Kehl Summit Declaration" gjendet në: http://www.nato.int/cps/en/natolive/news_52837.htm

2003, nga Shqipëria, Kroacia e Maqedonia nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mund të themi pa asnjë mëdyshje se: Karta e Adriatikut meriton të quhet model i bashkëpunimit të suksesshëm rajonal që i ka shërbyer dhe realizimit të qëllimit për të cilin ajo dhe u krijua.

Ky akt i vitit 2003 u shndërrua në një instrument të fuqishëm që nxiti bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë duke ulur tensionet, forcoi stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin e rajonit tonë duke provuar kontributin e vet në arritjen e vizionit të përbashkët për Europën e bashkuar, të lirë dhe në paqe.

Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi ishin pikërisht dy vendet të cilat duke konsideruar nismën e Kartës së Adriatikut, me një rëndësi të jashtëzakonshme në nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe sigurisë e rrjedhimisht për integrimin euroatlantik, u bashkuan me parimet e Kartës së Adriatikut. Këtij mozaiku pritet t'i shtohen dhe Kosova e Serbia.

Shqipëria, Kroacia e Maqedonia në kuadër të Kartës së Adriatikut arritën të përshpejtonin reformat demokratike në fushat politike, ekonomike, të sigurisë, mbrojtjes e të ambientit, përmbushën detyrimet në kuadër të Planit të Veprimit për Anëtarësim e rrjedhimisht standardet e përcaktuara nga Aleanca për të marrë fillimisht ftesën për anëtarësim e për t'u bërë më pas anëtarë me të drejta të plota të saj.

Ftesat për anëtarësim në Aleancë, për Shqipërinë dhe Kroacinë që ofroi Samiti i Bukureshtit më 3 prill të vitit 2008, janë dëshmi të këtij efektiviteti të cilat flasin për vlerësim të përpjekjeve dhe arritjeve të jashtëzakonshme në reformat e ndërmarra, në të njëjtën kohë shënojnë një kapitull të ri në rrugën drejt të ardhmes plotësisht të integruar në institucionet Euroatlantike. Ky vendim u tregoi dhe Bosnjë-Hercegovinës, Mali të Zi dhe vendeve të tjera të rajonit që po të punonin në drejtim të integritimit dhe realizimit të reformave, nëpërmjet këtij modeli bashkëpunimi rajonal të frytshëm, do të bëheshin pjesë e integruar e familjes së zgjeruar Euroatlantike.

REFERENCA

Adriatic Charter Reinforces Support for NATO's "Open Door",
<http://www.america.gov/st/washfile>

Adriatic Charter, Fact Sheet, <http://www.state.gov/p/eur/rls/fs/112766.htm>

Commending the Signing of the United States, Adriatic Charter,
<http://commdocs.house.gov/committees/intlrel/hfa87671.000/hfa87671>

Deklarata e Parlamentarëve të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi në mbështetje të Kartës së Adriatikut, <http://www.parlament.al/?k=5603>

Demi, Leonard. *Cikël Ligjëratash mbi :Institucionet, Politikat dhe Çështje të Sigurimit European, Ligjërata: Karta e Adriatikut (A3).UT, F. i Historisë, Master i Shkencës.*

Historiku, si lindi dhe u zhvillua iniciativa e Kartës së Adriatikut, <http://lajme.shqipëria.com/>

Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, 2008. *Shqipëria dhe NATO; Përse na duhet NATO-ja?*, Tiranë.

Karta e Partneritetit ndërmjet Shqipërisë, Maqedonisë, Kroacisë dhe SHBA. Dokument i Arkivës së Drejtorisë së NATO-s në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Komisioni i Partneritetit i Kartës së Adriatik 5: Shqipëria model për vendet e Ballkanit në rrugën e anëtarësimit në Nato, http://www.mfa.gov.al/index.php?option=com_content&view

Montenegro, BiH join Adriatic Charter, <http://www.emg.rs/en/news/region/72019.html>

Musafaj, B. *Karta e Adriatikut dhe NATO*, Fjalimet e mbajtura në Konferencën: “Agjendë shqiptare për sigurinë rajonale”, 7-8 mars 2006, Tiranë.

NATO Office of Information and Press. 2001. *NATO Handbook*, Brussels. <http://www.nato.int/docu/handbook/2001/pdf/handbook.pdf>

Prague Summit Declaration, <http://www.nato.int/docu/pr/2002/p02-127e.htm>

Public Diplomacy Division NATO. 2006. *NATO Handbook*, Brussels. <http://www.nato.int/docu/handbook/2006/hb-en-2006.pdf>

Strasbourg / Kehl Summit Declaration”, http://www.nato.int/cps/en/natolive/news_52837

Tanku, G. *A-5, shembull i partneritetit për siguri*, <http://217.24.243.131/botime/html/revista/2009/06/faqe4.htm>

The Membership Action Plan, <http://www.nato.int/docu/handbook/2001/hb030103.htm>

Urmas Paet Participating in Meeting of USA-Adriatic and Baltic Charter Foreign Ministers, <http://www.vm.ee/?q=en/node/6231>

Zhvillohet në Tiranë takimi i Komisionit të Partneritetit të Kartës së Adriatikut, <http://www.keminet.net/~minfagov/index.php?option>

Zyrtarja e Departamentit të Shtetit komenton mbi Kartën e Adriatikut dhe Kosovën, <http://www.voanews.com/albanian/news/a-30-a-2003-11->

The EU between Pooling & Sharing and Smart Defence Making a virtue of necessity?

By Giovanni Faleg and Alessandro Giovannini

The financial crisis has deeply affected European defence budgets and, as a consequence, the EU's capability to act as a provider of global security. This paper assesses the extent to which pooling & sharing (P&S) of military capabilities is a viable plan to boost collective capacity-building and offset the heavy budget cut-backs, drawing impetus from the NATO 'smart defence' agenda. Although multilateral cooperation is proven more efficient than the status quo through the lens of economics, and a set of external stimuli would facilitate deeper military integration, the paper acknowledges that a fully-fledged EU defence market remains difficult to attain due to short-term political and strategic considerations. However, piecemeal progress in specific areas is possible and viable, if political conditions are met. The last section of the paper offers some policy recommendations towards a pragmatic and feasible roadmap for P&S.

Inclusive Approach to NATO's Smart Defence

By Lidija Levkovska and Shane Thomas Franklin

This paper considers avenues to successful, interoperable and compatible sustainment of capabilities in the SEE region, compliant with NATO's Smart Defence concept. The arguments presented in this paper keep the collective interest in responsible management of defence resources at the forefront. Furthermore, we entail joint efforts of NATO and the Balkan countries as paramount to deepen the regional cooperation by developing solutions that are rooted in NATO's "smart defence" concept. Considering that there is a low probability that the modest defense spending trend will end any time soon and should the SEE and NATO fail to smartly coordinate, pool and share resources towards development of shared regional defence capabilities, they stand a chance to further lag behind and undermine the regional capability sustainment efforts of the Alliance.

The Geopolitical Implications of the Eurozone Crisis: The Case of the Common Security and Defence Policy Daniel Fiott

This paper is concerned with the European Union's (EU) ability to overcome geographical constraints in light of the eurozone crisis. The paper's starting hypothesis is that the eurozone crisis has indeed impacted on the EU's internal relations and on its foreign dimension, especially with partners such as the United States (US) and China. Taking policy dimensions such as defence and security as important political and material mechanisms for overcoming the constraints of geography, and keeping in mind the manner in which the eurozone crisis is putting pressure on sovereign budgets, the task is to see to what extent the EU is still able to "tame" geopolitical forces.

In essence, this paper is interested in uncovering whether the eurozone crisis will lead to the erosion of factors which the EU uses to overcome the constraints and challenges of geography. Yet before this one would do well to realise that the eurozone crisis is not the root of all of the EU's problems, but it has laid bare and aggravated structural problems which have afflicted the EU over a longer period of time.

Economic crisis and organized crime By dr. Arben Shehu

Organized crime is approached and studied as a phenomenon which brings inevitably economic, politic and social instability. Fight against organized crime has constituted permanently the major contribution from international organizations in strengthening the institutions in the countries of the region. At the same time, it has also been one of the conditions that those countries' governments have to fulfill for the EU and NATO integration. Generally, criminality is being treated as one of the factors for decreasing stability and security. Still, there is to be clarified the effect of the economic crisis in organized crime trends. In this regard, one should take into consideration the characteristics, activity, the organization and criminality features in Albania but also in other countries in the region.

Albanian legislation and the institutions involved in fight against organized crime should show awareness of organized crime characteristic, development and its reaction to political, social and economic situation

Terrorism and its historical context in Europe

By Kudret Selimaj

The manifestation of terrorism as a challenge to security differs in forms and places. This article focuses on terrorism in Europe and it tries to approach different definitions about this concept starting from a European traditional context and the present environment of terrorist activity. It aims to clarify the strategic objective of this phenomenon, as well as causes and factors for the genesis and development of terrorism. After a short description, this article assesses the evolvement over the years of some terrorist organization in Spain, France and North Ireland, from both a theoretical and practical perspective. Through this theoretical view, the main directions and goals of major terrorist organization are being evidenced and their specific features are being clarified.

Adriatic Charter: NATO integration of Adriatic 3 countries

By Alida Tomja

The inclusion of Western Balkan countries into a security organization like NATO constitutes without doubts a major historic event regarding their future development. The integration of the countries of the Adriatic Charter is an attempt that started much earlier than the signing of this framework. Their orientation towards Western democracies was a determinant factor that created the necessary stability and sustainability that would bring peace to the region.

Adriatic 3 (A3) was a promoting and encouraging initiative designed by the United States for the countries that remained without an invitation from the Vilnius 10 group at the Summit of Prague. But what was the so-called Adriatic 3 which aim was to achieve quick NATO membership through a cooperation model unknown before in the Balkans? What were the bilateral relations that NATO established with those countries? What was the content of the Adriatic Charter and what was the cooperation envisaged within its framework? These are the issues on which this paper focuses on. The progress of reforms in the Adriatic 3 countries until the invitation for membership was received; the membership of Albania and Croatia as well as the case of Macedonia will constitute the main lines of this work.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHITJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË - 22

Formati: 15.5x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: + 355 4 22 40 116
Tiranë, 2012